
VLERËSIM PARAPRAK I
DHOMAVE TË SPECIALIZUARA
TË KOSOVËS

Struktura, funksioni, praktika në
zhvillim dhe sfidat ligjore

RRETH KOMITETIT TË AVOKATËVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Komiteti i Odës së Avokatëve për të Drejtat e Njeriut i Anglisë dhe Uellsit (BHRC) është degë e pavarur dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e Odës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit, që merret me mbrojtjen e të drejtave të avokatëve, gjykatësve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut në mbarë botën. BHRC-ja angazhohet për mbrojtjen e sundimit të ligjit dhe standardeve juridike të njohura ndërkombëtarisht, që lidhen me të drejtat e njeriut dhe me të drejtën në gjykim të drejtë. Komiteti është i pavarur nga Këshilli i Odës së Avokatëve.

BHRC-ja synon:

- Të mbrojë sundimin e ligjit, si dhe normat dhe standardet të njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut;
- T'i mbështesë dhe mbrojë avokatët në ushtrim të profesionit, gjykatësit dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut që përballen me kërcënime ose presion gjatë punës së tyre;
- Të zhvillojë më tej interesin dhe njohuritë mbi të drejtat e njeriut dhe ligjet përkatëse si brenda, ashtu edhe jashtë profesionit juridik;
- T'i mbështesë dhe bashkëpunojë me organizata dhe individë të tjerë, që punojnë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në kuadër të mandatit të tij, BHRC-ja ndërmerr misione vëzhgimi juridik për t'i monitoruar procedurat ku ekzistojnë shqetësime lidhur me funksionimin e duhur të procesit të rregullt ligjor dhe të së drejtës për gjykim të drejtë. Krahas juridiksionit të vet, Anglisë dhe Uellsit, fushëveprimi i BHRC-së shtrihet në të gjitha vendet e botës. Kjo pasqyron nevojën që Komiteti ta ushtrojë funksionin e tij si vëzhgues dhe kritik i pavarur, duke qenë njëkohësisht i kualifikuar në aspektin juridik.

Anëtarët e BHRC-së janë kryesisht avokatë të pranuar në Odën e Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit, akademikë të fushës së drejtësisë, si dhe studentë të drejtësisë. Në mesin e anëtarëve përfshin disa nga avokatët më të shquar të të drejtave të njeriut në Mbretërinë e Bashkuar, ushtrues të së drejtës dhe akademikë. Komiteti Ekzekutiv dhe anëtarët e BHRC-së i ofrojnë shërbimet e tyre *pro bono*, njëkohësisht krahas ushtrimit të profesionit të tyre në mënyrë të pavarur, angazhimeve në mësimdhënie dhe studimeve të drejtësisë. BHRC-ja mbështetet gjithashtu nga dy zyrtarë të projekteve.



Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës
Institucija Ombudsmana Republike Kosovo
Ombudsperson Institution of Republic of Kosovo

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT TË KOSOVËS

VLERËSIMI PARAPRAK I DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

Përgatitur nga:

Komiteti i Odës së Avokatëve për të Drejtat e Njeriut (BHRC), Londër

Porositur nga:

Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës

Prill, 2026

MOHIM PËRGJEGJËSIE

Ky raport është porositur nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës në ushtrim të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe liritë themelore, dhe për të mbështetur llogaridhënien dhe sundimin e ligjit.

Pronësia e këtij raporti i takon Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

Raporti është përgatitur plotësisht në mënyrë të pavarur nga Komiteti i Odës së Avokatëve për të Drejtat e Njeriut (BHRC), Londër. Përmbajtja e këtij raporti, duke përfshirë analizën, gjetjet, përfundimet dhe çdo rekomandim, pasqyron vetëm pikëpamjet e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet, qëndrimet ose vlerësimet zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës ose të ndonjë institucioni tjetër. Porositja e këtij raporti nuk nënkupton miratimin e të gjitha pikëpamjeve të shprehura në të. Përkundrazi, ai pasqyron angazhimin e Institucionit të Avokatit të Popullit për të siguruar vlerësim të pavarur nga ekspertë, për të nxitur transparencën dhe për të promovuar dialogun e informuar dhe konstruktiv mbi çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.

Versioni origjinal i këtij raporti është përgatitur në gjuhën angleze. Në rast të mospërputhjeve në përkthim, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VLERËSIM PARAPRAK I DhSK-së

Përmbajtja

I.	HYRJE & METODOLOGJIA.....	5
II.	STRUKTURA INSTITUCIONALE E DhSK-së.....	7
	A. Origjina dhe themelimi i Dhomave të Specializuara	7
	B. Mandati, Juridiksioni dhe Struktura Organizative.....	13
	C. Korniza ligjore	16
III.	VËREJTJE PARAPRAKE LIDHUR ME LIRIMIN E PËRKOHSHËM.....	19
	A. Paraburgimi.....	21
	B. Neni 8 i KEDNj-së	26
	C. Paraburgimi pas shpalljes së pafajësisë	27
	D. Konkluzioni	28
IV.	VËREJTJE PARAPRAKE MBI TË DREJTËN PËR NJË GJYKATË KOMPETENTE, TË PAVARUR DHE TË PAANSHME TË THEMELUAR ME LIGJ	28
	A. E drejta për një gjykatë kompetente, të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj .	29
	B. Praktika e zgjedhur	36
	C. Konkluzioni	46
V.	VËREJTJE PARAPRAKE MBI PRANUESHMËRINË E PROVAVE	48
	A. Parimet e përgjithshme	48
	B. Rregullat përjashtuese.....	50
	C. Provat e paverifikuara.....	53
	D. Pranueshmëria e dokumenteve të siguruara nga autoritetet serbe.....	55
	E. Konkluzioni	61
VI.	VËREJTJE PARAPRAKE MBI PARIMIN E BARAZISË SË ARMËVE	62
	A. Sfidat.....	62
	B. Marrja në pyetje nga trupi gjykues.....	70
	C. Konkluzioni	75
VII.	VËREJTJE PARAPRAKE MBI PARIMIN E LIGJSHMËRISË.....	76
	A. <i>Nulla crimen sine lege</i> në nivel ndërkombëtar	78
	B. <i>Nullum crimen sine lege</i> në nivel vendor	81
	C. Lex mitior	86
	D. Konkluzioni	93
VIII.	KONKLUZIONI.....	96

I. HYRJE & METODOLOGJIA

1. Shkalla në të cilën tribunale bashkëkohore penale ndërkombëtare respektojnë të drejtat e të akuzuarve ka rëndësi jo vetëm për legjitimitetin e tyre në procedura penale konkrete, por edhe për trashëgiminë që lënë prapa në drejtësinë penale ndërkombëtare në kuptim më të gjerë.¹ Ky fakt është theksuar në mënyrë të fuqishme dhe të qëndrueshme nga Kryeprokurori i Shteteve të Bashkuara, Robert Jackson, në deklaratën e tij hyrëse para Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar në Nuremberg në vitin 1945:

“T’u servirësh këtyre të pandehurve një kupë me helm do të thotë ta vëmë atë helm edhe në buzët tona. Ne duhet të dëshmojmë një shkallë të tillë paanshmërie dhe integriteti intelektual në përmbushjen e detyrës sonë, në mënyrë që ky Gjykim t’u rekomandohet brezave të ardhshëm si përmbushje e aspiratave të njerëzimit për drejtësi ... [Ne] kemi marrë përsipër barrën e pjesëmarrjes në një përpjekje të ndërlikuar për t’u siguruar atyre gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo është garancia më e njohur mbrojtëse për çdo person që ka një mbrojtje që meriton të dëgjohet.”²

2. Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK), gjykatë kjo, e themeluar sipas ligjeve të Kosovës, por me seli në Hagë, dhe e ngarkuar me gjykimin e ish-figurave të larta të një lëvizjeje çlirimtare që ende gëzon legjitimitet të madh popullor në mesin e popullsisë së cilës i ka shërbyer, ky parim merr një peshë të veçantë.³ Gjykata vepron nën presion të jashtëzakonshëm politik dhe të sigurisë, në një kontekst më të gjerë në të cilin procedurat penale ndërkombëtare jo gjithmonë i kanë përmbushur standardet e tyre dhe në të cilin karakteri i veçantë i këtyre procedurave penale ka shërbyer herë pas here për të cenuar, në vend se për të forcuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut që u garantohen të akuzuarve në nivel vendor.⁴

¹ Y. McDermott, ‘The Right to a Fair Trial in Practice in International Criminal Trials’, në *Fairness in International Criminal Trials*, OUP (2016), fq. 41

² Nuremberg Trial Proceedings, Vëll. 2, fq. 100, 21 nëntor 1945, Deklarata hyrëse e z. Justice Jackson, Kryeprokuror për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, siç citohet në Y. McDermott, *Fairness in International Criminal Trials*, OUP (2016), fq. 1.

³ G. Visoka, *Assessing the Potential Impact of the Kosovo Specialist Court*, shtator 2017, PAX, fq. 8–9.

⁴ Göran Sluiter, *Human Rights in International Criminal Proceedings - The Impact of the Judgment of the Kosovo Specialist Chambers of 26 April 2017*, 27 *Wm. & Mary Bill Rts. J.* 623 (2019), <https://scholarship.law.wm.edu/wmbrj/vol27/iss3/3>; D. Robinson, *The Identity Crisis of International Criminal Law*, *Leiden Journal of International Law*, 21 (2008), fq. 925–963, fq. 927; Yvonne McDermott, ‘The Right to a Fair Trial in Practice in International Criminal Trials’, në *Fairness in International Criminal Trials* (OUP, 2016); Fairlie, ‘Due Process Erosion: The Diminution of Live Testimony at the ICTY’ (2003) 34 *California Western International Law Journal* 47.

3. Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës i ka kërkuar BHRC-së të kryejë një rishikim dhe vlerësim të pavarur të shkallës në të cilën DhSK-ja respekton standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut. Ky rishikim është realizuar pa asnjë kontribut nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, me qëllim garantimin e pavarësisë së tij.
4. Ky raport përbën një “*Vlerësim Paraprak*”. Raporti nuk synon të trajtojë tërësinë e çështjeve të të drejtave të njeriut ashtu siç ato manifestohen në procedurat penale pranë DhSK-së. Përkundrazi, u përgjigjet çështjeve specifike të identifikuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës për shqyrtim, përkatësisht ka të bëjë me:
 - a. Lirimin e përkohshëm, përfshirë kohëzgjatjen e paraburgimit dhe monitorimin e komunikimeve dhe vizitave familjare;
 - b. Të drejtën për një gjykatë kompetente, të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj, përfshirë procesin e emërimit të gjykatësve dhe mungesën e gjykatësve nga Kosova;
 - c. Pranueshmërinë e provave, përfshirë dokumentet e siguruara nga Serbia;
 - d. Parimin e barazisë së armëve;
 - e. Parimin e ligjshmërisë;
 - f. Llogaridhënien e DhSK-së, përfshirë detyrimet e saj raportuese ndaj shteteve të huaja dhe partnerëve ndërkombëtarë që kanë luajtur rol kyç në krijimin dhe financimin e Dhomave të Specializuara.
5. Këto janë tema jashtëzakonisht të gjera dhe komplekse, dhe edhe çështje të tjera përtej atyre të identifikuara do të kishin merituar analizë. Për më tepër, ky rishikim është realizuar brenda një afati kohor sfidues. Për këtë arsye, analiza në këtë raport është përqendruar në identifikimin e atyre aspekteve të një çështjeje të caktuar që ngritin shqetësime të menjëhershme lidhur me pajtueshmërinë me të drejtat e njeriut në

praktikën e DhSK-së. Analiza që e mbështet diskutimin nuk është shteruese dhe nuk çon domosdoshmërisht në konkluzione përfundimtare mbi pajtueshmërinë ose mospajtueshmërinë me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut. Megjithatë, analiza është e qëndrueshme dhe shërben për të përcaktuar dhe artikuluar në mënyrë të qartë çështjet e identifikuara.

6. Raporti është hartuar bashkërisht nga dy autorë **Dr. Gus Waschefort** (4-5 Gray's Inn Square) dhe **Lauren Lederle** (Outline Chambers⁵), dhe i është nënshkruar një rishikimi të pavarur nga **profesori Kevin Jon Heller** (Doughty Street Chambers dhe Universiteti i Kopenhagës) dhe **Haydee Dijkstra** (33 Bedford Row). Metodologjia ka përfshirë hulumtim në bazë dokumentare të kombinuar me analizë doktrimore, duke u përqendruar në burime primare, jurisprudencë dhe burime sekondare. Autorët kanë përfituar nga diskutimet me disa anëtarë të ekipeve ligjore të angazhuar rishtazi ose të përfshirë në mënyrë aktive në rastit në zhvillim e sipër pranë DhSK-së. Qëllimi i këtyre diskutimeve ishte të ndihmonte në identifikimin e burimeve, veçanërisht të parashtrësave dhe dorëzimeve të bëra gjatë procesit të gjyimit dhe gjatë paraqitjes së ankesave. Këto diskutime janë zhvilluar në mënyrë anonime, në frymën e rregullave të Chatham House dhe janë kufizuar në çështje të informacionit publikisht të disponueshëm. Diskutimet nuk janë konsideruar dhe në fakt nuk përbëjnë burim informacioni apo të dhënash në raport dhe nuk kanë ndikuar në përzgjedhjen e temave apo në konkluzionet e arritura nga autorët.

II. STRUKTURA INSTITUCIONALE E DhSK-së

A. **Origjina dhe themelimi i Dhomave të Specializuara**

7. DhSK-ja, krimet që ndjek penalisht, individët që i gjykon dhe mjedisi politik në të cilin vepron, nuk mund të vlerësohen në mënyrë të izoluar. Kjo pjesë paraqet sfondin e domosdoshëm për të kuptuar se përse është krijuar gjykata, si u krijua, dhe cilat janë sfidat e dukshme që kanë formësuar themelimin e saj dhe që ndihmojnë në orientimin e analizës në këtë raport.

Konflikti Kosovë / Serbi

⁵ Guernica 37 Chambers tani është Outline Chambers.

8. Konflikti i armatosur në Kosovë gjatë viteve 1998 dhe 1999 përbën sfondin historik të themelimit të Dhomave të Specializuara. Kosova kishte qenë prej kohësh një krahinë vetëqeverisëse e Serbisë, por në vitin 1989, presidenti serb Slobodan Milosheviq ia hoqi asaj këtë status, duke i shtyrë shqiptarët e Kosovës drejt përpjekjeve për pavarësi të plotë.⁶ Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) u shfaq në vitin 1990⁷. Në vitin 1998, ajo kishte nisur një kryengritje të hapur kundër sundimit serb. Forca shtesë të policisë dhe ushtrisë u dërguan për të shtypur kryengritjen, dhe gjatë kësaj kohe forcat serbe shënjestruan ashpër civilët, duke bombarduar fshatra dhe duke detyruar shqiptarët e Kosovës të largoheshin.⁸
9. Negociatat e paqes të ndërmjetësuara në nivel ndërkombëtar në Rambouillet dështuan në fillim të vitit 1999 dhe NATO-ja ndërhyri ushtarakisht në mars të po atij viti.⁹ Forcat serbe reagueshan duke intensifikuar persekutimin e civilëve shqiptarë. Milošević në fund pranoi të tërhiqte forcat e tij¹⁰, dhe Operacioni “Allied Force” i NATO-s u pezullua më 10 qershor pas 78 ditësh.¹¹ Baza ligjore e asaj ndërhyrjeje ishte, dhe mbetet, në masë të madhe e kontestuar, me ç’rast shumica e shteteve dhe të studiuesve e kundërshtojnë ligjshmërinë e saj.¹²

⁶ James Pettifer, *The Kosova Liberation Army: Underground War to Balkan Insurgency, 1948–2001* (Hurst 2013), f. 56; “Autonomy Abolished: How Milošević Launched Kosovo’s Descent into War” (Balkan Insight, 23 mars 2020) <https://balkaninsight.com/2020/03/23/autonomy-abolished-how-milosevic-launched-kosovos-descent-into-war/btj/> (aksesuar më 25 prill 2026).

⁷ James Pettifer, *The Kosova Liberation Army: Underground War to Balkan Insurgency, 1948-2001* (Hurst 2013), f. 60-64.

⁸ Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë i Kombeve të Bashkuara, “Konfliktet” (Mekanizmi Ndërkombëtar Rezidual i Kombeve të Bashkuara për Tribunalet Penale). <https://www.icty.org/en/about/what-former-yugoslavia/conflicts>

⁹ Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Kosovo/Kosova: As Seen, As Told — An Analysis of the Human Rights Findings of the OSCE Kosovo Verification Mission, October 1998 to June 1999* (OSCE/ODIHR 1999) <https://www.osce.org/odihr/17772> (qasur më 25 prill 2026).

¹⁰ Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë i Kombeve të Bashkuara, “Konfliktet” (Mekanizmi Ndërkombëtar Rezidual i Kombeve të Bashkuara për Tribunalet Penale). <https://www.icty.org/en/about/what-former-yugoslavia/conflicts>

¹¹ NATO, “Fushata ajrore në Kosovë (mars – qershor 1999): Operacioni Allied Force” (NATO, përditësuar më 21 tetor 2024). <https://www.nato.int/en/what-we-do/operations-and-missions/kosovo-air-campaign-march-june-1999>

¹² Shih, për shembull, gamën e mëposhtme të pikëpamjeve: F. L. Kirgis, *The Kosovo Situation and NATO Military Action*, ASIL Vol. 4 Issue 1, 12 March 1999; B. Simma, *NATO, the UN and the Use of Force: Legal Aspects*, EJIL 1999; D. Bethlehem KC, *Stepping Back: The Legal Basis in Favour of a Principle of Humanitarian Intervention*, EJIL:Talk!, 12 September 2013; <https://www.ejiltalk.org/stepping-back-a-moment-the-legal-basis-in-favour-of-a-principle-of-humanitarian-intervention/>; Christine Chinkin, “Ligjshmëria e veprimit të NATO-s në ish-Republikën e Jugosllavisë (FRY) sipas së drejtës ndërkombëtare” (2000) 49 *International & Comparative Law Quarterly* 4, 910-925.

10. UÇK-ja lindi nga konflikti si një lëvizje çlirimtare me rëndësi të madhe popullore brenda Kosovës.¹³

Del Ponte dhe akuzat për trafikim organesh

11. Çështja e krimeve që supozohet se janë kryer nga UÇK-ja ka qenë e pranishme gjatë përpjekjeve për llogaridhënie qysh prej pas luftës. Carla Del Ponte ka shërbyer si Kryeprokurore e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) nga viti 1999 deri në vitin 2007. Në vitin 2008, pas largimit të saj, ajo botoi një memoar me titull *Madame Prosecutor*, në të cilin pretendoi se anëtarë të rangut të lartë të UÇK-së kishin kryer krime serioze kundër të burgosurve serbë, përfshirë heqjen e detyruar të organeve njerëzore për qëllime trafikimi.¹⁴
12. Këto pretendime “*shkakatuan tronditje në mbarë botën*” dhe “*u mohuan kategorikisht në Kosovë*.”¹⁵
13. Në reagimin e saj, Zyra e Prokurorit të TPNJ-së (ZPT) pranoi se në vitet 2002-2003, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) e kishte informuar për pretendime se kishte persona që ishin rrëmbyer në Kosovë dhe ishin dërguar në Shqipëri, ku u ishin hequr organet, dhe se autoritetet serbe gjithashtu kishin qenë në dijeni të këtyre pretendimeve në atë kohë. ZPT-ja më tej kishte deklaruar se ishte kryer një hetim paraprak së bashku me UNMIK-un dhe me autoritetet shqiptare, përfshirë një vizitë në një lokacion në veri të Shqipërisë, por se këto pretendime nuk kishte qenë e mundur të vërtetoheshin dhe se rasti i ishte referuar UNMIK-ut dhe autoriteteve shqiptare si autoritete kompetente.¹⁶

Raporti Marty

14. Pretendimet e Del Pontes nxitën një hetim zyrtar nën drejtimin e Këshillit të Evropës. Asambleja Parlamentare e Këshillit ngarkoi Komitetin për Çështje Ligjore dhe të Drejtat

¹³ James Pettifer, *The Kosova Liberation Army: Underground War to Balkan Insurgency, 1948–2001* (Hurst 2013), f. 221.

¹⁴ Carla Del Ponte and Chuck Sudetic, *Madame Prosecutor: Përballjet me kriminelët më të këqij të njerëzimit dhe kulturën e pandëshkueshmërisë* (Other Pr LLC, 2009).

¹⁵ Dean B. Pineles, “Trashëgimia e diskutueshme e Dick Marty-t në Kosovë” (Balkan Insight, 26 prill 2022) i disponueshëm [këtu](#).

¹⁶ Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë i Kombeve të Bashkuara, “Pikat kryesore të periudhës 14/04/2008–25/04/2008 – Nr. 35” (*The ICTY Digest*, 28 prill 2008) Shih [këtu](#).

e Njeriut me shqyrtimin e çështjes dhe caktoi senatorin zviceran Dick Marty si raportues.¹⁷

15. I publikuar pas një hetimi dyvjeçar, Raporti Marty pasqyrooi shumë nga pretendimet e Del Pontes. Raporti identifikoi anëtarë të lartë të UÇK-së (të gjithë pjesë e të ashtuquajturit Grupi i Drenicës) dhe i akuzoi ata për vrasje, rrëmbime, torturë, zhdukje me forcë, përfshirje në krim të organizuar dhe trafikim organesh.¹⁸ Ndër personat e përmendur ishte Hashim Thaçi, Kryeministër i Kosovës në atë kohë, i cili nga Marty u karakterizua si “bos” i krimit të organizuar,¹⁹ dhe Kadri Veseli,²⁰ ish-kreu i Shërbimit të Inteligjencës dhe një nga themeluesit e UÇK-së, i cili më vonë u bë Kryetar i Kuvendit. Viktimat e supozuara përfshinin serbë, anëtarë të grupeve të pakicave etnike dhe kundërshtarë politikë.²¹
16. Marty më tej pretendoi: *“Mbështetja politike dhe diplomatike e Thaçit nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqitë e tjera perëndimore [...] i ka dhënë Thaçit, sidomos në bindjen e tij personale, ndjesinë e të qenit ‘i paprekshëm’”*.²² Ai gjithashtu pretendoi: *“E gjithë bashkësia ndërkombëtare në Kosovë – nga qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe ato të fuqive të tjera perëndimore aleate, deri te autoritetet e drejtësisë të mbështetura nga Bashkimi Evropian – pa dyshim posedon të njëjtin dokumentacion të bollshëm mbi shtrirjen e plotë të krimeve të Grupit të Drenicës, por askush nuk duket i gatshëm të reagojë përballë një situatë të tillë dhe t’i vërë autorët përpara përgjegjësisë.”*²³
17. Marty më vonë sqaroi se raporti i tij nuk e akuzonte Thaçin për përfshirje të drejtpërdrejtë në trafikim organesh, por se bashkëpunëtorët e tij të afërt ishin të implikuar dhe se ishte e vështirë të besohej se Thaçi nuk kishte qenë në dijeni.²⁴

¹⁷ Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Komiteti për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Dok. 12462, Raport: Trajtimi çnjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë, 7 janar 2011 (“**Raporti Marty**”).

¹⁸ Raporti Marty.

¹⁹ Raporti Marty, par. 58.

²⁰ Raporti Marty, par. 68, 72.

²¹ Raporti Marty, par. 88.

²² Raporti Marty, par. 60.

²³ Raporti Marty, par. 71.

²⁴ “Dick Marty sqaron pretendimet për trafikim organesh”, Balkan Insight, 19 janar 2011, e disponueshme [këtu](#).

18. Ashtu si edhe pretendimet e Del Pontes, Raporti Marty tërhoqi vëmendje dhe reagim të gjerë ndërkombëtar dhe u dënua ashpër, si dhe u mohua kategorikisht nga personat e përmendur dhe nga shoqëria kosovare në përgjithësi.²⁵

TFHS / EULEX

19. Në vitin 2011, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (“**EULEX**”) autorizoi një hetim penal lidhur me gjetjet e Raportit Marty, duke krijuar Task-Forcën Hetimore Speciale të BE-së (**TFHS**), e udhëhequr nga Clint Williamson, ish-Ambasador i Shteteve të Bashkuara për Çështjet e Krimeve të Luftës. TFHS-ja kishte mandatin të hetonte dhe, nëse do të ishte e arsyeshme, të ndiqte penalisht individët për krimet e pretenduara në raportin e Këshillit të Evropës.²⁶
20. Në korrik 2014, Williamson njoftoi se task-forca ishte në gjendje të ngrinte aktakuza ndaj disa zyrtarëve të UÇK-së. Për sa i përket trafikimit të organeve, konkludoi se një numër i vogël individësh ishin vrarë me qëllim të nxjerrjes dhe shitjes së organeve të tyre, në përputhje me gjetjen e Raportit Marty se një “grusht” individësh ishin subjekt i këtij krimi, por pranoi se provat e nevojshme për ndjekje penale ende nuk ishin siguruar.²⁷
21. Williamson rekomandoi që çdo aktakuzë të ngrihej para një gjykate të posaçme të krijuar për këtë qëllim, dhe jo brenda sistemit ekzistues gjyqësor të EULEX-it në Kosovë. Ai gjithashtu vuri në dukje se TFHS-ja kishte hasur sfida serioze për shkak të një klime intimidimi që synonte të minonte hetimet ndaj individëve të lidhur me ish-UÇK-në.²⁸

Themelimi i DhSK-së

22. Në prill 2014, Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian (**BE**), Catherine Ashton, shkëmbeu letra me Presidenten e Kosovës, Atifete Jahjaga, duke iniciuar procesin për krijimin e DhSK-së.²⁹ Gjatë vitit pasues, gjykata u kundërshtua fuqishëm në politikën e

²⁵ Dean B. Pineles, “Trashëgimia e debatueshme e Dick Marty në Kosovë”, Balkan Insight, 26 prill 2022, e disponueshme [këtu](#)

²⁶ RECOM (Rrjeti i Pajtimit), “Deklaratë e Kryeprokurorit të Task-Forcës së Posaçme Hetimore (SITF) mbi gjetjet hetimore në Kosovë” (RECOM, 29 korrik 2014) e disponueshme [këtu](#).

²⁷ *Ibid*

²⁸ *Ibid* (n 26)

²⁹ Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, “Ligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare (“Shkëmbimi i letrave”)” (Dhomat e Specializuara të Kosovës, 23 prill 2014), i disponueshëm [këtu](#).

brendshme të Kosovës.³⁰ Më 3 gusht 2015, nën presion të konsiderueshëm nga BE-ja, ShBA-ja dhe fuqitë e tjera perëndimore, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet në Kushtetutën e Kosovës për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe njësisë së saj prokuroriale, Zyrës së Prokurorit të Specializuar (**ZPS**).³¹ Ndër personat e mëvonshëm të akuzuar nga DhSK-ja ishin dy prej figurave që kishin mundur të themelin e saj: Veseli, i cili, si Kryetar i Kuvendit, kishte nënshkruar ndryshimin kushtetues dhe po ashtu edhe “Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar” (**Ligji për DhSK-në**),³² dhe Thaçi, i cili, si zëvendëskryeministër, kishte dhënë mbështetje politike për miratimin e tij.³³ Të dy u akuzuan në vitin 2020 dhe aktualisht janë në gjykim në fazën e kuvendimit; prokuroria ka kërkuar dënim prej 45 vjetësh për secilin.

23. Kundërshtimi ndaj DhSK-së nuk u zbeh pas miratimit të legjislacionit. Në dhjetor 2017, një grup deputetësh nënshkruan një kërkesë për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme për shfuqizimin e Ligjit për DhSK-në.³⁴ Reagimi ndërkombëtar ishte i shpejtë dhe i prerë. ShBA-ja u deklarua “*thelësisht e shqetësuar*” dhe u bëri thirrje udhëheqësve politikë të Kosovës që të ruanin përkushtimin ndaj gjykatës dhe të mos ndryshonin juridiksionin e saj. Ambasadori i ShBA-së në Kosovë paralajmëroi se shfuqizimi i DhSK-së do të kishte “*pasojë thellësisht negative për të ardhmen e Kosovës si pjesë e Evropës*” dhe do të “*konsiderohej nga Shtetet e Bashkuara si thikë pas shpine*.”³⁵
24. Edhe pse tentativa për shfuqizimin e DhSK-së dështoi, ajo evidentoi nivelin e lartë të kundërshtimit të brendshëm që do të vijonte ta shoqëronte gjykatën përgjatë gjithë ekzistencës së saj.³⁶

³⁰ S. Steininger, “Dhomat e Specializuara të Kosovës – një kapitull i ri për drejtësinë penale ndërkombëtare në Ballkan”, Völkerrechtsblog, 14 mars 2018, e disponueshme [këtu](#).

³¹ Aidan Hehir, “Supozimet që qëndrojnë në themel të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe implikimet e tyre” (2020) 20 *International Criminal Law Review* 1, 17 dhe 27; Dean P. Bineles, “Vendimi ndaj Thaçit do të përcaktojë trashëgiminë e Dhomave të Specializuara të Kosovës” (Balkan Insight, 4 mars 2026).

³² Ligji nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Kosovë), 3 gusht 2015, i disponueshëm [këtu](#).

³³ Dean P. Bineles, “Vendimi ndaj Thaçit do të përcaktojë legjitimitetin e Dhomave të Specializuara të Kosovës” (Balkan Insight, 4 mars 2026). <https://balkaninsight.com/2026/03/04/thaci-trial-verdict-will-decide-legacy-of-kosovo-specialist-chambers/btj/>

³⁴ Aidan Hehir, “Mësime të nxjerra? Mungesa e legjitimitetit vendor të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe implikimet e saj” (2019) 20 *Human Rights Review* 267, 268.

³⁵ A. Hehir, Supozimet që qëndrojnë në themel të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe implikimet e tyre, 20 INT’L CRIM. L. REV. 17, 27 (2020), duke cituar Erjone Popova, “Kuvendi i Kosovës dështon të mblidhet për votimin mbi shfuqizimin e ‘Gjykatës së Specializuar’”, (*Prishtina Insight*, 22 dhjetor 2017) <https://prishtinainsight.com/kosovo-assembly-fails-convenc-vote-revocation-special-court>.

³⁶ S. L. Ochs & K. Walters, Drejtësi e imponuar: Dhomat e Specializuara të Kosovës, *Duke Journal of Comparative & International Law*, Vol. 32:239, në fq. 269-273

B. Mandati, Juridiksioni dhe Struktura Organizative

25. Përcaktimi i mandatit të DhSK-së me saktësi është i vështirë. Kushtetuta parasheh se DhSK-ja dhe ZPS-ja shërbejnë për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës lidhur me Raportin e Këshillit të Evropës. Ligji për DhSK-në më tej parasheh se DhSK-ja dhe ZPS-ja shërbejnë:

“Për garantimin e procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase lidhur me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, krime të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës ... dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale të kryera nga Task Force Hetimore Speciale (“TFHS”) e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (“PSRK”).”³⁷

26. Duke qenë se theksi i Raportit të Këshillit të Evropës është te “*krimi i organizuar*” dhe tregtia e paligjshme me organe – çështje që nuk janë ndjekur penalisht nga DhSK-ja – bëhet e qartë se mandati i DhSK-së ka pësuar ndryshim.³⁸ Mandati i saj mund të kuptohet më mirë nëpërmjet juridiksionit të saj dhe natyrës së rasteve, të kaluara dhe aktuale, në regjistrin e saj gjyqësor. Një lexim i tillë e konfirmon mandatin e saj si të përqendruar në ndjekjen penale të ish-udhëheqësve të UÇK-së përgjegjës për kryerjen e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit gjatë luftës në Kosovë. Juridiksioni personal dhe territorial i DhSK-së mundëson ndjekjen penale edhe të individëve të tjerë përveç anëtarëve të UÇK-së. Megjithatë, fokusi më i ngushtë ndaj UÇK-së buron nga Raporti i Këshillit të Evropës, marrëveshja me BE-në lidhur me mandatin e EULEX-it³⁹ dhe realiteti më i gjerë politik në të cilin është themeluar DhSK-ja. Kjo mbetet një çështje me shumë polemika.⁴⁰

27. Juridiksioni i DhSK-së përcaktohet në Ligjin për DhSK-në:

³⁷ Neni 1(2) i Ligjit për DhSK-në.

³⁸ Për diskutim të mëtejshëm, shih Michela Frulli, “Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës: kthesa e Kosovës drejt komplementaritetit?” (2016) 14(1) *Journal of International Criminal Justice* 65, 68–70.

³⁹ Ligji Nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, 23 prill 2014.

⁴⁰ Shih, për shembull, Gëzim. Visoka, “Vlerësimi i ndikimit potencial të Dhomave të Specializuara të Kosovës”, PAX (shtator 2017), fq. 26.

- a. **Juridiksioni lëndor:** DhSK-ja ka juridiksion të kufizuar lëndor lidhur me një nëngrup të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit të përcaktuara në Ligjin për DhSK-në, por të definuara sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së veprës, si dhe për disa vepra penale vendore kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike; rendit publik; korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, siç përcaktohen në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012.⁴¹
 - b. **Juridiksioni kohor:** juridiksioni kohor i DhSK-së përfshin vetëm krimet ndërkombëtare të kryera ndërmjet 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000.⁴² Megjithatë, juridiksioni lëndor lidhur me veprat penale vendore kufizohet në ato vepra që lidhen me procedurat penale zyrtare pranë DhSK-së ose me zyrtarët e tyre.⁴³ Rrjedhimisht, ky kufizim kohor nuk përjashton ndjekjen penale të veprave si intimidimi i dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor.
 - c. **Juridiksioni territorial:** DhSK-ja ka juridiksion për krimet e filluara ose të kryera në territorin e Kosovës.⁴⁴
 - d. **Juridiksioni personal:** juridiksioni personal i DhSK-së kufizohet në persona fizikë dhe përfshin juridiksionin aktiv dhe pasiv të personalitetit.⁴⁵ Rrjedhimisht, DhSK-ja ka juridiksion për krimet e kryera nga ose kundër shtetasve të Kosovës ose të Republikës Federale të Jugosllavisë, pavarësisht vendit të kryerjes së veprës.
28. DhSK-ja përgjithësisht trajtohet në kontekstin e tribunaleve penale ndërkombëtare. Megjithatë, DhSK-ja është një mekanizëm i përkohshëm *sui generis* me tensione dhe kontradikta të pranishme gjatë gjithë konceptimit të saj. Ajo është krijuar mbi bazën e angazhimeve ndërkombëtare, e mandatuara për të ndjekur penalisht vepra penale ndërkombëtare dhe e përbërë nga gjykatës ndërkombëtarë, por është e qartë se është institucion vendor i themeluar në bazë të Kushtetutës së Kosovës dhe i cili vepron sipas ligjeve të Kosovës.⁴⁶ Kjo nuk është çështje semantike, por çështje me pasoja të rëndësishme, veçanërisht për sa i përket funksionimit të DhSK-së brenda kornizës së një

⁴¹ Neni 6, i lexuar së bashku me nenet 12-14 të Ligjit për DhSK-në.

⁴² Neni 7 i Ligjit për DhSK-në.

⁴³ Neni 6, i lexuar së bashku me nenin 15 të Ligjit për DhSK-në.

⁴⁴ Neni 8 i Ligjit për DhSK-në.

⁴⁵ Neni 9 i Ligjit për DhSK-në.

⁴⁶ Neni 162(1) i Kushtetutës së Kosovës.

kushtetute me fuqi më të lartë juridike. Kjo ka ndikim në çështje si legjitimiteti dhe llogaridhënia. Përtej interpretimit të veprave penale materiale, karakteri vendor i DhSK-së e bën krahasimin e saj me gjykata dhe tribunale ndërkombëtare me dobi të kufizuar.

29. Strukturalisht, DhSK-ja dhe ZPS-ja janë institucione të ndara dhe të pavarura, secila me personalitet të plotë juridik.⁴⁷ Dhomat përbëhen nga katër dhoma të veçanta dhe nga Zyra Administrative. Të katër dhomat janë të organizuara sipas strukturës së gjyqësorit në Kosovë dhe përfshijnë: Dhomën e Gjykatës Themelore; Dhomën e Gjykatës së Apelit; Dhomën e Gjykatës Supreme; dhe Dhomën e Gjykatës Kushtetuese. Emërimi dhe caktimi i gjykatësve trajtohet në raportin kryesor.⁴⁸

a. **Dhoma e Gjykatës Themelore** - është dhoma e shkallës së parë për procedurat penale pranë DhSK-së dhe përfshin Dhomën e Procedurës Paraprake dhe Dhomat e Gjykimit.

b. **Dhoma e Gjykatës së Apelit** - vepron si organ i shkallës së dytë lidhur me aktgjykimet e trupave gjykues.⁴⁹

c. **Dhoma e Gjykatës Supreme** - kryen disa funksione të rezervuara, përfshirë veprimin si organ i shkallës së tretë të apelit lidhur me vendime të caktuara të Dhomës së Apelit;⁵⁰ dhe shqyrtimin e kërkesave për mjete juridike të jashtëzakonshme siç përcaktohen në Ligjin për DhSK-në.⁵¹

d. **Dhoma e Gjykatës Kushtetuese** - trajton ekskluzivisht çdo referim kushtetues që lidhet me Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në.

30. Statusi dhe funksionet e ZPS-së përcaktohen dhe rregullohen me Ligjin për DhSK-në.⁵² ZPS-ja udhëhiqet nga Prokurori i Specializuar, i cili ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur nga DhSK-ja. Prokurori i Specializuar dhe prokurorët shërbejnë kryesisht për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale brenda juridiksionit të DhSK-së.⁵³

⁴⁷ Neni 4 i Ligjit për DhSK-në.

⁴⁸ Shih më poshtë, “Emërimi i Gjykatësve” dhe “Caktimi i Gjykatësve”.

⁴⁹ Neni 46 i Ligjit për DhSK-në.

⁵⁰ Neni 47 i Ligjit për DhSK-në.

⁵¹ Neni 48 i Ligjit për DhSK-në.

⁵² Neni 35 i Ligjit për DhSK-në.

⁵³ Neni 24(2) i Ligjit për DhSK-në.

Megjithatë, siç parashihet në Ligjin për DhSK-në, ata kanë një gamë të gjerë detyrash dhe kompetencash ndihmëse përveç funksionit të tyre kryesor.⁵⁴

31. Zyra Administrative udhëhiqet nga Administratori dhe është përgjegjëse për administrimin e DhSK-së dhe të gjitha funksioneve të lidhura me të.⁵⁵ Zyra Administrative përfshin Zyrën për Pjesëmarrjen e Viktimave; Zyrën e Mbrojtjes; Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve; Njësinë për Menaxhimin e Paraburgimit; dhe Zyrën e Ombudspersonit.⁵⁶

C. Korniza ligjore

32. Klima politike në të cilën u themelua DhSK-ja ishte e lidhur ngushtë me angazhimet ndërkombëtare për të siguruar llogaridhënie, të nxjerra nga Raporti i Këshillit të Evropës dhe të ndërmarra nga Kosova në raport me BE-në lidhur me mandatin e EULEX-it.⁵⁷ Megjithatë, këto angazhime kanë të bëjnë me krijimin e një institucioni vendor të Kosovës, jo të një institucioni ndërkombëtar. Siç u diskutua më sipër, për t'u dhënë efekt këtyre angazhimeve ndërkombëtare, përmes veprimeve të koordinuara legislative, më 3 gusht 2015, Kosova miratoi ndryshimin kushtetues për miratimin e nenit 162 të Kushtetutës si dhe Ligjin për DhSK-në.⁵⁸
33. Neni 162 i Kushtetutës parashihet themelimin e DhSK-së dhe të ZPS-së “*brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës*”⁵⁹ dhe se këto institucione “*rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë*”. DhSK-ja dhe ZPS-ja janë unike në kompleksitetin e tyre të konceptimit. Ndryshe nga mekanizmat ndërkombëtarë penalë, të cilët veprojnë në mënyrë autonome dhe jashtë strukturave ekzistuese vendore, DhSK-ja është e vendosur brenda sistemit gjyqësor të Kosovës. Prandaj, Ligji për DhSK-në është dashur ta rregullonte në mënyrë të detajuar vendin e duhur të DhSK-së/ZPS-së brenda këtyre strukturave ekzistuese. Stafi ndërkombëtar i DhSK-së/ZPS-së dhe fakti që selia e saj kryesore ndodhet në Hagë e komplikojnë marrëdhënien e saj me gjykatat dhe akterët e tjerë në sistemin gjyqësor të

⁵⁴ Neni 35 i Ligjit për DhSK-në.

⁵⁵ Neni 34(1)-(2) i Ligjit për DhSK-në.

⁵⁶ Neni 34(6)-(12) i Ligjit për DhSK-në.

⁵⁷ Ligji Nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, 23 prill 2014.

⁵⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Amendamenti nr. 21, 3 gusht 2015.

⁵⁹ Theks i shtuar.

Kosovës. Ligji për DhSK-në përcakton në detaje tiparet institucionale, funksionimin dhe kornizën ligjore të DhSK-së dhe ZPS-së.

34. Meqenëse Kosova nuk është as anëtare e Këshillit të Evropës dhe as e Kombeve të Bashkuara, ajo nuk ka mundësi ta ratifikojë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**KEDNJ**) apo ndonjë nga traktatet kryesore të OKB-së për të drejtat e njeriut. Megjithatë, neni 22 i Kushtetutës së Kosovës parasheh përfshirjen e drejtpërdrejtë në të drejtën e brendshme të tetë instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (1948); KEDNJ-në dhe Protokollet e saj; dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (**KNDCP**).⁶⁰ Efekti juridik i kësaj përfshirjeje është që dispozitat materiale të këtyre instrumenteve të jenë të zbatueshme në Republikën e Kosovës si burim i së drejtës së brendshme dhe, në rast konflikti, kanë përparësi ndaj së drejtës së përgjithshme të brendshme.⁶¹
35. Një përfshirje e tillë e drejtpërdrejtë përbën një mjet efektiv për krijimin e një kornize të fuqishme vendore për të drejtat e njeriut.⁶² Megjithatë, përfshirja e instrumenteve të mbivendosura, por jo identike, të të drejtave të njeriut krijon mundësinë e fragmentimit normativ. Ky shqetësim zbutet përmes nenit 53 të Kushtetutës, i cili trajton interpretimin e dispozitave për të drejtat e njeriut dhe përcakton: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*. Efekti praktik i kësaj është që KEDNJ-ja gëzon një pozitë të privilegjuar në të drejtën dhe praktikën e Kosovës. Neni 3(2)(a) dhe (e) i Ligjit për DhSK-në përcakton që Dhomat e Specializuara të gjykojnë dhe të veprojnë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë standardet e parapara sipas KEDNJ-së dhe KNDCP-së.

⁶⁰ Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës, i ndryshuar me Amendamentin Kushtetues Nr. 26, përfshin në të drejtën e brendshme të Kosovës këto traktate ndërkombëtare për të drejtat e njeriut: Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj; Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e tij; Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventën për të Drejtat e Fëmijës; Konventën kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Jonjerëzor dhe Poshtëruar; si dhe Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

⁶¹ Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës.

⁶² Ndoshta mangësia kryesore e kornizës vendore për të drejtat e njeriut në Kosovë është mungesa e mbrojtjes efektive e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.

36. Përfshirja e shprehur e standardeve të KEDNj-së, në vend të formulimit të paqartë të “*të drejtave të njeriut të njohura ndërkombëtarisht*”, të parapara në nenin 21(3) të Statutit të Romës, përbën një fuqizim potencialisht të rëndësishëm të kornizës së të drejtave të aplikueshme para një gjykate penale ndërkombëtare (të ndërkombëtarizuar).⁶³ Siç kanë potencuar disa autorë, formulimi i KEDNj-së shmang paqartësitë që shoqërojnë standardin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (**GjPN**) dhe i mbështet detyrimet e DhSK-së në një jurisprudencë të zhvilluar dhe të zbatueshme.⁶⁴ Për më tepër, “*referenca ndaj KEDNj-së në Kushtetutën e Kosovës i bën këto të drejta të justifikueshme, pasi në përputhje me nenin 49 të Ligjit për DHSK-në, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës në masën që ajo lidhet me juridiksionin lëndor dhe veprimtarinë e DHSK-së*”.⁶⁵
37. Neni 19 i Ligjit për DhSK-në i udhëzon gjykatësit që mblidhen në seancë plenare të miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave (**RrPP e DhSK-së**), e cila duhet të pasqyrojë “*standardet më të larta të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), me synim garantimin e shqyrtimit gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë*”. Gjatë përcaktimit të RrPP-së së DhSK-së, gjykatësit duhet gjithashtu të “*udhëhiqen nga Kodi i Procedurës Penale i Kosovës 2012*”.⁶⁶
38. Neni 19(2) i Ligjit për DhSK-në shton një garanci të mëtejshme strukturore: pas miratimit të tyre ose të çdo ndryshimi të mëvonshëm, drafti i Rregullores së Procedurës dhe të Provave të DhSK-së duhet të shqyrtohet nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese për të siguruar pajtueshmërinë e vazhdueshme me Kushtetutën e Kosovës. Siç ka vërejtur Sluiter, përfshirja e një mekanizmi të kontrollit gjyqësor ishte në masë të madhe e pazakontë në të drejtën penale ndërkombëtare dhe përbën “*një zgjidhje të mirë dhe kreative për përmirësimin e cilësisë së asaj që në thelb është një proces legjislativ, përkatësisht zhvillimi i së drejtës procedurale të një gjykate penale ndërkombëtare ose të ndërkombëtarizuar, e cila mund të shërbejë si model për gjykata të tjera*”.⁶⁷ Vlera e tij konfirmohet nga praktika: vendimi i 26 prillit

⁶³ A. Heinze, “*Rregullat e Procedurës dhe të Provave të Dhomasë të Specializuar të Kosovës: një diamant i krijuar nën presion?*”, *Journal of International Criminal Justice* 15 (2-17), fq. 985-1009, në fq. 1000.

⁶⁴ A. Heinze, “*Rregullat e Procedurës dhe të Provave të Dhomasë të Specializuar të Kosovës: një diamant i krijuar nën presion?*”, *Journal of International Criminal Justice* 15 (2-17), fq. 985-1009, në fq. 1000.

⁶⁵ A. Heinze, “*Rregullat e Procedurës dhe të Provave të Dhomasë të Specializuar të Kosovës: një diamant i krijuar nën presion?*”, *Journal of International Criminal Justice* 15 (2-17), fq. 985-1009, në fq. 1000.

⁶⁶ Neni 19(2) i Ligjit për DHSK-në

⁶⁷ Göran Sluiter, “*Të drejtat e njeriut në procedurat penale ndërkombëtare - ndikimi i vendimit të Dhomasë të Specializuar të Kosovës të 26 prillit 2017*”, 27 *Wm. & Mary Bill Rts. J.* 623 (2019), <https://scholarship.law.wm.edu/wmbrj/vol27/iss3/3>, fq. 645.

2017 mbi referimin e Rregullores dhe ligjshmërinë e saj (**Vendimi i Referimit 2017**) identifikoi “*jo më pak se trembëdhjetë dispozita*”⁶⁸ në kundërshtim me të drejtën për të drejtat e njeriut, disa prej të cilave trajtohen në pjesët në vijim.

III. VËREJTJE PARAPRAKE LIDHUR ME LIRIMIN E PËRKOHSHËM

39. Kjo pjesë shqyrton kornizën juridike që rregullon paraburgimin dhe lirimimin e përkohshëm në DhSK, e vendosur në kontekstin më të gjerë të sfidave specifike që karakterizojnë procedurat penale ndërkombëtare. Ndonëse korniza juridike e DhSK-së, në pamje të parë, është e qëndrueshme dhe është përmirësuar në mënyrë domethënëse përmes shqyrtimit nga Dhoma Kushtetuese e Specializuar, pengesat praktike për lirimimin e përkohshëm që burojnë nga Marrëveshja me Shtetin Pritës, si dhe konsideratat kontekstuale që ndikojnë në lirimimin në Kosovë, meritojnë shqyrtim të mëtejshëm - veçanërisht nëse rrezikojnë të krijojnë, *ab initio*, kushte të paraburgimit të zgjatur në mospërputhje me nenin 5 të KEDNj-së dhe nenin 9 të KNDCP-së.
40. E drejta për liri dhe siguri personale është ndër garancitë më themelore të parapara në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Neni 5 i KEDNj-së, i pasqyruar në nenin 9 të KNDCP-së, përcakton se askush nuk mund të privohet nga liria përveçse mbi baza dhe në përputhje me procedurat e parapara me ligj, si dhe se çdo person i arrestuar ose i ndaluar nën akuza penale ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit.
41. Për procedurat penale ndërkombëtare, kjo garanci paraqet një sfidë të veçantë: personat e akuzuar zakonisht ngarkohen me veprat penale më të rënda të njohura nga e drejta, procedurat janë jashtëzakonisht komplekse dhe të zgjatura, ndërsa rreziku i arratisjes ose i ndërhyrjes në dëshmitarë vlerësohet rregullisht si i konsiderueshëm.
42. Paraburgimi në gjykatat penale ndërkombëtare për pasojë ka tendencë të jetë i gjatë, me kohëzgjatje që korrespondon pothuajse në mënyrë të pashmangshme me atë të vetë procedurave penale (nga arrestimi deri në gjykim dhe shpesh deri në vendimin e apelit).⁶⁹ Kostoja njerëzore nuk duhet të mbetet në hije të analizës juridike: personat që gëzojnë

⁶⁸ *Ibid*, në fq. 646.

⁶⁹ J. B. Mbokani, “Paraburgimi para gjykimit”, Max Planck Encyclopedias of International Procedural Law, tetor 2023, paragrafi 6.

prezumimin e pafajësisë i nënshtrohen paraburgimit shumëvjeçar, duke humbur rrjedhën e plotë të jetës së zakonshme.⁷⁰ Rasti i Hashim Thaçit ofron një ilustrim të fundit dhe domethënës. I ndaluar në Hagë që nga nëntori 2020, Thaçi nuk ishte në gjendje të merrte pjesë në varrimin e babait të tij në mars 2025, pavarësisht paraqitjes së kërkesës një ditë më herët.⁷¹

43. Përvoja krahasuese me tribunalet ndërkombëtare ngre shqetësime dhe sugjeron se këto sisteme nuk janë projektuar gjithmonë duke pasur qartësisht parasysh mundësinë e lirimit të individëve. Në rastin *Butare*, rasti i fundit i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR), shumica e të akuzuarve ishin arrestuar ndërmjet viteve 1995 dhe 1998. Aktgjykimi gjykues nuk u shpall deri më 24 qershor 2011, duke e bërë këtë një nga periudhat më të gjata të paraburgimit në historinë e drejtësisë penale ndërkombëtare.⁷² Në GjPN, Laurent Gbagbo u transferua në qendrën e paraburgimit në nëntor 2011 dhe u shpall i pafajshëm në janar 2019 – një person që përfundimisht u shpall i pafajshëm sipas ligjit, qëndroi në paraburgim në një vend të huaj për më shumë se shtatë vjet. Pas shpalljes së pafajësisë nga Dhoma e Gjykitimit, Dhoma e Apelit vendosi kushte për lirimin si të Gbagbo, ashtu edhe të bashkakuçarit të tij, Charles Blé Goudé.⁷³ Në mars 2021, pafajësia e Gbagbo u konfirmua nga Dhoma e Apelit.⁷⁴
44. Përvoja e personave të shpallur të pafajshëm në TPNR ka qenë më ekstremja: nëntë persona të liruar pas shpalljes së pafajësisë nuk kishin mundësi të ribashkoheshin me familjet e tyre pas mbylljes së tribunalit, pasi aplikimet e tyre për viza në shtete strehimi rezultuan të pasuksesshme ose pa përgjigje, duke i lënë fillimisht të bllokuar në një shtëpi

⁷⁰ *Ibid*, par. 7.

⁷¹ KSC-BC-2020-06, Versioni publik i redaktuar i kërkesës urgjente të Mbrojtjes së Thaçit për lirimin e përkohshëm mbi baza humanitare, me Shtojcën konfidenciale ex parte 1, F03024, 17 mars 2025; KSC-BC-2020-06, Versioni publik i redaktuar i përgjigjes së konsoliduar urgjente të Mbrojtjes së Thaçit ndaj parashtrësive të Regjistrarit F03031 dhe përgjigjes së ZPS-së F03032, F03035, 18 mars 2025, par. 2: “Mbrojtja shpreh keqardhje që ç. Thaçi de facto nuk do të lejohet të marrë pjesë në varrimin e babait të tij. Në një situatë të ngjashme në ICTY para njëzet vitesh, ç. Ramush Haradinaj u lejua të marrë pjesë në varrimin e vëllait të tij më pak se 48 orë pas paraqitjes së kërkesës për lirim të përkohshëm mbi baza humanitare, duke udhëtuar drejt dhe nga Holanda me avion komercial. Është thellësisht për t’u ardhur keq që Dhomat e Specializuara të Kosovës me sa duket nuk janë në gjendje të lehtësojnë pjesëmarrjen e të paraburgosurve të tyre në varrimet e anëtarëve të ngushtë të familjes.”

⁷² J. B. Mbokani, “Paraburgimi para gjykitimit”, Max Planck Encyclopedias of International Procedural Law, tetor 2023, paragrafi 6.

⁷³ GjPN, *Prokurori k. Laurent Gbagbo dhe Charles Blé Goudé*, Aktgjykim mbi ankesën e Prokurorit kundër vendimit gojor të Dhomës së Gjykitimit I në përputhje me nenin 81(3)(c)(i) të Statutit, ICC-02/11-01/15 OA14, 1 shkurt 2019. Shih gjithashtu K. Jon Heller, “Dhoma e Apelit shpik lirimin me kushte pas shpalljes së pafajësisë”, *Opinio Juris*, 3 shkurt 2019, e disponueshme [këtu](#).

⁷⁴ GjPN, *Prokurori k. Laurent Gbagbo and Charles Blé Goudé*, Judgment in the appeal of the Prosecutor against Trial Chamber I’s decision on the no case to answer motion, ICC-02/11-01/15 A, 31 mars 2021.

të sigurt të OKB-së në Arusha dhe më pas, pas një marrëveshjeje të dështuar për zhvendosje, në arrest shtëpiak në Niger.⁷⁵ Një person vdiq para se të mund të realizohej transferimi për në Niger. Deri në prill të vitit 2026, edhe tre të tjerë kanë vdekur në Niger pa u ribashkuar ndonjëherë me familjet e tyre, ndërsa pesë të tjerë vazhdojnë të jenë nën arrest shtëpiak të paligjshëm, ende në pritje të një zgjidhjeje.⁷⁶

45. Rregullat e DhSK-së për lirimin e përkohshëm, si dhe për lirimin pas shpalljes së pafajësisë, janë hartuar në këtë kontekst nga gjykatës që vetë kanë shërbyer në këto tribunale. Pjesët në vijim paraqesin kornizën ligjore të zbatueshme dhe vlerësojnë shkallën në të cilën korniza e DhSK-së ka nxjerrë mësim nga – apo ka riprodhuar – përvojën e paraardhësve të saj.

A. Paraburgimi

46. Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNj) kërkon që paraburgimi në pritje të gjykimit të jetë proporcional me qëllimin e paraqitjes së të akuzuarit para gjykatës, dhe që vazhdimi i tij të justifikohet vetëm nëse ekzistojnë tregues konkretë për një nevojë reale të interesit publik, e cila, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, mbizotëron mbi të drejtën për liri.⁷⁷ Shkaqet e konsideruara “*relevante*” dhe “*të mjaftueshme*” në praktikën gjyqësore të Strasburgut kanë përfshirë rrezikun e arratisjes, rrezikun e ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët ose të manipulimit të provave, rrezikun e bashkëpunimit të paligjshëm, rrezikun e përsëritjes së veprës penale, rrezikun e shkakut të trazirave publike, si dhe nevojën për mbrojtjen e të ndaluarit.⁷⁸

⁷⁵ <https://www.ibanet.org/document?id=IBA-ICL-Perspectives-Remedying-International-Injustice>

⁷⁶ International Bar Association, “Remedying international injustice: appeals, retrials, and revisions of judgments in international criminal law” (International Bar Association) <https://www.ibanet.org/document?id=IBA-ICL-Perspectives-Remedying-International-Injustice>. Shih gjithashtu, në ICC, Mokom Defence Response to the Registry’s Submissions on the Defence Request for Compensation under Article 85 of the Rome Statute, ICC-01/14-01/22-344-Red, 12 korrik 2024, ku përshkruhen gjetjet e Dhomës së Paragjykimit se z. Mokom ishte vendosur në kushte që përbënin një formë të arrestit shtëpiak për 43 ditë pas lirit të tij, pavarësisht urdhrin të saj që nuk duhej të vendoseshin kufizime në lirinë e lëvizjes. Paraburgimi i z. Mokom në një hotel në Hagë, si dhe dështimi i Regjistrin për të siguruar lëvizjen e tij të lirë në Holandë, i atribuohet në masë të konsiderueshme refuzimit të Shtetit Pritës për të lejuar praninë e tij të pakufizuar në territorin e tij pas lirit — një pengesë strukturore e rrënjësor në Marrëveshjen me Shtetin Pritës. Shih gjithashtu, Dhoma e Paragjykimit II, “Versioni publik i redaktuar i ‘Urdhrit lidhur me masat në pritje të transferimit të z. Mokom’”, 21 nëntor 2023, ICC-01/14-01/22-294-Red, par. 3.

⁷⁷ Vendimi i Referimit 2017, paragrafi 113

⁷⁸ GJEDNj, Idalov k. Rusisë [GC], nr. 5826/03, 22 maj 2012, paragrafi 140; GJEDNj, Bykov k. Rusisë [GC], nr. 4378/02, 10 mars 2009, paragrafët 61–64; GJEDNj, McKay k. Mbretërisë së Bashkuar, cituar më sipër, paragrafët 41-45.

47. Pragu për vazhdimin e paraburgimit rritet pas shqyrtimit të parë gjyqësor. Në rastin *Buzadji k. Republikës së Moldavisë*,⁷⁹ Dhoma e Madhe konstatoi se, ndonëse dyshimi i arsyeshëm mund të mjaftojë për të justifikuar arrestimin fillestar, nga momenti i kontrollit të parë gjyqësor të paraburgimit (i cili duhet të ndodhë menjëherë pas arrestimit), kërkohen arsye relevante dhe të mjaftueshme përtej thjesht dyshimit për të justifikuar vazhdimin e paraburgimit.⁸⁰
48. Korniza ligjore e DhSK-së u përmbahet në masë të madhe këtyre parimeve:
- a. Neni 41(5) i Ligjit për DhSK-në pasqyron nenin 5(3) të KEDNJ-së dhe përcakton se çdo person ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit. Rregulla 56(2) e RrPP-së së DhSK-së parasheh më tej se Paneli duhet të sigurojë që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së rastit si dhe mundësinë e lirimit me kusht “*në rast të vonesave të paarsyeshme të shkaktuara nga Prokurori i Specializuar*”. Në rastin *Thaçi et al.* (Administrimi i Drejtësisë – Rasti 12), për shkak të vonesave të konsiderueshme në procedurë penale, Gjykatësi individual urdhëroi lirimin e Isni Kilajt në Kosovë nën kushte të rrepta, duke konstatuar se vazhdimi i mëtejshëm i paraburgimit do të ishte i paarsyeshëm.⁸¹ Vendimi u konfirmua në apel.⁸²
- b. Neni 41(6) i Ligjit për DhSK-në përcakton se arrestimi dhe paraburgimi mund të urdhërohen vetëm kur: (a) ekziston dyshim i bazuar se një person ka kryer një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara; dhe (b) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) paraqet rrezik për arratisje; (ii) do të shkatërrojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova të një veprë penale, ose do të pengojë zhvillimin e procedurës penale duke ndikuar mbi dëshmitarë, viktimë ose bashkëpunëtorë; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të

⁷⁹ [GC] (App. No. 23755/07), 5 korrik 2016.

⁸⁰ GJEDNJ, *Idalov k. Rusisë* (cituar më sipër), paragrafi 140; GJEDNJ, *Jablonski k. Polonisë*, nr. 33492/96, 21 dhjetor 2000, paragrafi 83.

⁸¹ KSC-BC-2018-01, Versioni publik i redaktuar i versionit të korigjuar të Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, F05999, 31 dhjetor 2025; KSC-BC-2023-12, INV/F00129/COR, Gjykatësi individual, Versioni i korigjuar i Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt (“Vendimi për Lirimin e Kilajt”), 3 maj 2024 (versioni i korigjuar i lëshuar më 15 maj 2024).

⁸² KSC-BC-2018-01, Version publik i redaktuar i Vendimit mbi ankesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit për rishikimin e paraburgimit të Isni Kilajt, IA007-F00007RED, 13 maj 2024.

përfundojë një vepër të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale për të cilën ka kërcënuar se do ta kryejë.

- c. Në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit për DhSK-në dhe Rregullën 57(2) të RrPP-së së DhSK-së, deri në nxjerrjen e një aktgjykimi përfundimtar ose deri në lirimin e personit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Paneli, pas skadimit të një periudhe dymujore nga vendimi i fundit për paraburgimin në pritje të gjyqimit, duhet të shqyrtojë nëse arsyet për paraburgim ende ekzistojnë dhe të nxjerrë vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.
- d. Rregulla 56(3) e RrPP-së së DhSK-së parasheh gjithashtu, me kërkesë ose *proprio motu*, lirimin e përkohshëm të personit të paraburgosur, kur ky librim përlligjet prej arsyeve humanitare bindëse.

49. Në rastet kur urdhërohet librimi, Rregulla 56(4) e RrPP-së së DhSK-së parasheh:

*“Me kërkesë sipas paragrafëve (2) ose (3), Paneli mund të vendosë kushte të tilla për librimin që i konsideron të përshtatshme për të siguruar praninë e të Akuzuarit gjatë procedurës, në përputhje me nenin 41(12) të Ligjit. Paneli duhet të dëgjojë Shtetin e Tretë në të cilin personi i paraburgosur kërkon të lirohet. Personi i paraburgosur **nuk lirohet në Shtetin e Tretë pa pëlqimin e atij Shteti**. Vendimi duhet të nxirret sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se tre (3) ditë nga parashtresa e fundit.”*

50. Formulimi fillestar i kësaj dispozite ishte si vijon:

*“Paneli duhet të dëgjojë Shtetin e Tretë në të cilin personi i paraburgosur kërkon të lirohet. Personi i paraburgosur **nuk lirohet pa pëlqimin e atij shteti**”.*

51. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese e shpalli këtë dispozitë në mospërputhje me Kushtetutën e Kosovës në Vendimin e Referimit të vitit 2017. Ndonëse pranoi se njëfarë vonese në ekzekutimin e vendimit për librim mund të jetë e kuptueshme, ajo

konstatoi se kushtëzimi i plotë i lirimit me pëlqimin e një shteti ishte “*qartësisht problematikë*”:⁸³

*“Kjo dispozitë do ta bënte lirimin e personit në paraburgim tërësisht të varur nga pëlqimi i një Shteti, edhe në rrethana kur Paneli konstaton ekzistencën e arsyeve të mjaftueshme që kërkojnë lirimin e tij ose të saj. Nëse pëlqimi i tillë do të refuzohej, atëherë zbatimi i dispozitës në formën e saj aktuale do të nënkuptonte se personi i paraburgosur ‘nuk lirohet’. Gjykata vlerëson se çdo paraburgim në këto rrethana do të ishte pa bazë të nevojshme ligjore dhe nuk do të përbënte paraburgim të ligjshëm.”*⁸⁴

52. Ndryshimi (duke shtuar fjalët “*në Shtetin e Tretë*”) nënkupton se i akuzuari që nuk arrin të sigurojë pëlqimin e një Shteti të Tretë, në parim, mund të lirohet në Kosovë, pasi RrPP-ja e DhSK-së e përkufizon “*Shtetin e Tretë*” si “[një] Shtet ose një entitet i tij, përveç Republikës së Kosovës”. Megjithatë, kjo mundësi duhet të kuptohet në kontekst: klima e pretenduar e intimidimit të dëshmitarëve në Kosovë ishte ndër konsideratat kryesore që çuan si në themelimin e DhSK-së, ashtu edhe në zhvendosjen në Hagë, dhe këto konsiderata mbeten relevante në vlerësimin e kërkesave për lirim. Prandaj ishte e parashikueshme, dhe praktika gjyqësore e konfirmon këtë, se pozita me ndikim e një të akuzuari në shoqërinë kosovare dhe/ose rreziku i ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në Kosovë do të vendosin një prag të lartë për lirim të përkohshëm.⁸⁵
53. Lirimi në Holandë, ku zhvillohen procedurat penale, nuk është i mundur.⁸⁶ Megjithëse ka pranuar katër tribunale ndërkombëtare (GjPN, TPNJ, TPNR dhe Tribunalin Special për Libanin (“GjSL”)) dhe tashmë edhe DhSK-në, Holanda ka kundërshtuar në mënyrë të

⁸³ Vendimi i Referimit 2017, par. 120. Shih gjithashtu: Maria Stefania Cataleta dhe Chiara Loiero, *The Kosovo Specialist Chambers: The Last Resort for Justice in Kosovo?* (LAP Lambert Academic Publishing, 2021), f. 97.

⁸⁴ *Ibid*

⁸⁵ Shih, për shembull: KSC-BC-2020-06, Versioni publik i redaktuar i vendimit mbi kërkesën e Hashim Thaçit për lirim të përkohshëm, 22 janar 2021, F00177; KSC-BC-2020-06, Vendimi për rishikimin periodik të paraburgimit të Hashim Thaçit, F03718, 10 prill 2026; KSC-BC-2020-06, Versioni publik i redaktuar dhe i korrigjuar i vendimit mbi kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për lirim të përkohshëm, 11 qershor 2025, F03177; KSC-BC-2020-06, Versioni publik i redaktuar dhe i korrigjuar i vendimit të konsoliduar mbi kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për lirim të përkohshëm dhe mbi rishikimin periodik të paraburgimit të Rexhep Selimit, F03175, 13 maj 2025; KSC-BC-2020-06, Versioni publik i redaktuar i vendimit për rishikimin periodik të paraburgimit të Jakup Krasniqit, F01110, 18 nëntor 2022.

⁸⁶ Maria Stefania Cataleta dhe Chiara Loiero, *The Kosovo Specialist Chambers: The Last Resort for Justice in Kosovo?* (LAP Lambert Academic Publishing, 2021), 98.

vazhdueshme lejimin e hyrjes në territorin e saj të çdo personi të liruar përkohësisht.⁸⁷ Ky qëndrim pasqyrohet në nenin 42(1) të Marrëveshjes me Shtetin Pritës, i cili përcakton se “[personat e paraburgosur nga Institucioni Gjyqësor i Relokuar i Kosovës në Shtetin Pritës nuk do të lirohen përkohësisht në Shtetin Pritës [...] me përjashtim të personave që janë shtetas ose rezidentë të përbërshëm të Shtetit Pritës]”.⁸⁸

54. Ky rregullim ndryshon në mënyrë thelbësore nga pozita e një të pandehuri të liruar me kusht në një juridiksion penal vendor, i cili zakonisht do të ishte në gjendje të takohej me përfaqësuesit e tij ligjorë dhe të qëndronte në afërsi të ngushtë me gjykatën.
55. Deri më sot, të akuzuarit e vetëm të cilëve u është miratuar lirimi i përkohshëm në DhSK janë Isni Kilaj (i liruar për herë të parë më 15 maj 2024 dhe sërish më 10 dhjetor 2025),⁸⁹ Bashkim Smakaj dhe Fadil Fazliu (të dy të liruar më 3 shkurt 2026),⁹⁰ në rastin *Thaçi et al.* (Rasti 12 – Administrimi i Drejtësisë).

Numri i rastit	I akuzuari	Arrestimi dhe transferimi në Njësinë e Paraburgimit të DhSK-së	Lirimi i përkohshëm	Fillimi i gjykimit	Aktgjykimi gjykues
KSC-BC-2020-05/KSC-CA-2023-02	Salih Mustafa	24/09/2020	N/A	15/09/2021	16/12/2022
KSC-BC-2020-07/KSC-CA-2022-01	Hysini Gucati	25/09/2020	N/A	07/10/2021	18/05/2022
KSC-BC-2020-07/KSC-CA-2022-01	Nasim Haradinaj	26/09/2020	N/A	07/10/2021	18/05/2022
KSC-BC-2020-06	Hashim Thaçi ⁹¹	04–05/11/2020	N/A	03/04/2023	Kuvendimet janë në vazhdim e sipër
KSC-BC-2020-06	Kadri Veseli	04–05/11/2020	N/A	03/04/2023	Kuvendimet janë në vazhdim e sipër
KSC-BC-2020-06	Rexhep Selimi	04–05/11/2020	N/A	03/04/2023	Kuvendimet janë në vazhdim e sipër

⁸⁷ Maité Van Regemorter, “Lirimi i përkohshëm” (Max Planck Encyclopaedia of International Procedural Law, përditësuar në nëntor 2020), para. 33. Ndërsa selia kryesore e ICTR-së ishte e vendosur në Arusha, Tanzani, Dhoma e Apelit ishte e vendosur në Holandë.

⁸⁸ Neni 42(1), Marrëveshja ndërmjet Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës lidhur me pritjen e Institucionit Gjyqësor të Relokuar të Kosovës në Holandë, 15 shkurt 2016.

⁸⁹ KSC-BC-2023-12, Versioni publik i redaktuar i Vendimit të gjashtë mbi shqyrtimin e paraburgimit të Isni Kilajt, F00599RED, 3 dhjetor 2022.

⁹⁰ KSC-BC-2023-12, Versioni publik i redaktuar i Vendimit të shtatë mbi shqyrtimin e paraburgimit të Bashkim Smakajt, F00719RED, 3 shkurt 2026; dhe KSC-BC-2023-12, Versioni publik i redaktuar i Vendimit të shtatë mbi shqyrtimin e paraburgimit të Fadil Fazliut, F00720RED, 3 shkurt 2026.

⁹¹ Janë përfshirë vetëm datat e rastit kryesor.

KSC-BC-2020-06	Jakup Krasniqi	04– 05/11/2020	N/A	03/04/2023	Kuvendimet janë në vazhdim e sipër
KSC-BC-2020-04/KSC-CA-2024-03	Pjetër Shala ⁹²	16/03/2021 (arrestim) 15/04/2021 (Transferim)	N/A	21/02/2023	16/07/2024
KSC-BC-2023-10	Sabit Januzi	05- 06/10/2023	N/A	Paneli vendosi që gjykimi të fillojë më 14/11/2024. Pas njoftimeve nga të dyja palët, Paneli shtyu fillimin e gjykit për të mundësuar finalizimin e marrëveshjeve të pranimit të fajësisë.	Paneli miratoi marrëveshjet e pranimit të fajësisë dhe shqiptoi dënimet më 04/02/2025
KSC-BC-2023-10	Ismet Bahtijari	05- 06/10/2023	N/A	Paneli vendosi që gjykimi të fillojë më 14/11/2024. Pas njoftimeve nga të dyja palët, Paneli shtyu fillimin e gjykit për të mundësuar finalizimin e marrëveshjeve të pranimit të fajësisë.	Paneli miratoi marrëveshjet e pranimit të fajësisë dhe shqiptoi dënimet më 04/02/2025
KSC-BC-2023-12	Isni Kilaj	02– 03/11/2023 (arrestimi i parë) 05– 06/12/2024 (arrestimi i dytë)	15/05/2024 (lirimi i parë i përkohshëm) 10/12/2025 (lirimi i dytë i përkohshëm)	27/02/2026	Gjykimi është në zhvillim e sipër
KSC-BC-2023-12	Fadil Fazliu	05– 06/12/2024	03/02/2025	27/02/2026	Gjykimi është në zhvillim e sipër
KSC-BC-2023-12	Hajredin Kuçi	05– 06/12/2024	N/A	27/02/2026	Gjykimi është në zhvillim e sipër
KSC-BC-2023-12	Bashkim Smakaj	05– 06/12/2024	03/02/2025	27/02/2026	Gjykimi është në zhvillim e sipër

B. Neni 8 i KEDNj-së

56. Çdo paraburgim që është i ligjshëm dhe i justifikuar do të kufizojë në mënyrë të pashmangshme deri në një masë të caktuar të drejtat sipas nenit 8. Kështu, për shembull,

⁹² Janë përfshirë vetëm datat e rastit kryesor.

kufizimet në kontaktin me botën e jashtme nuk janë vetvetiu në mospërputhje me nenin 8, duke marrë parasysh kriteret e zakonshme të vuajtjes së dënimit me burgim.⁹³

57. GjEDNj-ja ka konstatuar megjithatë se, ndonëse mbikëqyrja e komunikimeve në zonën e vizitave në burg mund të justifikohet mbi baza sigurie, mbikëqyrja e tyre sistematike për qëllime të tjera përbën ndërhyrje në nenin 8. Gjykata i ka kushtuar rëndësi të veçantë kërkesës së ligjshmërisë, përfshirë qartësinë dhe parashikueshmërinë e bazës ligjore përkatëse.⁹⁴

C. Paraburgimi pas shpalljes së pafajësisë

58. Në formën e tyre fillestare, RrPP e DhSK-së rrezikonin të riprodhonin mangësitë e gjykatave dhe tribunaleve të tjera ndërkombëtare (ose të ndërkombëtarizuara) për sa i përket personave të shpallur të pafajshëm. Rregulla 158(2) parashihte si vijon:

“Nëse Prokurori i Specializuar njofton Panelin se synon të apelojë një vendim pafajësie në momentin e shpalljes së tij, Paneli mundet, me kërkesë të Prokurorit të Specializuar dhe pas dëgjimit të Palëve, në rrethana të jashtëzakonshme, të urdhërojë vazhdimin e paraburgimit të të Akuzuarit në përputhje me nenin 41(6)(b)(i) dhe (ii) të Ligjit, në pritje të vendimit mbi ankesën.”

59. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese e shpalli këtë dispozitë në mospërputhje me Kushtetutën, duke deklaruar në mënyrë të qartë se

“[n]uk ekziston asnjë dispozitë në Kushtetutën e [Kosovës] ose në Konventë që lejon paraburgimin e një personi i cili është shpallur i pafajshëm pas një gjykimi”,⁹⁵ dhe se “[...] pavarësisht rrethanave, vazhdimi i paraburgimit të një personi të shpallur i pafajshëm në pritje të vendimit mbi ankesën kundër pafajësisë së tij ose të saj, në mungesë të një dyshimi të arsyeshëm se ai ose ajo ka kryer një veprë tjetër penale për të cilën është ngritur akuzë, nuk parashihet me ligj dhe nuk hyn në një nga shkaqet e lejuara për privimin nga liria. Rrjedhimisht, Gjykata përfundon se Rregulla 158(2) nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën.”⁹⁶

⁹³ Khoroshenko k. Rusisë [DHM], Kërkesa nr. 41418/04 (30 qershor 2015), paragrafët 106, 109, 116-149.

⁹⁴ Wisse k. Francës, Kërkesa nr. 71611/01, 20 dhjetor 2005, paragrafët 29–34; GjEDNj, Doerga k. Holandës, Kërkesa nr. 50210/99, (27 prill 2004), paragrafët 44-54.

⁹⁵ Vendimi i Referimit 2017, paragrafi 200.

⁹⁶ Vendimi i Referimit 2017, paragrafi 205.

60. Rregulla 158(1) e RrPP-së së DhSK-së u ndryshua në këtë drejtim, duke kërkuar lirimin e menjëhershëm të një të akuzuari të paraburgosur pas shpalljes së pafajësisë, përveç nëse ai ose ajo mbahet ligjërisht në paraburgim ose është duke vuajtur një dënim për vepra të tjera penale. Versioni i ndryshuar përmbush në dukje standardin kushtetues dhe ilustron vlerën e mekanizmit të rishikimit që e ka prodhuar atë.

D. Konkluzioni

61. Korniza ligjore e DhSK-së që rregullon paraburgimin është, në dukje, e qëndrueshme. Detyrimi për shqyrtim periodik është i integruar në rregulla, parashihen mundësi për lirim mbi baza humanitare, ndërsa korniza pas shpalljes së pafajësisë është korrigjuar për të pasqyruar ndalimin kushtetues të paraburgimit të personave të shpallur të pafajshëm. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese ka luajtur rol të rëndësishëm në formësimin e rregullave në gjendjen e tyre aktuale. Megjithatë, pengesa strukturore për lirimin e përkohshëm e krijuar nga Marrëveshja me Shtetin Pritës, dhe e përforcuar nga vështirësitë për lirimin në Kosovë, ka pasoja të thella për personat e akuzuar. Ligjshmëria e paraburgimit që rrjedh prej kësaj nuk mund të vlerësohet *in abstracto*, por një paraburgim i tillë me hapësirë shumë të kufizuar për lirim të përkohshëm ngre shqetësime lidhur me përrputhjen me nenin 5 të KEDNj-së dhe nenin 9 të KNDCP-së.
62. Vlerësimi i mënyrës se si korniza është zbatuar në praktikë, përfshirë qëndrueshmërinë e vendimeve për paraburgim ndërmjet rasteve, ligjshmërinë e masave kufizuese të vendosura ndaj të akuzuarve gjatë qëndrimit në paraburgim, si dhe ndikimin e tyre në të drejtat sipas nenit 8, bie jashtë fushëveprimit të këtij raporti. Këto çështje ngrenë probleme të rëndësishme që meritojnë shqyrtim të veçantë, ndërsa trajtimi i tyre i duhur kërkon një analizë rast për rast që tejkalon qëllimin dhe fushëveprimin e këtij raporti. Ndërkohë, rekomandohet që DhSK-ja të mbështetet në mënyrë proaktive në praktikën e shqyrtuar në paragrafët 41-45 më sipër, për të siguruar që dështimet e dokumentuara në tribunalet e tjera ndërkombëtare (ose të ndërkombëtarizuara) të mos përsëriten.

IV. VËREJTJE PARAPRAKE MBI TË DREJTËN PËR NJË GJYKATË KOMPETENTE, TË PAVARUR DHE TË PAANSHME TË THEMELUAR ME LIGJ

63. Kjo pjesë shqyrton kornizën juridike që rregullon pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore në DhSK, si dhe vlerëson mënyrën se si kjo kornizë është zbatuar në praktikë. Analizohen standardet përkatëse ndërkombëtare, modeli i emërimit dhe caktimit të gjykatësve, rregullat mbi vetëtërheqjen apo heqjen e gjykatësve, si dhe një sërë procedurash që burojnë nga një informim diplomatik në dhjetor 2020, i cili ka çuar në paraqitjen e kërkesave për vetëtërheqje apo heqje të gjykatësve nga shqyrtimi në dy raste të veçanta.

A. E drejta për një gjykatë kompetente, të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj

64. E drejta për një gjykatë kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të themeluar me ligj, është e paraparë në të gjitha traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që trajtojnë të drejtën për gjykim të drejtë, si dhe në statutet e gjykatave penale ndërkombëtare dhe instrumente të tjera përkatëse.⁹⁷ Neni 14(1) i KNDCP-së përcakton se secili ka të drejtë të dëgjohet nga “një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”. Neni 6(1) i KEDNj-së është i formuluar në terma identikë, përveçse nuk përfshin fjalën “kompetente”, ndonëse GjEDNj-ja ka interpretuar kërkesën që gjykata të jetë “e themeluar me ligj” si përfshirëse, në çdo rast, edhe të garancive që lidhen me kompetencën.⁹⁸ Kjo e drejtë zbatohet në të gjitha fazat e procedurës penale, përfshirë fazën paraprake, gjykimin,⁹⁹ apelin dhe dënimin, si dhe kërkon që gjykata të përmbushë kushte të tilla si “pavarësia e anëtarëve të saj dhe kohëzgjatja e mandateve të tyre, paanshmëria dhe ekzistenca e garancive procedurale”.¹⁰⁰ Kjo e drejtë është gjithashtu e paraparë në nenin 31(2) të Kushtetutës së Kosovës.

65. Paanshmëria gjyqësore ka gjeneruar një jurisprudencë të gjerë si në GjEDNj, ashtu edhe në tribunale penale ndërkombëtare. Është fakt i pranuar gjerësisht se gjykatësit duhet jo vetëm të jenë të lirë nga paragjykimi (paanshmëria subjektive, e cila prezumohet derisa të provohet e kundërta), por edhe të mos krijojnë asnjë dyshim të arsyeshëm për paragjykim (paanshmëria objektive, e cila vlerësohet nga këndvështrimi i një vëzhguesi të

⁹⁷ Amal Clooney dhe Philippa Webb, *E drejta për një gjykim të drejtë në të drejtën ndërkombëtare*, (OUP, 2021), 72 (version elektronik).

⁹⁸ Shih, p.sh., *Lavents k. Letonisë* (Kërkesa nr. 58442/00), 28 nëntor 2022, paragrafi 114; *Coëme k. Belgjikës* (kërkesat nr. 32492/96 & të tjerët) (22 qershor 2000), paragrafët 99 dhe 107-108.

⁹⁹ *Easterbrook k. Mbretërisë së Bashkuar* (Kërkesa nr. 48015/99), (12 qershor 2003).

¹⁰⁰ *Coëme k. Belgjikës* (kërkesat nr. 32492/96 e të tjera) (22 qershor 2000), paragrafi 99.

arsyeshëm).¹⁰¹ Barra e provës për çdo mungesë të pretenduar të paanshmërisë ose pavarësisë bie mbi palën që e ngre pretendimin.¹⁰²

Emërimi i gjykatësve

66. Gjykatësit e DhSK-së emërohen në një “Regjistër i Gjykatësve Ndërkombëtarë” nga Shefi i Misionit të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së (PPSM),¹⁰³ me rekomandimin e një paneli të pavarur përzgjedhës të përbërë nga “tre anëtarë ndërkombëtarë, ku të paktën dy prej tyre janë gjykatës ndërkombëtarë me përvojë të konsiderueshme në të drejtën penale ndërkombëtarë”.¹⁰⁴ Kryetari dhe zëvendëskryetari i Gjykatës emërohen përmes të njëjtit proces.¹⁰⁵
67. Gjykatësit e përfshirë në regjistrin e gjykatësve nuk marrin shpërblim ose përfitime të tjera për përfshirjen në regjistër dhe “dubet të përpiqen të mos ndërmarrin asnjë aktivitet që mund të komprometojë aftësinë e Kryetarit të Dhomave të Specializuara për t’i caktuar ata për të ushtruar funksione si gjykatës në Dhomat e Specializuara”.¹⁰⁶ Pasi caktohen për të shqyrtuar një fazë të një rasti ose një referim kushtetues, gjykatësi caktohet për një mandat katërvjeçar ose deri në përfundimin e fazës së procedurës për të cilën është caktuar, nëse ajo fazë përfundon më herët. Për sa i përket Kryetarit të Dhomave të Specializuara, ai/ajo emërohet për një mandat katërvjeçar, me mundësi vazhdimi. Ky funksion është mbajtur nga Ekaterina Trendafilova që nga viti 2016.¹⁰⁷
68. Trupi gjykues është ekskluzivisht ndërkombëtar: në DhSK nuk marrin pjesë gjykatës vendore. Kjo përbën një devijim të qëllimshëm nga modeli i “trupit gjykues të përzjer”, tipik për tribunale të tjera hibride ose të ndërkombëtarizuara si Dhomat e Jashtëzakonshme në

¹⁰¹ *Prokurori k. Furundžija*, Aktgjykim, Rasti nr. IT-95-17/1-A, 21 korrik 2000, paragrafi 182; ICTR, *Prokurori k. Rutaganda*, Aktgjykim, Rasti nr. ICTR-96-3-A, 26 maj 2003, paragrafi 39 e në vijim; SCSL, *Prokurori k. Sesay*, Vendim mbi mocionin e mbrojtjes për përjashtimin e gjykatësit Robertson nga Dhoma e Apelit, Rasti nr. SCSL-2004-15-AR15, 13 mars 2004, paragrafi 15; SCSL, *Prokurori k. Norman*, Vendim mbi mocionin për përjashtimin e gjykatësit Winter nga kuvendimet në mocionin paraprak mbi rekrutimin e ushtarëve fëmijë, Rasti nr. SCSL-2004-14-PT, 28 maj 2004.

¹⁰² *Prokurori k. Blagojević*, Vendim mbi mocionin për përjashtim, Rasti nr. IT-02-60-R, 2 korrik 2008; *Prokurori k. Šešelj*, Vendim mbi mocionin për përjashtim, Rasti nr. IT-03-67-PT, 16 shkurt 2007, paragrafi 5; Aktgjykimi *Furundžija* (n 93), paragrafi 196.

¹⁰³ Neni 28(3) i Ligjit për DhSK-në.

¹⁰⁴ Neni 28(2) i Ligjit për DhSK-në.

¹⁰⁵ Neni 32 i Ligjit për DhSK-në.

¹⁰⁶ Neni 26(2) dhe (3) i Ligjit për DhSK-në.

¹⁰⁷ Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, “Presidenti” (Dhomat e Specializuara të Kosovës) <https://www.scp-ks.org/en/specialist-chambers/president>

Gjykatat e Kamboxhias (**DhJGjK**), GjSL, Gjykata Speciale për Sierra Leonen (**GjSSL**) dhe Gjykata Reziduale Speciale për Sierra Leonen (**GjSRSL**), ku trupi gjykues përbëhet nga një kombinim gjykatësish vendorë dhe ndërkombëtarë.¹⁰⁸ Një karakteristikë tjetër dalluese (dhe, sipas njohurive të autorëve, unike¹⁰⁹) është se emërimet gjyqësore kontrollohen në mënyrë efektive nga i njëjti grup (i kufizuar) shtetesh që financojnë gjykatën, pasi neni 28 i Ligjit për DhSK-në parasheh që kandidatët propozohen nga shtetet financuese, përkatësisht shtetet e BE-së dhe shtetet kontribuuese të treta (Kanadaja, Norvegjia, Zvicra, Turqia dhe ShBA-ja),¹¹⁰ dhe kushtet e përcaktuara në thirrjen për nominim parashohin se “[kandidatët duhet të kenë shtetësi të një shteti anëtar të BE-së ose të një shteti të tretë kontribuues]”.¹¹¹

69. Modeli i emërimeve në DhSK pasqyron mësimet e nxjerra nga tribunalet e mëparshme ndërkombëtare (ose të ndërkombëtarizuara).¹¹² Në veçanti, kërkesa për “kompetencë të dëshmuar në të drejtën penale dhe procedurën penale ose në pjesë përkatëse të së drejtës ndërkombëtare dhe të së drejtës kushtetuese, sipas rastit, me përvojë të gjerë gjyqësore, prokuroriale ose të mbrojtjes në procedura penale ndërkombëtare ose vendorë” i përgjigjet kritikave të vazhdueshme ndaj emërimeve gjyqësore në institucionet e mëparshme, ku në disa raste konsideratat politike mund të kenë mbizotëruar mbi kompetencën profesionale.¹¹³ Përbërja e regjistrit të gjykatësve ofron mbështetje empirike për këtë pohim.

¹⁰⁸ Joseph Powderly, “Njohja me gjyqësorin penal ndërkombëtar: një profil i përgjithshëm” në *Judges and the Making of International Criminal Law* (Brill Nijhoff, 2020), f. 36.

¹⁰⁹ Vërejmë se, për sa i përket Tribunalit të Posaçëm për Krimin e Agresionit (“STCoA”), “anëtarët dhe anëtarët e asociuar të Komitetit të Menaxhimit do të mund të propozojnë kandidatë për listën e gjykatësve”. Megjithatë, sa i përket STCoA-së, “kandidatëve nuk do t’u kërkohet të jenë shtetas të një shteti që është anëtar ose anëtar i asociuar i Komitetit të Menaxhimit” (theksimi i shtuar – shih këtu).

¹¹⁰ Neni 28 i Ligjit për DhSK-në. Shih gjithashtu shkëmbimin e letrave që shoqëron Ligjin nr. 04/L-274 për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, 23 prill 2014.

¹¹¹ Shih, për shembull, Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm, Thirrje për nominime për listën rezervë për gjykatës në listën e gjykatësve ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, Shtojca II, f. 2: “Shtetet anëtare të BE-së/ Shtetet e treta kontribuuese kërkohet të sigurojnë që kërkesat thelbësore të mëposhtme të përmbushen dhe pranohen në mënyrë strikte për kandidatët: Shtetësia – Kandidatët duhet të kenë shtetësinë e një shteti anëtar të BE-së ose të një shteti të tretë kontribuues. [...]”, i disponueshëm këtu.

¹¹² Michael G. Karnavas, “Dhomat e Specializuara të Kosovës – Pjesa 3: Tipare të veçanta të Statutit” (michaelgkarnavas.net/Blog, 20 shkurt 2019) i disponueshëm këtu. Më tej, siç vëren Joseph Powderly, “[fakti që afërsisht një në pesë gjykatës të së drejtës penale ndërkombëtare nuk ka përvojë të mëparshme në ushtrimin e funksionit gjyqësor është shqetësues]” (shih Joseph Powderly, “Njohja me gjyqësorin penal ndërkombëtar: një profil i përgjithshëm” në *Judges and the Making of International Criminal Law* (Brill Nijhoff, 2020), f. 36).

¹¹³ Shih Michael Bohlander, “Gjyqësori penal ndërkombëtar: problemet e përzgjedhjes gjyqësore, pavarësisë dhe etikës”, në Michael Bohlander (ed.), *Drejtësia penale ndërkombëtare: një analizë kritike e institucioneve dhe procedurave* (Cameron, 2007), fq. 326-362.

70. Natyra ndërkombëtare e emërimeve gjyqësore në DhSK ka si pasojë të pashmangshme faktin që asnjë gjykatës që shërben në DhSK nuk ka përvojë paraprake në të drejtën dhe procedurën penale të Kosovës. Ky realitet paraqet problem për dy arsye. Së pari, DhSK-ja ka juridiksion të kufizuar lëndor për sa i përket së drejtës penale vendore të Kosovës. Kjo krijon një situatë në të cilën DhSK-ja gjykon sjellje potencialisht të rënda penale që mund të rezultojnë në dënime të gjata me burgim, pa asnjë gjykatës në trup gjykues që të ketë përvojë ose ekspertizë relevante lidhur me të drejtën penale materiale ose procedurale në fjalë. Së dyti, dhe ndoshta edhe më me rëndësi, gjykatësit e DhSK-së nuk janë në pozitë të përshtatshme për të kontekstualizuar në mënyrë adekuate funksionin e tyre brenda traditës kushtetuese vendore. Në të vërtetë, gjykatësit që shërbejnë në Dhomën e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë përvojë apo ekspertizë të konsiderueshme lidhur me Kushtetutën e Kosovës. Ekziston një tension i theksuar ndërmjet përvojës dhe ekspertizës së gjykatësve ndërkombëtarë në regjistër lidhur me të drejtën dhe praktikën penale ndërkombëtare, dhe mungesës së përvojës dhe ekspertizës së tyre për sa i përket të drejtës dhe praktikës penale dhe kushtetuese vendore të Kosovës. Implikimet e këtij tensioni mund të vënë në pikëpyetje kompetencën e DhSK-së sipas neneve 14(1) të KNDCP-së dhe 6(1) të KEDNj-së.
71. Statuti i DhSK-së po ashtu nuk përmban ndonjë dispozitë që përcakton marrjen parasysht të përfaqësimit gjinor në emërimet gjyqësore. Ndonëse mungesa të ngjashme mund të gjenden edhe në tribunele të tjera të ndërkombëtarizuara,¹¹⁴ kjo bie në kontrast me kornizën e Gjykatës Penale Ndërkombëtare si dhe me Tribunalin e Posaçëm për Krimin e Agresionit, të cilat parashohin në mënyrë eksplicite detyrimin për të marrë parasysht balancën gjinore,¹¹⁵ si dhe me kornizën kushtetuese vendore të Kosovës, e cila përfshin parimet e barazisë gjinore në emërimet publike.¹¹⁶ Në regjistrin e gjykatësve, aktualisht

¹¹⁴ Siç vëren Powderly, e njëjta mangësi gjendet edhe në statutet e Gjykatës Speciale për Sierra Leonen, Gjykatës së Mbetur Speciale për Sierra Leonen dhe Tribunalit Special për Libanin (J. Powderly, *Gjykatësit dhe krijimi i së drejtës penale ndërkombëtare*, Brill Nijhoff (2020), Kapitulli 1, fq. 58).

¹¹⁵ Neni 36(8)(a)(iii) përcakton se Shtetet Palë “*dubët të marrin parasysht nevojën për një përfaqësim të drejtë të gjykatësve femra dhe meshkuj*”. Shih gjithashtu J. Powderly, *Gjykatësit dhe krijimi i së drejtës penale ndërkombëtare*, Brill Nijhoff (2020), Kapitulli 1, fq. 58.

¹¹⁶ Neni 104(2) i Kushtetutës së Kosovës përcakton se “[p]ërbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht të barazisë gjinore”. Përveç Kushtetutës, Ligji për Barazi Gjinore kërkon përfaqësim të barabartë gjinor, të përcaktuar si 50 për qind – 50 për qind në të gjitha nivelet vendimmarrëse në të gjitha institucionet publike, përfshirë organet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe institucionet e tjera publike.

janë 7 gra dhe 22 burra, që përbën afërsisht një të tretën e përfaqësimit.¹¹⁷ Për krahasim, në GjPN gratë në fakt janë më të shumta se burrat në trup gjykues (11 gra dhe 7 burra).¹¹⁸

Caktimi i gjykatësve

72. Gjykatësit caktohen nga regjistri në Panelet gjyqësore nga Kryetari i DhSK-së.¹¹⁹ Rregulla 4 e Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara parasheh se, gjatë caktimit të gjykatësve në Panelet gjyqësore, Kryetari duhet të jetë *“objektiv dhe transparent”* dhe të *“niset nga kritere objektive, si përvoja, kompetenca, përparësia në bazë të datës së emërimit ose të moshës dhe përfaqësimi gjinor e gjeografik, si edhe nga parapëlqimet e gjykatësve dhe disponueshmëria e tyre në kohën e fillimit të procesit gjyqësor përkatës.”*
73. Pavarësia gjyqësore kërkon që gjykatësit të caktohen në gjykata dhe raste në përputhje me procedura objektive dhe transparente, pasi *“një sistem jotransparent dhe subjektiv i caktimit të rasteve është i cenusshëm ndaj manipulimit dhe korrupsionit”*.¹²⁰ Në këtë kuptim, Raportuesi i Posaçëm i OKB-së shprehu shqetësim lidhur me kompetencën e presidentit të një gjykate ruse për t’u caktuar raste gjykatësve *“në mungesë të një procedure të përshtatshme dhe transparente për ndarjen e rasteve”*.¹²¹ Në rastin *Bochan k. Ukrainës*, GjEDNj-ja konstatoi shkelje të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur kur rasti i një të pandehuri në Ukrainë iu ricaktua një gjykatësi tjetër, edhe pse i pandehuri *“nuk ishte informuar për arsyet e ricaktimit [...] dhe [...] nuk kishte pasur mundësi të komentonte mbi këtë çështje”*.¹²²
74. Megjithatë Rregulla 4 përcakton disa kritere objektive,¹²³ neni 33(1) në praktikë i jep Kryetarit diskrecion të konsiderueshëm për të formuar panelet duke pasur parasysh

¹¹⁷ Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, “Dhomat” (Dhomat e Specializuara të Kosovës) <https://www.scp-ks.org/en/specialist-chambers/chambers>

¹¹⁸ Gjykata Penale Ndërkombëtare, “Gjykatësit” (Gjykata Penale Ndërkombëtare), <https://www.icc-cpi.int/judges/judges-who-s-who>

¹¹⁹ Neni 33(1) i Ligjit për DhSK-në

¹²⁰ Raportuesi i Posaçëm i OKB-së, Raporti 2012, UN Doc. A/67/305, paragrafi 65; dhe Raporti 2014, UN Doc. A/69/294, paragrafi 80.

¹²¹ Raportuesja e Posaçme e OKB-së Gabriela Knaul, Shtojcë Raporti, Misioni në Federatën Ruse (2014), UN Doc. A/HRC/26/32/Add.1, paragrafët 24, 26.

¹²² *Bochan k. Ukrainës* (kërkesa nr. 7577/02) (3 maj 2007), paragrafi 72. Shih gjithashtu *Sutyagin kundër Rusisë* (kërkesa nr. 30024/02) (3 maj 2011), paragrafi 185.

¹²³ Pavarësia gjyqësore kërkon që gjykatësit të caktohen në gjykata dhe çështje në përputhje me procedura objektive dhe transparente, pasi një sistem *“jotransparent dhe subjektiv i caktimit të çështjeve është i cenusshëm ndaj manipulimit dhe korrupsionit”*. Sistemet jorastësore mund të jenë gjithashtu në përputhje me pavarësinë, për sa kohë që caktimi i çështjeve përcaktohet nga “kritere objektive”. Shih Raportuesen e Posaçme të OKB-së, Gabriela Knaul, Raport (2012), UN Doc. A/67/305.

rezultate të caktuara, duke qenë se Kryetari zakonisht ka njohuri mbi qëndrimet e gjykatësve individualë lidhur me çështje të veçanta juridike.¹²⁴ Ky shqetësim është veçanërisht i theksuar lidhur me përbërjen e Panelit të Apelit,¹²⁵ dhe një metodë e ngjashme e caktimit është përdorur nga Dhomat e Apelit të tribunaleve *ad-hoc* dhe ka zgjuar kritika të ngjashme.¹²⁶

Konsultimet ndërmjet Kryetarit, Administratorit dhe Prokurorit të Specializuar

75. Rregulla 12 parasheh këshillime ndërmjet Kryetarit dhe Administratorit, si dhe, kur është e nevojshme, ndërmjet Kryetarit dhe Prokurorit të Specializuar, për çështje që lidhen me administrimin e veprimtarisë gjyqësore.¹²⁷ Megjithëse e formuluar në terma administrativë, kjo dispozitë ngre çështje lidhur me përcaktimin e kufirit ndërmjet koordinimit administrativ dhe pavarësisë gjyqësore, veçanërisht në masën që lejon ndërveprim të drejtpërdrejtë ndërmjet akterëve gjyqësorë dhe prokurorialë jashtë pranisë së mbrojtjes.
76. Në Vendimin lidhur me Referimin e vitit 2017, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese vlerësoi se Rregulla 12 mund të prekte nenin 31 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën për një gjykim të drejtë. Dhoma theksoi se drejtësia natyrore kërkon respektimin e parimeve *audi alteram partem* dhe barazisë së armëve në të gjitha procedurat penale *inter partes*, si dhe që të gjitha palët, jo vetëm Prokurori i Specializuar, duhet të konsultohen për çdo çështje administrative që lind dhe që ndikon në zhvillimin e procedurave konkrete penale.¹²⁸ Ndonëse Dhoma nuk e shfuqizoi rregullën, ajo theksoi

¹²⁴ Michael G. Karnavas, “Kosovo Specialist Chambers – Part 3: Peculiar features of the Statute” (michaelgkarnavas.net/Blog, 20 shkurt 2019), i disponueshëm këtu; shih gjithashtu diskutimin në praktikë: KSC-BC-2020-06, F00434, Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit për vetëterheqjen e Presidentes Ekaterina Trendafilova nga caktimi i një Paneli të Apelit për të shqyrtuar ankesën e z. Thaçi për lirimin e përkohshëm, me Aneksin 1 konfidencial dhe Aneksin 2 publik, 16 gusht 2021, paragrafi 9.

¹²⁵ Michael G. Karnavas, “Dhomat e Specializuara të Kosovës – Pjesa 3: Veçoritë e veçanta të Statutit”. michaelgkarnavas.net/Blog, e disponueshme këtu.

¹²⁶ “The Self-Fragmentation of the ICTY Appeals Chamber” (23 janar 2014). EJIL: Talk! <https://www.ejiltalk.org/the-self-fragmentation-of-the-icty-appeals-chamber/>: “[J]urisprudenca e TPNJ-së mbetet në një gjendje ndryshueshmërie dhe fragmentimi lidhur me çështjen specifike të drejtimit – deri në atë masë sa fajësia ose pafajësia e të akuzuarve të veçantë do të varet në masë të madhe nga gjykatësit që caktohen në Dhomën e Apelit të tyre.”

¹²⁷ Rregulla 12 parasheh: “Pa cenuar pavarësinë e ushtrimit të funksioneve të tyre, nëse është e nevojshme, Kryetari dhe Administratori këshillohen me njëri-tjetrin dhe bashkërendojnë punën në lidhje me administrimin e veprimtarisë gjyqësore të Dhomave të Specializuara. 2Nëse është e nevojshme, për të njëjtën temë Kryetari mund të këshillohet edhe me Prokurorin e Specializuar.”

¹²⁸ DhSK, Vendimi mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe Provave të miratuar nga Seanca Plenare më 17 mars 2017 në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorin e Specializuar, paragrafi 32: “Për aq sa Rregulla 12

rëndësinë e sigurimit që zbatimi i saj të mos krijojë perceptime të mungesës së ekuilibrit ose të pabarazisë procedurale. Rregulla ka mbetur e pandryshuar në formën e saj të amendamentuar. Zbatimi i saj në praktikë trajtohet në Pjesën **IV.B**, më poshtë.

Vetëtërheqja ose heqja e gjykatësve të DhSK-së

77. Rregulla 20 e RrPP-së së DhSK-së rregullon vetëtërheqjen ose heqjen e gjykatësve të DhSK-së. Rregulla 20(1) parasheh se gjykatësi “*nuk mund të marrë pjesë në një çështje gjyqësore në të cilën gjykatësi ka interes personal ose në të cilën është përfshirë ose ka qenë përfshirë, që mund të ndikojë ose perceptohet se ndikon në paanshmërinë e gjykatësit, në pavarësinë gjyqësore ose në integritetin e procesit.*” Shkaqet specifike përfshijnë interesin personal në raste (përfshirë marrëdhënie familjare, profesionale ose vartëse me palët ose me Avokatin e Viktimave, apo situata që në mënyrë të arsyeshme mund të perceptohen si konflikt interesi); përfshirjen e mëparshme në procedura ligjore ku i dyshuari ose i akuzuari ka qenë palë; ushtrimin e mëparshëm të funksioneve, gjatë të cilave gjykatësi mund të ketë formuar një opinion që ndikon negativisht në paanshmëri; dhe çfarëdo arsye tjetër që në mënyrë të arsyeshme mund të duket se ndikon në paanshmëri.¹²⁹
78. Rregulla 20(2) vendos një detyrim për vetëtërheqje: gjykatësi që ka arsye të besojë se ekziston bazë për vetëtërheqje duhet t’i paraqesë menjëherë kërkesë konfidenciale Kryetarit, i cili mund ta zëvendësojë gjykatësin në përputhje me rrethanat.
79. Rregulla 20(3) i mundëson çdo palë të paraqesë kërkesë te Kryetari për heqje të gjykatësit, jo më vonë se dhjetë ditë pasi arsyet bëhen të njohura. Kryetari mund t’i hedhë poshtë në mënyrë të përmbledhur kërkesat që janë keqdashëse, të pabazuara ose pa substancë; përndryshe, krijohet një panel prej tre gjykatësish për të vendosur mbi çështjen. Procedura penale para këtij paneli i jep gjykatësit të kontestuar mundësinë për t’u përgjigjur, ndërsa palëve u lejohej të paraqesin vërejtje. Vendimet duhet të jenë të arsyetuara dhe publike, me përjashtim të redaktimeve të jashtëzakonshme.

parasheh konsultime të njëanshme ndërmjet Kryetarit dhe Prokurorit të Specializuar, kjo rregull mund të preki nenin 31 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Gjykata thekson se në të gjitha procedurat inter partes, drejtësia natyrore kërkon respektimin e parimeve ‘audi alteram partem’ dhe barazisë së armëve. Kjo domosdoshmërisht kërkon që pala tjetër të dëgjohet gjatë zhvillimit të çdo procedure. Prandaj, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 3(2) të Ligjit, të gjitha palët dhe jo vetëm Prokurori i Specializuar duhet të konsultohen për çdo çështje administrative që lind dhe që ndikon në zhvillimin e procedurave konkrete” (theks i shtuar).

¹²⁹ Rregulla 20(1) e RrPP-së së DSHK-së.

80. Rregulla 20(4) trajton çështjen nëse gjykatësi i kontestuar mund të vazhdojë të marrë pjesë në gjykim deri në marrjen e vendimit. Rregulla 20(5) parasheh se vendimet për heqjen e gjykatësit janë përfundimtare dhe nuk i nënshtrohen shqyrtimit nga shkalla më e lartë.
81. Rregulla 20(6) parasheh se, kur kërkesa ka të bëjë me Kryetarin, Zëvendëskryetari merr përsipër funksionet e Kryetarit sipas Rregullës 20. Në dukje, kjo duket se mbyll boshllëkun më të dukshëm. Nëse kjo ndodh në praktikë mbetet të vlerësohet në procedurat penale të përshkruara si më poshtë.

B. Praktika e zgjedhur

¹⁷² Shih McDermott lidhur me rreziqet që i janë të natyrshme një qasjeje holistike: “*Rreziku i qasjes holistike është se ajo mund të përdoret për të ‘mbuluar të çarat’, si të thuash, ose për të anashkaluar disa boshllëqe specifike në prova për shkak të një përshtypjeje të përgjithshme të gjykatësve se ky i akuzuar i veçantë është fajtor. Një qasje e tillë mund të jetë e përshtatshme në një sistem ku standardi i provës është l’*intime conviction du juge*, por është thellësisht e papërshtatshme në një sistem prove përtej dyshimit të arsyeshëm. Një thirrje ndaj holizmit mund të rezultojë gjithashtu në një rast më pak të fokusuar të prokurorisë.*” (Yvonne McDermott, Strengthening the Evaluation of Evidence in International Criminal Trials in Strengthening the validity of international criminal tribunals, Brill (2018), fq. 186-187.)

¹⁷³ *Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Urdhër ndaj ZPS-së në përputhje me Rregullën 136*, KSC-BC-2020-06/F03716, 2 prill 2026.

122. Vendimi nuk është pa vështirësi nga këndvështrimi i drejtësisë procedurale. Pavarësisht dallimit formal midis zbulimit dhe paraqitjes, efekti praktik i komunikimit të materialeve nga ZPS-ja drejtuar Panelit gjatë fazës së kuvendimit, përfshirë materialet e karakterizuara si shfajësuese para Panelit, por si fajësuese në procedura penale të veçanta,¹⁷⁴ është se Paneli ekspozohet ndaj informacionit të cilit mbrojtja nuk ka mundësi t'i përgjigjet.

C. Provat e paverifikuara

123. Rregullat 153 deri në 155 përcaktojnë mekanizmat konkretë proceduralë për pranimin e deklaratave me shkrim në vend të dëshmisë gojore. Rregulla 153 mundëson pranimin e dëshmive të regjistruara më parë nga procedura të tjera penale, kur dëshmitari nuk është në gjendje të paraqitet personalisht për të dëshmuar, në varësi të kushteve, përfshirë që prova të lidhet me vërtetimin e një çështjeje tjetër përveç veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarit, siç përshkruhen në aktakuzë, përveç nëse plotësohen garanci shtesë. Rregulla 155 parasheh pranimin e deklaratave të dëshmitarëve të vdekur, në varësi të kushteve të njëjta.
124. Të dy rregullat zbatohen brenda kufizimit të vendosur nga Rregulla 140(4)(a), e cila përcakton parimin kryesor kufizues për përdorimin e provave të paverifikuara: dënimi nuk mund të bazohet “vetëm ose në një masë vendimtare” në deklaratën e një dëshmitari të cilin mbrojtja nuk ka pasur mundësi ta merrte në pyetje. Ky rregull i jep efekt së drejtës themelore për gjykim të drejtë për të marrë në pyetje ose për të kërkuar marrjen në pyetje të dëshmitarëve, e garantuar me nenin 6(3)(d) të KEDNj-së, nenin 31(4) të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 21(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës.
125. Paneli i Apelit i DhSK-së në rastin *Shala* sqaroi se ndalimi i paraparë në Rregullën 140(4)(a) “zbatohet vetëm për faktet që përbëjnë elementet e krimeve ose mënyrat e përgjegjësisë së pretenduara, si dhe për çdo fakt tjetër të domosdoshëm për shqiptimin e dënimit”,¹⁷⁵ dhe se zbatohet edhe për “incidente penale individuale, edhe kur disa incidente të tilla përfshihen në një pikë të vetme

¹⁷⁴ *Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Urdhër ndaj ZPS-së në përputhje me Rregullën 136*, KSC-BC-2020-06/F03716, 2 prill 2026.

¹⁷⁵ *Prokurori i Specializuar k. Shalës*, Aktgjykim i Apelit, KSC-CA-2024-03/F00069/RED/, 14 korrik 2025, par. 478.

dbe, për rrjedhojë, nuk janë individualisht ‘të domosdoshme’ për një dënim”.¹⁷⁶ Paneli i Apelit gjithashtu theksoi se, kur një provë e paverifikur përdoret për të mbështetur një provë tjetër të patverifikuar, trupi gjykues duhet të tregojë kujdes për të siguruar që konstatimet e domosdoshme për një dënim të mos bazohen vetëm ose në mënyrë vendimtare në prova të paverifikuara.¹⁷⁷

126. Aktgjykimi i Apelit në rastin *Shala* gjithashtu zgjidhi një çështje të rëndësishme lidhur me marrëdhënien midis Rregullës 140(4)(a) dhe jurisprudencës së GjEDNj-së sipas nenit 6. Sipas praktikës përkatëse të Strasburgut, “faktorët kundërbalancues” (siç është mundësia e të akuzuarit për t’i marrë në pyetje dëshmitarët që kanë dëshmuar për veprime të ngjashme), në parim, mund të justifikojnë një dënim pavarësisht mbështetjes vendimtare në prova të paverifikuara, me kusht që gjykimi në tërësi të ketë qenë i drejtë.¹⁷⁸ Rregulla 140(4)(a) nuk parashihet kualifikim të tillë: ndalimi është kategorik dhe drejtësia e përgjithshme e procedurës nuk përbën mjet korrigjues.¹⁷⁹ Prandaj, rregulla funksionon si një standard minimal që as ZPS-ja dhe as Trupi Gjykues nuk mund ta anashkalojnë duke u mbështetur në cilësinë e përgjithshme të procedurës.
127. Këto parime kanë ndikim të drejtpërdrejtë në procedurën *Thaçi et al.* ZPS-ja argumentoi, në paragrafët 1408 dhe 1409 të parashtrësës së saj përfundimtare gjyqësore,¹⁸⁰ se moskundërshtimi nga mbrojtja i pranimit të disa deklaratave sipas Rregullave 153 dhe 155 përbënte heqje dorë nga drejta e mbrojtur nga Rregulla 140(4)(a) në fazën e dënimit.¹⁸¹
128. Në rastin *Shala*, ZPS-ja parashtrroi kërkesë sipas Rregullës 153 për pranimin e deklaratave me shkrim të dëshmitarëve që fillimisht ishin planifikuar të dëshmonin në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke i karakterizuar dëshmitë e tyre si kumulative ose konfirmuese të dëshmitarëve që dëshmuar në seancë. Trupi Gjykues i pranoi ato deklarata pavarësisht kundërshtimit të mbrojtjes. Paneli i Apelit konstatoi se dënimet që mbështeteshin në

¹⁷⁶ *Prokurori i Specializuar k. Shalës*, Aktgjykim i Apelit, KSC-CA-2024-03/F00069/RED/, 14 korrik 2025, par. 483. Një interpretim po aq kufizues i parimit të sanksionuar në Rregullën 140(4)(a) të RrPP të DHSK-së u hodh poshtë gjithashtu nga IRMCT në Aktgjykimin e Apelit në rastin *Karadžić* (paragrafët 460–475).

¹⁷⁷ *Prokurori i Specializuar k. Shalës*, Aktgjykim i Apelit, KSC-CA-2024-03/F00069/RED/, 14 korrik 2025, par. 480.

¹⁷⁸ *Prokurori i Specializuar k. Shalës*, Aktgjykim i Apelit, KSC-CA-2024-03/F00069/RED/, 14 korrik 2025, par. 485-486.

¹⁷⁹ *Prokurori i Specializuar k. Shalës*, Aktgjykim i Apelit, KSC-CA-2024-03/F00069/RED/, 14 korrik 2025, par. 485-486.

¹⁸⁰ *Thaçi et al.*, Transkripti i Deklaratës Përmbyllëse, 9 shkurt 2026, f. 28454. Shih gjithashtu Parashtrësën Përfundimtare të Veselit, par. 44.

¹⁸¹ *Thaçi et al.*, Transkripti i Deklaratës Përmbyllëse, 13 shkurt 2026, f. 28889.

mënyrë vendimtare në këto prova të pranuar, por të paverifikuara, shkelnin Rregullën 140(4)(a)¹⁸² dhe përgjegjësinë për situatën e krijuar ia atribuoi si ZPS-së, ashtu edhe Trupit Gjykses.¹⁸³ Paneli i Apelit në rastin *Shala* gjithashtu hodhi poshtë tezën se marrja në pyetje e dëshmitarëve të tjerë nga pala kundërshtare mbi fakte përgjithësisht të ngjashme mund të shërbejë si kundërbalancim i mjaftueshëm për mungesën e marrjes në pyetje nga pala kundërshtare të dëshmitarëve specifikë të paverifikuar.¹⁸⁴

129. Në rastin *Thaçi et al.*, dëshmitarët, të planifikuar fillimisht për të dëshmuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, u kaluan në pranim me shkrim në një fazë të vonë të procedurës, pasi dëshmitarë të tjerë të prokurorisë kishin përfunduar tashmë dëshminë e tyre.¹⁸⁵ Mënyra se si Trupi Gjykses trajton argumentin e heqjes dorë nga ZPS-ja, si dhe nëse ndonjë dënim mbështetet në mënyrë vendimtare në ato deklaratatë të paverifikuara, do të përcaktojë nëse aktgjykimi përkatës i reziston shqyrtimit sipas Rregullës 140(4)(a), siç është interpretuar në rastin *Shala*. Kjo çështje është veçanërisht e ndjeshme duke marrë parasysh përbërjen e materialit provues. Deri në mbylljen e fazës së provave në dhjetor 2025, rreth dy vjet e tetë muaj pas fillimit të gjykimit, 134 dëshmitarë kishin dëshmuar në gjykatore, ndërsa 164 deklaratatë shtesë dëshmitarësh ishin pranuar vetëm në formë të shkruar.¹⁸⁶ Rreth dy mijë nga mbi pesë mijë prova materiale ishin pranuar përmes procedurës së pranimit në tavolinë pas mbylljes së provave të prokurorisë.¹⁸⁷

D. Pranueshmëria e dokumenteve të siguruara nga autoritetet serbe

¹⁸² *Prokurori i Specializuar k. Shalës*, Aktgjykim i Apelit, KSC-CA-2024-03/F00069/RED/, 14 korrik 2025.

¹⁸³ *Ibid*, par. 593. Ai identifikoi në mënyrë të veçantë paraqitjen me vonesë nga ZPS-ja të kërkesave sipas Rregullës 153, pas afatit të caktuar nga Paneli i Gjykimit dhe pasi dëshmitarët kryesorë në gjykim kishin përfunduar dëshminë e tyre, si një faktor që mund të ketë deformuar strategjinë e marrjes në pyetje të Mbrojtjes ndaj këtyre dëshmitarëve. Në paragrafin 600, ai gjithashtu identifikoi dështimin e ZPS-së për të nxjerrë nga dëshmitarët e saj në gjykim prova të afta për të korroboruar ose sqaruar pretendimet vendimtare të paverifikuara si një dimension të mëtejshëm të përgjegjësisë së prokurorisë, duke vënë në dukje se boshllëku provues ishte krijuar nga mënyra se si ZPS-ja kishte zgjedhur ta paraqiste çështjen e saj. Paneli arriti në përfundimin se dënimet që rezultuan shkelnin Rregullën 140(4)(a) dhe të drejtën themelore të Shalës për një gjykim të drejtë, dhe nuk mund të qëndronin në atë masë.

¹⁸⁴ *Prokurori i Specializuar k. Shalës*, Aktgjykim i Apelit, KSC-CA-2024-03/F00069/RED/, 14 korrik 2025, par. 595.

¹⁸⁵ KSC-BC-2020-06, Version i mëtejshëm i redaktuar i versionit publik të redaktuar të Parashtrësës Përfundimtare Gjyqësore në emër të Kadri Veselit me Shtojcat konfidenciale 1 dhe 2, F03666/RED2, 19 janar 2026, par. 44.

¹⁸⁶ Prej të cilëve 125 ishin thirrur nga Prokuroria, dy nga Këshilltari i Viktimave dhe shtatë nga Mbrojtja.

¹⁸⁷ KSC-BC-2020-06, Further Redacted Version of Public Redacted Version of Final Trial Brief on Behalf of Kadri Veseli with Confidential Annexes 1 and 2, F03666/RED2, 19 January 2026, para. 82.

130. Pranimi i provave të siguruara nga autoritetet serbe ka qenë ndër çështjet më të kontestuara në procedurat penale pranë DhSK-së, veçanërisht në rastin *Thaçi et al.* (Rasti 6). Shqetësimet janë bazuar në tre faktorë të ndërlidhur:
- a. Faktori i parë është qëndrimi politik dhe juridik i Serbisë ndaj Kosovës.¹⁸⁸ Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës (sipas nenit 182 të Kushtetutës së Serbisë, Kosova vazhdon të përcaktohet formalisht si krahinë serbe) dhe vazhdon ta konsideroj UÇK-në organizatë terroriste. Sipas dokumentimeve të Qendrës për të Drejtën Humanitare, që nga viti 2012, politika zyrtare e kujtesës në Serbi është ndërtuar mbi një narrativë të viktimizimit serb dhe të heroizimit të forcave të armatosura serbe, si dhe mbi përjashtimin sistematik të krimeve të kryera nga forcat serbe kundër shqiptarëve të Kosovës – një narrativë e promovuar në mënyrë aktive përmes mediave të kontrolluara nga shteti.¹⁸⁹
 - b. Faktori i dytë është interesi i demonstruar institucional i Serbisë në rezultatet e DhSK-së në ndjekjet penale lidhur me UÇK-në.¹⁹⁰ Në vitin 2018, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme të Serbisë, Veljko Odalović, deklaroi publikisht se Serbia kishte gjurmuar arkiva dhe kishte bashkëpunuar me persona që posedonin informacione relevante për të prodhuar dokumente lidhur me krimet e pretenduara të UÇK-së.¹⁹¹ Prokurori serb Dragoljub Stanković është raportuar të ketë përshkruar rolin e tij si person për gjetjen dhe inkurajimin e dëshmitarëve për të dhënë deklarata para ZPS-së, duke e cilësuar këtë si shërbim ndaj interesave të Serbisë përmes vënies në pah të viktimave serbe dhe avancimit të çështjeve që TPNJ-ja nuk i kishte zgjidhur.¹⁹² Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, i ka karakterizuar procedurat penale pranë DhSK-së si mundësi për të demonstruar kriminalitetin e UÇK-së dhe për të kundërshtuar atë që ai e ka

¹⁸⁸ Shih, për shembull, shqetësimet e ngritura në KSC-BC-2020-06, Versioni i redaktuar publik i mocionit të përbashkët të mbrojtjes për zbulim në përputhje me Rregullën 103, me anekset publike 1-3 dhe aneksin konfidencial 4 (F00877, i datës 12 korrik 2022), 21 korrik 2022.

¹⁸⁹ Qendra për të Drejtën Humanitare, *Politikat e kujtesës në Serbi* (2021), i disponueshëm në https://www.hlc-rcd.org/wp-content/uploads/2021/10/Politika_secanja_en.pdf

¹⁹⁰

¹⁹¹ Koha.net, “Serbia ka shumë dokumente që dëshmojnë krimet e UÇK-së” (2018), i disponueshëm në <https://www.koha.net/en/arberi/serbia-ka-shume-dokumente-qe-deshmojne-krimet-e-uck-se>

¹⁹² Kosovo Online, “Serbia siguroi dëshmitarë kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së” (5 nëntor 2020), i disponueshëm në <https://www.kosovo-online.com/vesti/hronika/srbija-obezbedila-svedoke-protiv-bivsih-pripadnika-ovk-5-11-2020>

quajtur “*lobin shqiptar*” në Kongresin e Shteteve të Bashkuara.¹⁹³ Këto deklarata nuk krijojnë në vetvete papërshtatshmëri: një shtet që ofron prova dhe inkurajon dëshmitarët të flasin, nuk vepron, në vetvete, veprim të papërshtatshëm, dhe dëshira për drejtësi për viktimat serbe është legjitime. Megjithatë, ajo që mund të thuhet është se Serbia e ka trajtuar angazhimin e saj me ZPS-në si çështje të interesit shtetëror, çka është relevante për mënyrën se si duhet vlerësuar besueshmëria dhe pavarësia e këtij angazhimi.¹⁹⁴

c. Faktori i tretë lidhet me prejardhjen dhe integritetin e dokumenteve të sekuestruara nga forcat serbe të sigurisë gjatë konfliktit të viteve 1998–99.¹⁹⁵ Ky shqetësim bazohet në konstatimet e Dhomës së Gjykimit të TPNJ-së në rastin *Dorđević* lidhur me inskenimin e skenave të fabrikuara të krimit dhe përpjekjet më të gjera të akterëve shtetërorë serbë për të shtypur, larguar dhe fshehur provat e krimeve të kryera kundër civilëve shqiptarë të Kosovës.¹⁹⁶

131. Këto shqetësime nuk qojnë në konkluzionin se materiali me burim nga Serbia është i papranueshëm *per se* si kategori. Vetë origjina e tyre nuk mund të jetë përcaktuese: konstatimet se akterë shtetërorë serbë kanë fabrikuar skena dhe kanë fshehur prova gjatë konfliktit nuk dëshmojnë se çdo dokument që pretendohet se u është sekuestruar pjesëtarëve të UÇK-së nga forcat serbe është *domosdoshmërisht* i pabesueshëm. E njëjta vlen edhe për dëshmitarët e identifikuar nga autoritetet serbe për qëllimet e këtyre procedurave penale.

¹⁹³ Telegraf, “Ofensiva e Serbisë në Kongresin e SHBA-së”, i disponueshëm në: <https://www.telegraf.rs/english/3089889-we-reveal-details-of-serbias-offensive-on-us-congress-world-will-finally-hear-about-klan-crimes>

¹⁹⁴ Shih gjithashtu pretendimet e ngritura në KSC-BC-2020-06, Versioni publik i redaktuar i Parashtrësës Paragjyqësore të Jakupskit, 22 tetor 2022, para. 27: “[...] Është e qartë se një pjesë e madhe e provave të ZPS-së burojnë drejtpërdrejt nga Shteti serb ose, të paktën, janë mbledhur me ndihmën e Serbisë. ZPS-ja mbështetet në dëshmitarë drejtpërdrejt nga shërbimet e inteligjencës serbe, përfshirë ata që ishin aktivë në Kosovë gjatë konfliktit. Në të vërtetë, disa prej këtyre dëshmitarëve duket se kanë qenë pjesë e, ose përndryshe kanë mbështetur individë të përfshirë në, një plan të përbashkët të regjimit serb për kryerjen e krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës ndaj popullit të Kosovës dhe që ishin të përkaushtuar ndaj mposhtjes së UÇK-së që u dilte përpara. **Një dëshmitar i tillë, [REDAKTUAR], madje është ofruar me incentiva nga kreu i shërbimit të inteligjencës serbe dhe nga Presidenti serb për të bashkëpunuar me ZPS-në. [REDAKTUAR] duket se janë kontaktuar përmes Shtetit serb dhe një përfaqësues i Serbisë ka marrë pjesë në intervistat e tyre me ZPS-në. [REDAKTUAR]**” (referencat në fusnota janë hequr).

¹⁹⁵ Shih, për shembull, shqetësimet e ngritura në KSC-BC-2020-06, Versioni i redaktuar publik i parashtrimit paraprak të Jakupskit, 22 tetor 2022, paragrafi 28; KSC-BC-2020-06, Versioni i redaktuar publik i mocionit të përbashkët të mbrojtjes për zbulim në përputhje me Rregullën 103, me anekset publike 1-3 dhe aneksin konfidencial 4 (F00877, i datës 12 korrik 2022), 21 korrik 2022; KSC-BC-2020-06, Versioni i mëtejshëm i redaktuar i versionit të redaktuar publik të parashtrimit përfundimtar gjyqësor në emër të Kadri Veselit me anekset konfidenciale 1 dhe 2, 19 janar 2026, paragrafi 78.

¹⁹⁶ TPNJ - *Prokurori k. Dorđević*, IT-05-87/1-T, Aktgjykim i Gjykimit, 23 shkurt 2011, par. 415-416, 483.

132. Si rrjedhojë, lindin dy kërkesa.

- a. Së pari, trajtimi nga shteti serb, ose përfshirja e tij në mbledhjen e provave, nuk mund të *merret* si neutrale. Ndonëse nuk mund të ekzistojë një rregull kategorik që zbaton standarde të ndryshme për pranueshmëri të provave sipas origjinës së tyre shtetërore, interesat specifike institucionale dhe sjellja e dokumentuar e shtetit serb të identifikuar më sipër janë faktorë që, kur ekzistojnë, lidhen drejtpërdrejt me *zbatimin* e rregullave të zakonshme që rregullojnë autenticitetin dhe zinxhirin e ruajtjes së provave. Si të tilla, gjykatësit duhet t'i zbatojnë këto rregulla me rigorozitet të veçantë – veçanërisht kur origjinalet mungojnë ose zinxhiri i ruajtjes nuk mund të verifikohet.¹⁹⁷ Vetëm pohimi i prejardhjes ose njohja e emrave brenda një dokumenti nuk duhet, pa elemente të tjera, të përmbushë standardin *prima facie* të autenticitetit.
- b. Së dyti, Mbrojtjes duhet t'i garantohet mundësi e mjaftueshme për të kundërshtuar si pranueshmërinë, ashtu edhe vlerën provuese të këtij materiali. Të dyja kërkesat mbështeten në jurisprudencën përkatëse ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, e cila e shtrin të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarët edhe mbi provat dokumentare dhe e konsideron të drejtën e të pandehurit për t'i kundërshtuar këto prova si pjesë të së drejtës për kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes. Për shembull, GjEDNJ-ja ka konstatuar shkelje kur gjykatat vendore kanë refuzuar në mënyrë të përsëritur kërkesat e të pandehurit për paraqitjen e dokumenteve origjinale që përbënin bazën e dënimit.¹⁹⁸ Komiteti për të Drejtat e Njeriut, duke interpretuar nenin 14 të KNDCP-së, ka theksuar gjithashtu se në rastet kur burimi i provave inkriminuese ka motiv për falsifikim, gjykatat duhet t'i trajtojnë ato me kujdes të shtuar dhe se dështimi për ta bërë këtë mund të përbëjë vetë shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë.¹⁹⁹

¹⁹⁷ Shih, në këtë drejtim, shqetësimet e ngritura në KSC-BC-2020-06, Versioni i mëtejshëm i redaktuar i versionit të redaktuar publik të parashtrimit përfundimtar gjyqësor në emër të Kadri Veselit me anekset konfidenciale 1 dhe 2, 19 janar 2026, paragrafët 29–32 dhe 77–78; KSC-BC-2020-06, Versioni i redaktuar publik i parashtrimit paraprak të Jakupskit, 22 tetor 2022, paragrafët 27–30; KSC-BC-2020-06, Deklaratat përmbyllëse gojore të Selimit – transkripti i 13 shkurtit 2026.

¹⁹⁸ GjEDNJ, *Papageorgiou k. Greqisë*, Kërkesa nr. 59506/00, 9 maj 2003, para. 35-43.

¹⁹⁹ Komiteti për të Drejtat e Njeriut (HRC), *Larrañaga k. Filipineve*, Komunikimi nr. 1421/2005, Mendime të miratuara më 24 korrik 2006, par. 7.4; HRC, *Arutyuniantz kundër Uzbekistanit (Komunikimi nr. 971/2001)*, 30 mars 2005, par. 6.3.

133. Në këtë situatë, dy çështje që lindin nga procedura penale *Thaçi et al.* (Rasti 6) meritojnë vëmendje:
- a. Mënyra se si Trupi Gjykses vlerëson provat nga autoritetet serbe;
 - b. Ecuria e çdo kërkesë të Mbrojtjes për zbulim që ka të bëjë me marrëdhënien e ZPS-së me Serbinë dhe zinxhirin e ruajtjes së materialeve të siguruara prej saj.
134. Për sa i përket çështjes së parë, konkluzionet tona janë të kufizuara, pasi çështja aktualisht ndodhet në fazën e kuvendimit dhe në pritje të aktgjykimit. Prandaj, vlerësimet e mëposhtme *paraprake* kufizohen në qasjen e deritanishme të Panelit.
135. Pikënisja e deklaruar nga Paneli, se “*fakti që këto dokumente vijnë nga një serb apo nga autoritetet serbe nuk ngre, në vetvete, dyshime lidhur me autenticitetin dhe/ose besueshmërinë e tyre në atë masë sa t’i bëjë të papranueshme*”,²⁰⁰ është juridikisht e qëndrueshme. Megjithatë, procedurat penale duhet të shqyrtohen nga afër për të vlerësuar nëse pragu për autenticitet *prima facie* është vendosur në një nivel që në praktikë e përmbys barrën e provës mbi Mbrojtjen. Në këtë drejtim, seancat e 20 dhe 25 marsit 2024 janë ilustruese dhe meritojnë vëmendje.
136. Paneli pranoi një fletore të shkruar me dorë dhe një dokument të daktilografuar me shtesa të shkruara me dorë, të dyja të paraqitura si regjistra bashkëkohorë të inteligjencës dhe kundër-inteligjencës së UÇK-së, të sekuestruara nga autoritetet serbe gjatë konfliktit dhe më pas të transferuara te ZPS-ja përmes TPNJ-së / Mekanizmit Ndërkombëtar Rezidual për Tribunalet Penale (MICT). Narrativi i ZPS-së për zinxhirin e ruajtjes nuk mbështetej në prova në dosje, por në një deklaratë nga procedurat penale në rastin *Haradinaj* në TPNJ, e cila nuk i ishte zbuluar Mbrojtjes dhe as nuk ishte paraqitur për pranim.²⁰¹ ZPS-ja pretendoi se “*Mbrojtja nuk kishte demonstruar ndonjë bazë për të vënë në dyshim autenticitetin e dokumentit*”, dhe se, meqenëse dëshmitari kishte njohur emrin e tij dhe të disa të tjerëve, “*përmbajtja e dokumentit dëshmonte prejardhjen e tij nga UÇK-ja dhe autenticitetin e tij, përfshirë kur merret në konsideratë së bashku me dokumente të tjera*”.²⁰²

²⁰⁰ KSC-BC-2020-06, Paneli, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të W00072, W02153 dhe W04586 sipas Rregullës 154, F01664, 10 korrik 2023, par. 35. Shih gjithashtu F01963, Vendim mbi Pranimin e Dokumenteve të Paraqitura W04769, 27 nëntor 2023, par. 28.

²⁰¹ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës gjyqësore, Rasti 6, 20 mars 2024.

²⁰² KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës gjyqësore, Çështja 6, 19 mars 2024, f. 13418.

137. Paneli i pranoi të dyja dokumentet. Me këtë veprim, pranoi se *“Mbrojtja nuk ka barrë prove në këtë drejtim”*, por më pas konstatoi se *“Mbrojtja nuk ka ofruar ndonjë shpjegim të besueshëm se përse dokumentet duhet të konsiderohen si diçka tjetër përveçse regjistra të mbledhjes së inteligjencës dhe kundër-inteligjencës të kryera nga individë të panjobur”*.²⁰³ Këto dy pohime janë në kundërshtim të brendshëm: nëse mungesa e një shpjegimi të besueshëm nga Mbrojtja funksionon si arsye për pranim, atëherë në praktikë barra është zhvendosur, pavarësisht nga ndarja e saj formale. Rëndësia e kësaj çështjeje thellohet nga shkalla e saj: Mbrojtja më tej pretendoi se ka identifikuar përmes platformës së menaxhimit të provave të Gjykatës të paktën 2,356 dokumente me origjinë nga Serbia ose organet e saj – një pjesë e konsiderueshme e tërësisë së dosjes provuese. Rrjedhimisht, standardi i autenticitetit i aplikuar ndaj materialit me burim nga Serbia nuk është çështje marginale; në fakt prek themelin provues të çështjes në tërësi.
138. Për sa i përket çështjes së dytë, Mbrojtja ka kërkuar, në të paktën dy raste, një urdhër zbulimi nga Paneli për të gjitha materialet me origjinë nga shteti serb, organet dhe përfaqësuesit e tij, së bashku me prejardhjen e çdo materiali të tillë të përdorur nga ZPS-ja.²⁰⁴ ZPS-ja e refuzoi këtë kërkesë, duke pretenduar se Mbrojtja nuk kishte demonstruar

²⁰³ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës gjyqësore, Çështja 6, 25 mars 2024, f. 13521: *“Së fundi, edhe pse Mbrojtja nuk ka barrë në këtë drejtim, Paneli konstaton se Mbrojtja nuk ka ofruar ndonjë shpjegim të besueshëm se përse dokumentet duhet të konsiderohen si diçka tjetër përveçse regjistra të mbledhjes së inteligjencës dhe kundër-inteligjencës të kryera nga individë të panjobur lidhur me individë të dyshuar për bashkëpunim me autoritetet serbe ose zyrtarë serbë. Paneli ka konstatuar në një vendim të mëparshëm, përkatësisht F01963, paragrafi 28, se nuk ka bazë për të sugjeruar se dokumentet e ofruara nga autoritetet serbe janë prima facie të dyshimta dhe se vetë Mbrojtja ka paraqitur dokumente të tilla për pranim. Rrjedhimisht, Paneli është i bindur se dokumentet janë prima facie autentike”*. Shih gjithashtu Transkriptin e seancës gjyqësore, Çështja 6, 20 mars 2024, f. 13506-13510: *“GJYKATËSI METTRAUX: [...] Natyrisht, ju nuk keni barrën për të provuar kushtet e pranimit apo për t’i përjashtuar ato. Është Prokuroria si palë që i paraqet provat ajo që duhet ta bëjë këtë. Por dua të kuptoj qëndrimin tuaj lidhur me atë dokument. A po na thoni se këto janë të falsifikuara, apo se keni prova për fabrikim të këtyre dokumenteve? Apo thjesht po theksoni se Prokuroria nuk ka përmbushur barrën e saj? [...] ZNJ. ROWAN: [...] Pika fillestare është se, duke marrë parasysh vakumin në të cilin paraqitet ky dokument, ai nuk mund të vetë-autentifikohet. Kur marrim parasysh si sfondin faktik të kësaj çështjeje ashtu edhe kontekstin në të cilin ka ndodhur kjo luftë, dhe nëse shikojmë përmbajtjen e dokumentit, përmbajtja e tij dhe niveli i njohurive të nevojshme për ta hartuar atë nuk janë të tilla që mund të konsiderohen ekskluzive për UÇK-në. Paneli dhe ZPS-ja nuk mund të përjashtojnë asnjë inferencë tjetër. Ky dokument mund të jetë po aq i mundshëm të jetë hartuar nga vetë inteligjenca serbe, sepse, natyrisht, për shembull, inteligjenca serbe mund të ketë pasur – nëse dokumenti është i vërtetë, gjë që nuk është qëndrimi ynë – zyrtarë serbë që mund të kenë pasur njohuri të ngjashme që do t’u mundësonin ta hartonin një dokument të tillë [...] GJYKATËSI METTRAUX: Do ta ndal këtu përsëri. Po flasim për këtë dokument. Nuk mendoj se ndihmon, të paktën për mua, të sugjerohet se diçka ka ndodhur diku tjetër. Do t’ju bëj pyetjen thjesht: **A keni ndonjë tregues se ky dokument është diçka tjetër përveç asaj që pretendon të jetë; dhe nëse po, mbi çfarë baze?** ZNJ. ROWAN: **Epo, i nderuar Gjykatës, sipas mendimit tim, kjo e përmbys barrën e këtij gjykimi.**” (theksimi i shtuar). Shih gjithashtu Çështja 6, Transkripti i seancës gjyqësore, 20 mars 2024, f. 13507.*

²⁰⁴ Shih KSC-BC-2020-06, Versioni i redaktuar publik i mocionit të përbashkët të mbrojtjes për zbulim në përputhje me Rregullën 103, me anekset publike 1–3 dhe aneksin konfidencial 4 (F00877, i datës 12 korrik

se marrëdhënia e saj me Serbinë, “*vetëm si e tillë*”, ndikonte në besueshmërinë ose kredibilitetin e provave të siguruara, dhe vetëm konfirmoi se asnjë provë me burim nga Serbia nuk po mbahej e fshehur në bazë të Rregullës 107. Qëndrimi i ZPS-së ishte se marrëdhënia e saj me Serbinë ishte e ngjashme me çdo burim tjetër informacioni. Fatkeqësisht, këto çështje mbeten të pazgjidhura në dosjen publike, pasi nuk është identifikuar asnjë vendim i disponueshëm publikisht lidhur me këto mocione, pavarësisht se datojnë nga viti 2023. Mungesa e çfarëdo vendimi të publikuar përbën në vetvete shqetësim për transparencën.

139. Në fund, duhet ritheksuar se këto vërejtje janë domosdoshmërisht paraprake: ato bazohen vetëm në dosjen publike, dhe çështjet që ngrenë kërkojnë një analizë më të hollësishme dhe më të detajuar sesa lejon fushëveprimi i këtij raporti.

E. Konkluzioni

140. DhSK-ja është themeluar me qëllim të ofrimit të drejtësisë, të cilën gjykatat vendore të rajonit nuk mundën ta siguronin në atë kohë, dhe për ta bërë këtë sipas një standardi që gëzon besim ndërkombëtar. Çështjet provuese të shqyrtuara në këtë pjesë nuk janë dytësore për këtë mision; ato janë veçanërisht të ndjeshme duke pasur parasysh kontekstin më të gjerë në të cilin zhvillohen këto procedura penale. Pavarësisht nëse pretendimet se procedurat penale pranë DhSK-së synojnë të rishkruajnë narrativin historik të konfliktit, janë të justifikuara apo jo (dhe ky raport nuk merr qëndrim në këtë drejtim), bazat provuese të çdo dënimi duhet të jenë të afta t’i rezistojnë shqyrtimit dhe ky shqyrtim mund të përmbushet vetëm përmes standardeve më të larta të drejtësisë²⁰⁵ dhe transparencës maksimale në mënyrën se si ndërtohet dhe përdoret dosja provuese. Një dosje e ngarkuar me materiale të pakontrolluara mirë nga aspekti i autenticitetit dhe me vlerë të kufizuar provuese nuk i shërben atij standardi; përkundrazi, e minon atë, duke dëmtuar aftësinë e Mbrojtjes për t’u përgatitur dhe duke u dhënë bazë kritikave që në kushte të tjera do të mund të kundërshtoheshin.

2022), 21 korrik 2022. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, Parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit për Konferencën e 11-të për Gjendjen e Çështjes (F00744), 21 mars 2022, paragrafët 31–32; KSC-BC-2020-06, Parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit për Konferencën e 12-të për Gjendjen e Çështjes (F00806/A01), 18 maj 2022.

²⁰⁵ Yvonne McDermott, *Setting the Highest Standards of Fairness, or Just ‘Fair Enough’*, në *Fairness in International Criminal Trials*, OUP (2016), f. 147.

141. Prandaj, rekomandohet që t'i kushtohet vëmendje e posaçme (përfshirë përmes një analize më të plotë) çështjeve provuese të identifikuar në këtë pjesë, si dhe ndikimit të tyre të kombinuar në aftësinë e Mbrojtjes për të përgatitur dhe paraqitur tezën e saj, me qëllim sigurimin që korniza provuese të përmbushë standardin e transparencës dhe të drejtësisë që burojnë nga mandati i DhSK-së.

VI. VËREJTJE PARAPRAKE MBI PARIMIN E BARAZISË SË ARMËVE

142. Kjo pjesë shqyrton parimin e barazisë së armëve në zbatimin e tij në procedurat pranë DhSK-së. Këtu identifikohen shqetësime paraprake në një sërë fushash – përfshirë qasjen në avokat mbrojtës, kohën dhe kushtet e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, zbulimin e provave, procedurat paralele, ndihmën juridike, mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të drejtën e përkthimit – përpara se të trajtojë në mënyrë më të thelluar çështjen e marrjes në pyetje nga trupi gjyqësor. Në këtë fazë nuk mund të bëhet asnjë konstatim përfundimtar për shkelje të barazisë së armëve; shqetësimet e identifikuar janë tregues paraparakë që kërkojnë analizë të vazhdueshme dhe sistematike dhe ky vlerësim mund të përfundohet vetëm pasi të shpallen aktgjykimet dhe të shqyrtohen në mënyrë të pavarur. Megjithatë, serioziteti dhe shtrirja e këtyre shqetësimeve si e tillë çon në rekomandimin e monitorimit të vazhdueshëm dhe me prioritet të procesit gjyqësor në të gjitha procedurat penale të DhSK-së.

A. Sfidat

143. Barazia e armëve është një tipar i qenësishëm dhe themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë. Dhoma e Apelit e DhSK-së ka konstatuar se “*e drejta për një gjykim të drejtë e garantuar me nenin 21 të Ligjit përfshin parimin e barazisë së armëve ndërmjet prokurorisë dhe të akuzuarit në një proces penal, i cili prek thelbin e garancive për një gjykim të drejtë*”.²⁰⁶ Paneli i Apelit ka vërejtur se “*ky parim mishëron detyrimin për të siguruar që asnjëra nga palët të mos vibet në disavantazh gjatë paraqitjes së rastit*”, dhe se GjEDNJ-ja e ka përshkruar atë si “*nënkuptim të detyrimit që secilës palë t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin - përfshirë provat - në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm krahasuar me palën kundërshtarë*”.²⁰⁷

²⁰⁶ KSC-CA-2022-01, Aktgjykim i Apelit (Gucati dhe Haradinaj), F00114, 2 shkurt 2023, par. 50.

²⁰⁷ KSC-CA-2022-01, Aktgjykim i Apelit (Gucati dhe Haradinaj), F00114, 2 shkurt 2023, para. 50. Edhe pse në këtë rast Paneli iu referua rastit *Dombo Bebeer kundër Holandës*, një vendim që lidhet me procedurat civile, ku referenca ndaj “secilës palë” nënkupton dy kundërshtarë në pozitë të barabartë dhe ku paditësi bart barrën e provës (shih Y. McDermott, *The Highest Standards of Fairness in Proving International Crimes*, OUP (2021), f. 35), GjEDNJ e ka përdorur në mënyrë të qëndrueshme të njëjtin formulim edhe gjatë vlerësimit

144. Shkeljet e parimit të barazisë së armëve janë konstatuar edhe në vetvete, ndonëse ato më së shpeshti shfaqen në lidhje me një element të caktuar të së drejtës për gjykim të drejtë dhe nuk janë të kufizuara në garancitë minimale të gjyimit të drejtë.²⁰⁸
145. Fuqia institucionale e prokurorisë - si një aktor i përhershëm me staf të përkushtuar - është një karakteristikë strukturore e procedurave penale, si në nivel vendor, ashtu edhe në atë ndërkombëtar, e cila duhet të merret parasysh në çdo vlerësim të barazisë së armëve.²⁰⁹ Në DhSK, ZPS-ja “*mori përsipër personelin dhe mandatin*” e TFHS-it në shtator 2016,²¹⁰ dhe që në korrik 2014, Kryeprokurori i TFHS-së kishte njoftuar se hetimi kishte prodhuar prova bindëse të mjaftueshme për të ngritur aktakuza ndaj disa ish-zyrtarëve të lartë të UÇK-së.²¹¹
146. Siç është theksuar edhe në hyrje, një analizë gjithëpërfshirëse e barazisë së armëve në DhSK tejkalon fushëveprimin e këtij raporti. Vlerësimi i një teme kaq të gjerë do të kërkonte vëzhgim të vazhdueshëm të procedurave penale me kohë dhe qasje në informacione që nuk mund të pasqyrohen në një raport të këtij lloji.
147. Në këtë kuptim, diskutimi i mëposhtëm evidenton shqetësime paraprake të identifikuara nga hulumtimi ynë, e të cilat kërkojnë vëmendje dhe analizë të mëtejshme:
- a. **Qasja në mbrojtje ligjore** - Udhëzimi Praktik i Zyrës Administrative të DhSK-së për vizitat dhe komunikimet e mbrojtjes parashih se vetëm avokati mbrojtjes dhe bashkë-avokati kanë të drejtë në vizita dhe komunikime të privileguara me

të pjesës penale të nenit 6 (shih p.sh. GjEDNJ, *Foucher kundër Francës*, Aplikimi nr. 22209/93, 18 mars 1997, para. 34; GjEDNJ, *Bulut kundër Austrisë*, Aplikimi nr. 17358/90, 22 shkurt 1996, para. 47; GjEDNJ, *Bobek kundër Polonisë*, Aplikimi nr. 68761/01, 17 korrik 2007, para. 56; GjEDNJ, *Klimentyev kundër Rusisë*, Aplikimi nr. 46503/99, 16 nëntor 2006, para. 95).

²⁰⁸ Clooney & Webb, *The Rights to a Fair Trial in International Law*, OUP, f. 748 (version elektronik).

²⁰⁹ Shih Y. McDermott, *The Highest Standards of Fairness in Proving International Crimes*, OUP (2021), f. 35; M. Fedorova, “The Principle of Equality of Arms in International Criminal Proceedings”, në C. Rohan dhe G. Zyberi (eds.), *Defense Perspectives on International Criminal Justice*, CUP (2017), f. 204–234, në f. 206; Charles C. Jalloh dhe Amy DiBella, “Equality of Arms in International Criminal Law: Continuing Challenges”, në William A. Schabas, Yvonne McDermott dhe Niamh Hayes (eds.), *The Ashgate Research Companion to International Criminal Law: Critical Perspectives* (Aldershot: Ashgate, 2013), f. 251, 263–264; M. G. Karnavas, “Kosovo Specialist Chambers – Part 3: The Rules of Procedure and Evidence (The Proceedings)”, michaelgkarnavas.net/Blog, 20 shkurt 2019, i disponueshëm [këtu](https://www.scp-ks.org/en/spo/special-investigative-task-force).

²¹⁰ <https://www.scp-ks.org/en/spo/special-investigative-task-force>

²¹¹ Deklarata e Kryeprokurorit të Task Forcës Speciale Hetimore, 29 korrik 2014, e disponueshme [këtu](#). Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, Konferenca Statusore e 16 shkurtit 2021 (Transkript) dhe KSC-BC-2020-06, Konferenca Statusore e 17 dhjetorit 2020 (Transkript).

personat e paraburgosur. Anëtarët e tjerë të ekipit të mbrojtjes (p.sh. asistentët e avokatit, menaxherët e rastit, konsulentët ligjorë) mund ta shoqërojnë avokatin ose bashkë-avokatin, por nuk mund të zhvillojnë vizita të privileguara në mënyrë të pavarur.²¹² Ky kufizim formal nuk pasqyron realitetin operativ të mënyrës se si, sipas përvojës së autorëve, funksionon një ekip mbrojtës në procedurat penale ndërkombëtare. Në praktikë, asistentët e avokatit (të quajtur edhe asistentë ligjorë), konsulentët ligjorë dhe menaxherët e rastit, në mënyrë të ngjashme, shpesh janë juristë të kualifikuar me përvojë të konsiderueshme dhe, në çdo rast, kryejnë një pjesë të madhe të punës që përfshin marrjen e udhëzimeve, shqyrtimin e provave me klientin dhe zhvillimin e strategjisë së rastit dhe hetimeve të mbrojtjes, shpesh përmes vizitave të veçanta dhe të drejtpërdrejta me të akuzuarin. Udhëzimi praktik që kufizon statusin e vizitave të privileguara vetëm për avokatin dhe bashkë-avokatin e injoron këtë ndarje të punës dhe krijon pengesë strukturore për përgatitjen efektive, e cila rëndon në mënyrë disproporcionale mbi të akuzuarit e paraburgosur, të cilët varen nga kontakti i rregullt dhe substancial me të gjithë anëtarët e ekipit të tyre ligjor.

- b. **Hapësira të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes:** Përtej kufizimit formal lidhur me atë se kush mund të zhvillojë vizita, janë ngritur gjithashtu shqetësime për infrastrukturën fizike në qendrën e paraburgimit. Sipas Zyrës Administrative, objekti operon në kapacitet maksimal të dhomave të vizitave dhe detyrohet të huazojë hapësira nga tribunale të tjera me njoftim të shkurtër, në disa raste duke konfirmuar vizitat vetëm disa orë më herët.²¹³ Për shembull, në një Konferencë Statusore në prill 2025 në rastin *Thaçi et al.*, disa ekipe të mbrojtjes e ngritën këtë çështje, duke vënë në dukje se koha e paparashikueshme e konfirmimit çrregullonte organizimin e udhëtimeve dhe, në të paktën një rast, aftësinë e të akuzuarit për t'u përqendruar në përgatitjen e tezës së mbrojtjes.²¹⁴
- c. **Koha e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes:** E drejta për kohë dhe hapësira të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes ka qenë çështje e kontestuar në Rastin 06 qysh në fazat e hershme. Në Konferencën Statusore të 16 shkurtit

²¹² DHSK, Udhëzim praktik për vizitat dhe komunikimet e mbrojtjes, i miratuar më 23 shtator 2020, i disponueshëm [këtu](#).

²¹³ KSC-BC-2020-06, Konferenca Statusore e 17 dhjetorit 2020 (Transkript), f. 26170-26175.

²¹⁴ KSC-BC-2020-06, Konferenca Statusore e 17 dhjetorit 2020 (Transkript), f. 26170-26175.

2021, ekipet e mbrojtjes paraqitën përshkrime të detajuara të pengesave që u ishin krijuar në përgatitje nga metodologjia e zbulimit të provave e ZPS-së, e përshkruar si një sistem që kërkonte nga mbrojtja të rindëronte tezën e prokurorisë nga një volum materialesh të papërzgjedhura.²¹⁵ ZPS-ja reagoi duke pretenduar se mbrojtja po “kërkonte shtyrje” dhe duke argumentuar se ekipet e mbrojtjes tashmë ndodheshin në një fazë të avancuar përgatitore (duke iu referuar parashtresave të detajuara të mbrojtjes në paraqitjen e parë si dëshmi të gatishmërisë), pavarësisht se parashtresa paraprake e ZPS-së nuk ishte zbuluar ende, si dhe duke u mbështetur, ndër të tjera, në rrezikun e frikësimit të dëshmitarëve për të justifikuar afatet e shkurtra kohore ndërmjet zbulimit nga ZPS-ja dhe fillimit të gjyqimit.²¹⁶ Mbrojtja vuri në dukje se akuzat për kërkim shtyrjeje ishin vështirë të mbështetshme ndaj ekipeve që kishin qenë pjesë e rastit vetëm prej disa muajsh, veçanërisht në krahasim me periudhën prej pesë vitesh që ZPS-ja kishte pasur në dispozicion për të përgatitur tezën e saj.²¹⁷

Sipas vlerësimit të autorëve, qëndrimi i ZPS-së u dobësua më tej nga një tension i brendshëm, pasi ajo po kërkonte një datë të përshpejtuar për gjykimin, ndërkohë që kundërshtonte sugjerimet e mbrojtjes që parashtresa paraprake e gjyqimit të paraqitej më herët, si dhe në një kohë kur një pjesë e konsiderueshme e zbulimit të provave të saj mbetej ende e papërfunduar. Mbrojtja Veseli e ka përshkruar qasjen e ZPS-së si një “politikë [...] për ta vënë Mbrojtjen në disavantazh deri në momentin e fundit të mundshëm” dhe për ta “mbajtur Mbrojtjen sa më shumë që të jetë e mundur në errësirë deri në momentin e fundit para gjyqimit”.²¹⁸ Ky tension ishte i parashikuar nga qëndrimi i artikuluar i ZPS-së në Konferencën Statusore të dhjetorit 2020, kur pranoi se mund ta paraqiste parashtresën paraprake të gjyqimit në qershor ose korrik 2021, por tregoi se do ta bënte këtë vetëm nëse gjyqimi do të pasonte tre muaj më vonë, duke lënë të kuptohej se do të shtynte paraqitjen më të hershme nëse gjyqimi do të caktohej për një datë më të vonshme, edhe kur një paraqitje më e hershme ishte praktikisht e realizueshme.²¹⁹ Sipas vlerësimit të autorëve, në pamje të parë, ky qëndrim duket vështirë i pajtueshëm me çdo gjë tjetër përveç një vendimi të

²¹⁵ KSC-BC-2020-06, Transkript i Konferencës Statusore, 16 shkurt 2021, f. 270-292.

²¹⁶ KSC-BC-2020-06, Transkript i Konferencës Statusore, 16 shkurt 2021, f. 277-282.

²¹⁷ KSC-BC-2020-06, Transkript i Konferencës Statusore, 16 shkurt 2021, f. 291-292.

²¹⁸ KSC-BC-2020-06, Transkript i Konferencës Statusore, 16 shkurt 2021, f. 287-288.

²¹⁹ KSC-BC-2020-06, Transkript i Konferencës Statusore, 17 dhjetor 2020, f. 199-202.

qëllimshëm për të rregulluar kohëzgjatjen e zbulimit të provave në mënyrë që të kufizohet periudha e përgatitjes së mbrojtjes.

ZPS-ja më në fund e paraqiti parashtrësën paraprake të gjykimit më 24 shkurt 2022, me një version fillestar të dorëzuar *ex parte* më 17 dhjetor 2021, megjithëse një pjesë e konsiderueshme e zbulimit të provave mbetej ende e papërfunduar dhe redaktime të gjera, përfshirë edhe në vetë aktakuzën, vazhdonin të ishin në fuqi deri në momentin kur mbrojtja paraqiti parashtrësat e saj paraprake në përgjigje. Gjykimi filloi më 3 prill 2023.

- d. **ProceduraT penale paralele:** Zhvillimi i procedurave penale paralele ndaj të njëjtit të akuzuar (*Thaçi et al. Rasti 06*) dhe *Thaçi et al. Rasti 12* (procedura penale për administrim të drejtësisë) është e paprecedent në praktikën e së drejtës penale ndërkombëtare. Mbrojtja ka ngritur disa kundërshtime ndaj kësaj strukture procedurale, përfshirë një kërkesë për ndarje të rastit në Rastin 12, por ato janë refuzuar pothuajse në të gjitha nivelet procedurale të disponueshme.²²⁰ GjEDNJ-ja ka theksuar se është thelbësore që si i akuzuari, ashtu edhe avokati i tij, të jenë në gjendje të marrin pjesë në procedurë penale dhe të paraqesin parashtrime pa u ekspozuar ndaj lodhjes së tepruar.²²¹ Pasojat praktike të detyrimit që i njëjti i akuzuar të përballet me dy gjykime paralele të këtij kompleksiteti janë të vetëkuptueshme: një i akuzuar në paraburgim që merr pjesë gjatë gjithë ditës në një rast ka kapacitet të kufizuar praktik për të marrë pjesë në mënyrë domethënëse në përgatitjen e një rasti tjetër. Kjo rëndohet më tej nga kufizimet e identifikuara në pikat (a) dhe (b) më sipër.

²²⁰ KSC-BC-2023-12/F00427-Red-Corr, Parashtrësat e Mbrojtjes Thaçi mbi kalendarin para-gjyqësor; KSC-BC-2023-12/F00602, Urdhër për caktimin e fillimit të gjykimit; KSC-BC-2023-12/F00612, Kërkesa e Mbrojtjes Thaçi për rishqyrtim dhe shtyrje; KSC-BC-2023-12/F00705, Vendim mbi kërkesën për shtyrjen e fillimit të procedurave të gjykimit; KSC-BC-2023-12/F00285+A01, Mocioni paraprak i Mbrojtjes Thaçi për ndarjen e aktakuzës dhe shtyrjen e procedurave ndaj z. Thaçi me Shtojcën 1 publike; KSC-BC-2023-12/F00354/KSC-BC-2023-12/Red, Vendim mbi mocionet paraprake për shtyrjen dhe ndarjen e procedurave; KSC-BC-2023-12/IA006/F00004-Red, Ankesë e Mbrojtjes Thaçi kundër “Vendimit mbi mocionet paraprake për shtyrjen dhe ndarjen e procedurave”; KSC-BC-2023-12/IA007/F00007 = KSC-BC-2023-12/IA006/F00009, Vendim i Gjykatës së Apelit mbi ankesat kundër “Vendimit mbi mocionin paraprak të Mbrojtjes Thaçi për juridiksion” dhe “Vendimit mbi mocionet paraprake për shtyrjen dhe ndarjen e procedurave”; KSC-CC-2025-31/F00003, Vendim i Dhomës Kushtetuese mbi referimin e Hashim Thaçit në Panelin Kushtetues lidhur me të drejtat themelore.

²²¹ GjEDNJ, *Makbfj kundër Francës*, Aplikimi nr. 59335/00, 19 tetor 2004, para. 40; GjEDNJ, *Barberà, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës*, Seria A nr. 146, 6 dhjetor 1988, par. 70.

- e. **Ndihma juridike:** Rregullorja e DhSK-së për ndihmë juridike u ndryshua në shkurt 2024 me qëllim uljen e ndjeshme të tarifave të ndihmës juridike në procedurat penale për shpërfillje. Shoqata e Avokatëve Mbrojtës, që janë të angazhuar para Gjykatave dhe Tribunalëve Ndërkombëtare (**ADC-ICT**) shprehu shqetësim se kjo ulje, të cilën e vlerësoi në rreth 60-74%, ishte vendosur në mënyrë të njëanshme, pa konsultim me avokatët e listuar pranë DhSK-së, apo me komunitetin më të gjerë juridik, dhe paralajmëroi se cenon të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë dhe rrezikon përfaqësimin efektiv.²²²
- f. **Balanca ndërmjet mbrojtjes së dëshmitarëve dhe së drejtës për gjykim të drejtë:** Regjimi i masave mbrojtëse për dëshmitarët në DhSK është jashtëzakonisht i gjerë. Në veçanti, Rregulla 80(4)(e) parasheh se, në bazë të një urdhri të Panelit për mbrojtjen e dëshmitarëve, masat mund të përfshijnë “*në rrethana të jashtëzakonshme dhe duke iu nënshtuar çdo garancie të nevojshme: (i) moszbulimin palëve të çfarëdo materiali ose informacioni që mund të çojë në zbulimin e identitetit të dëshmitarëve ose viktimave pjesëmarrëse në procedurë; ose (ii) anonimitetin e plotë të dëshmitarit*”.²²³ Rregulla 80(1) përcakton se çdo masë e tillë duhet të jetë “*në përputhje me të drejtat e të akuzuarit*”. Kjo shkon përtej çdo tribunali tjetër penal ndërkombëtar (ose të ndërkombëtarizuar). Në TPNJ, Dhoma e Gjyimit në rastin *Tadić* i dha anonimitet të pjesshëm disa dëshmitarëve të Prokurorisë,²²⁴ por praktika e përdorimit të dëshmitarëve anonimë nuk vazhdoi pas *Tadić*-it, dhe Rregulla 69(c) e Rregullores së Procedurës dhe Provave të TPNJ-së kërkon që identiteti i dëshmitarit t'i zbulohet mbrojtjes para dëshmisë së tij. E njëjta gjë vlen edhe në TPNR dhe SCSL. Po ashtu, në GjPN, çdo dëshmitar që jep dëshmi kundër të pandehurit duhet të heqë dorë nga anonimiteti i tij.²²⁵ Organet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

²²² Shoqata e Këshilltarëve të Mbrojtjes që janë të angazhuar pranë Gjykatave dhe Tribunalëve Ndërkombëtarë, “Deklaratë për shtyp: ADC-ICT shpreh shqetësim të madh lidhur me uljen e konsiderueshme të ndihmës juridike në Dhomat e Specializuara të Kosovës” (ADC-ICT, 6 maj 2024), në dispozicion këtu.

²²³ Theks i shtuar

²²⁴ Prokurori kundër *Tadić* (IT-94-1-T), Vendim mbi kërkesën e Prokurorit për masa mbrojtëse për viktimat dhe dëshmitarët, 10 gusht 1995, paragrafët 67–68, 75–85. Çështja *Tadić* filloi ndërsa Lufta në Bosnje ishte ende në vazhdim. ICTY konstatoi se, ndonëse “ekzistonin disa kufizime në marrjen në pyetje nga pala kundërshtarë”, ajo “duhej të mbronte dëshmitarët që ishin vërtet të frikësuar”, dhe se paragjykimi ndaj të drejtës së të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët mund të “zvogëlohej në mënyrë të konsiderueshme përmes garancive procedurale”.

²²⁵ Shih, për shembull, Prokurori kundër Ngudjolo Chui (ICC-01/04-02/12 A), Vendim mbi pjesëmarrjen e viktimave anonime në ankim dhe mbi mbajtjen e viktimave të ndjera në listën e viktimave pjesëmarrëse, 23 shtator 2013, paragrafi 19; Prokurori kundër Bemba Gombo (ICC-1/05-01/08-2027), Urdhri i dytë

kanë pranuar në mënyrë të qëndrueshme se aftësia e të pandehurit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij/saj dëmtohet seriozisht nëse ai/ajo nuk informohet për identitetin e dëshmitarit.²²⁶ Megjithatë, GjEDNJ-ja nuk i ndalon dëshmitarët anonimë, por kërkon një balancim për të vlerësuar nëse një gjykim mund të mbetet i drejtë në rrethana të tilla.²²⁷ Në Vendimin e Referimit të vitit 2017, Dhoma Kushtetuese e Specializuar pranoi se mund të “*pranohet që, në disa raste, mund të jetë e nevojshme të mos i zbulohen mbrojtjes disa prova për të ruajtur të drejtat themelore të një individi tjetër ose për të mbrojtur një interes të rëndësishëm publik*”,²²⁸ por theksoi se kjo duhet të zbatohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe se çdo masë e tillë “*duhet të kundërbalancohet në mënyrë të mjaftueshme përmes procedurave të miratuara nga autoritetet gjyqësore*”.²²⁹ Se çfarë konsistojnë në praktikë këto procedura kundërbalancuese dhe se a janë në përputhje me të drejtat e të akuzuarit, është çështje që kërkon shqyrtim më të thuktë.

- g. **Zbulimi i provave:** Zbulimi i provave është “*thelbësor për një gjykim të drejtë*”²³⁰ dhe një tjetër fushë në të cilën shqetësimet për barazinë e armëve shfaqen me intensitet të veçantë.²³¹ Fushëveprimi i këtij raporti nuk ka mundur një analizë të plotë. Megjithatë, çështjet që ngre zbulimi i provave meritojnë shqyrtim të posaçëm. Për shembull, ndikimi i zbulimit të vonuar, të pjesshëm dhe të paplotë në aftësinë e Mbrojtjes për të përgatitur mbrojtjen e saj ka qenë një temë e qëndrueshme në Rastin 06 (shih si më sipër). Siç u theksua më sipër, parashtrësit paraprake të mbrojtjes u dorëzuan në një kontekst të një aktakuze me redaktime të gjera, para

lidhur me kërkesat e përfaqësuesve ligjorë të viktimave për të paraqitur prova dhe pikëpamjet dhe shqetësimet e viktimave, 21 dhjetor 2011, paragrafi 19.

²²⁶ Në rastin *Asani k. Maqedonisë*, GjEDNJ-ja vuri në dukje se “në rastin e një dëshmitari plotësisht anonim, ku nuk dihet asnjë detaj për identitetin apo prejardhjen e dëshmitarit, mbrojtja përballet me vështirësinë e pamundësisë për t’i parashtruar dëshmitarit, dhe në fund jurisë, çdo arsye që dëshmitari mund të ketë për të gënjer” (*Asani kundër Maqedonisë* (kërkesa nr. 27962/10), 1 shkurt 2018). Shih gjithashtu *Khaleel k. Maldiveve* (Komunikimi nr. 2785/2016), 27 korrik 2018, 13 mars 2019, paragrafi 9.5; *Al-Khawaja k. Mbretërisë së Bashkuar* [GC] (kërkesat nr. 26766/05 & 22228/06), 15 dhjetor 2011, paragrafi 127; *Rove dhe Davis k. Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 28901/95, ECHR 2000-II, paragrafët 60-62; Vendimi i Referimit i vitit 2017, paragrafi 133.

²²⁷ *Asani k. Maqedonisë* (kërkesa nr. 27962/10), 1 shkurt 2018, paragrafi 36; Donohoe kundër Irlandës (kërkesa nr. 19165/08), 12 dhjetor 2013, paragrafët 79-94.

²²⁸ Vendimi i Referimit i vitit 2017, paragrafët 135–138.

²²⁹ *Ibid*, par. 137

²³⁰ A. Heinze, “Disclosure: International Criminal Courts and Tribunals”, *Max Planck Encyclopedia of International Procedural Law*, gusht 2020, para. 1.

²³¹ McDermott vëren se “[zbulimi i materialeve si inkriminuese ashtu edhe shfajësuese është pa dyshim një nga të drejtat e gjykit të drejtë më të kontestuara para gjykatave penale ndërkombëtare, dhe kjo prioritet nuk tregon shenja zbutjeje” (Y. McDermott, *The Right to a Fair Trial in Practice in International Criminal Trials në Fairness in International Criminal Trials*, OUP (2016), f. 81).

se të ishte caktuar data e gjykimit dhe para se ZPS-ja të kishte përfunduar procesin e saj të zbulimit: 68 identitete dëshmitarësh mbetën të panjohur për Mbrojtjen, ndërsa 46 mijë faqe materiale të reja, ose më pak të redaktuara, ende nuk ishin dorëzuar, me zbulimin e planifikuar vetëm 30 ditë para gjykimit.²³²

Në këtë kontekst, funksionimi praktik i Rregullës 110 të RrPP-së së DhSK-së, e cila parashih sanksione në rastet e zbulimit të vonuar dhe e cila është përshkruar si “*shembull premtues dhe progresiv i legjislacionit procedural liberal*”,²³³ meriton shqyrtim më vete: në veçanti, nëse ka funksionuar për të mbrojtur të drejtat e Mbrojtjes apo nëse zbatimi i saj është mbështetur në një masë të tillë në praktikën e TPNJ-së, saqë ka zbehur funksionin e saj mbrojtës.

- h. **E drejta për përkthim:** Në vazhden e profilin gjuhësor të personave të akuzuar deri më tani pranë DhSK-së, e drejta për përkthim kërkon shqyrtim të kujdesshëm. Tashmë vërejmë se në Rastin 6, në fazën e procedurës paraprake, përkthimi në shqip i “*përmbledhjes së detajuar*” të Prokurorisë sipas Rregullës 86(3)(b), e cila demonstroi relevancën e çdo elementi të materialit provues për secilën akuzë, me referencë të veçantë ndaj sjelljes së të dyshuarit në lidhje me veprën/veprat e pretenduara dhe e cila “*dubet të dorëzohet së bashku*” me aktakuzën, nuk u vu në dispozicion deri në mesin e vitit 2021, gjë që përbën një çështje me shqetësim të lartë, pasi njëri nga të akuzuarit nuk flet dhe nuk lexon anglisht.²³⁴ Dokumenti nuk është thjesht formalitet procedural: ai përbën mjetin kryesor, përmes të cilit i akuzuari mund të kuptojë rastin që ngrihet ndaj tij dhe t’i japë udhëzime kuptimplota ekipit të tij të mbrojtjes. Për më tepër, në atë periudhë, nga rreth 289 dokumente të dosjes së rastit, vetëm rreth 65 ishin përkthyer në shqip, ndërsa ndër dokumentet e papërkthyer gjendeshin vendime me rëndësi të madhe, përfshirë vendimin për konfirmimin e aktakuzës dhe vendimin mbi lirimin e përkohshëm.²³⁵ Çdo vonesë e mëtejshme e këtij lloji – në të gjitha rastet pranë DhSK-së – dhe

²³² See KSC-BC-2020-06/F01050/RED para. 15; KSC-BC-2020-06/F00952, Prosecution submissions for fourteenth status conference, 5 September 2022 (“F00952”), paras. 11 and 81; Transcript of Fourteenth Status Conference, pp. 1543-1544, 1559-156; Krasniqi PTB, para. 10; Selimi PTB paras 16-42.

²³³ A. Heinze, *The Kosovo Specialist Chambers’ Rule of Procedure and Evidence*, EJIL: Talk!, 17 gusht 2017. Shih gjithashtu Maria Stefania Cataleta dhe Chiara Loiero, LAP Lambert Academic Publishing, 2021, f. 108; M. G. Karnavas, *Kosovo Specialist Chambers – Part 6: The Rules of Procedure and Evidence (The Proceedings)*, 26 qershor 2017.

²³⁴ KSC-BC-2020-06, Transkript i Konferencës Statusore, 16 shkurt 2021, f. 259–260.

²³⁵ KSC-BC-2020-06, Transkript i Konferencës Statusore, 16 shkurt 2021, f. 259–260.

ndikimi i saj në aftësinë e të akuzuarve për të ndjekur procedurat penale dhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive në përgatitjen e mbrojtjes së tyre, kërkon shqyrtim dhe analizë të kujdesshme.

148. Shqetësimet e identifikuar më sipër përbëjnë tregues paraprakë që, në këtë fazë, nuk mund të mbështesin një konstatim për shkelje të barazisë së armëve në ndonjë rast të veçantë. Megjithatë, kërkojnë që të ndërmerren hapa për një vlerësim më të plotë, përfshirë përmes monitorimit të vazhdueshëm të gjykimeve.

B. Marrja në pyetje nga trupi gjykues

149. Nga shqetësimet e identifikuar përgjatë hulumtimit tonë, marrja në pyetje nga trupi gjykues trajtohet si më poshtë në mënyrë të detajuar për dy arsye: ato ndodhen në pikëtakimin e dy temave të tjera të trajtuara në këtë raport (paanshmëria gjyqësore dhe pranueshmëria e provave), si dhe prekin drejtpërdrejt tensionin strukturor që e karakterizon kornizën hibride të DHSK-së.
150. Korniza e DHSK-së i njeh Trupit Gjykues kompetenca të gjera inkuizitore krahas një strukture gjykimi akuzatore, në të cilën barra e provës bie mbi prokurorinë.²³⁶ Rregulla 127 e RrPP së DHSK-së rregullon paraqitjen dhe marrjen në pyetje lidhur me provat në një rend akuzator (duke përfshirë terminologjinë e së drejtës zakonore “*marrje në pyetje nga pala thirrëse*” dhe “*marrje në pyetje nga pala kundërshtarë*”), por parasheh shprehimisht se “*Gjykatësi mund t’i bëjë pyetje dëshmitarit në çdo fazë.*”²³⁷ Rregullat 132 dhe 137(1) shkojnë më tej, duke e autorizuar Panelin të kërkojë nga palët paraqitjen e provave shtesë, ose të thërrasë prova me iniciativën e vet, kur e konsideron “*të nevojshme për përcaktimin e së vërtetës*”. Neni 40(6)(e) i Ligjit për DHSK-në autorizon gjithashtu Panelin të urdhërojë paraqitjen e provave përtej atyre të mbledhura paraprakisht ose të paraqitura gjatë gjykimit nga palët. Neni 329(4) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës 2012, i inkorporuar me referencë, shton se trupi gjykues “*ka autoritetin të mbledhë prova që i konsideron të nevojshme për përcaktimin e drejtë dhe të plotë të çështjes*”.

²³⁶ Rregulla 140(1) e RrPP të DHSK-së (“*Trupi gjykues mund të shpallë një të akuzuar fajtor, në qoftë se fajësia vërtetohet jashtë dyshimit të arsyeshëm.*”).

²³⁷ Rregulla 127 e Rregullores së Procedurës dhe Provave të DHSK-së; Michael G. Karnavas, *International Criminal Law Review* 20 (Brill, 2020), 77-124, f. 89.

151. Ky tension kërkon shqyrtim nga perspektiva e barazisë së armëve. Michael Karnavas ka identifikuar qysh moti se kjo kornizë krijon një rol potencialisht të zgjeruar gjyqësor, duke paralajmëruar se gjykatësit e së drejtës civile “mund të dominojnë procedurat penale, duke kërkuar dhe pranuar prova që ata i konsiderojnë të nevojshme për të vërtetën, si dhe duke ndërhyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë në marrjen në pyetje të dëshmitarëve”.²³⁸ Ai ka paralajmëruar më tej se një përfshirje e tillë e theksuar e një paneli, krahasuar me një panel më pak ndërhyrës në një rast tjetër, “duhet të ngjallë shqetësim”.²³⁹

“Nga perspektiva e Mbrojtjes, kjo ka potencialin të ngrëjë çështje të mungesës së drejtësisë dhe paanshmërisë. Nga perspektiva e barazisë së armëve, Mbrojtja është në mënyrë të natyrshme në disavantazh, pavarësisht nëse procedurat penale zhvillohen në mënyrë më akuzatore apo më inkvizitore. Pa dyshim, Prokurori i Specializuar (i asistuar gjithashtu nga Avokati i Viktimave) nuk ka realisht nevojë për ndihmën e gjykatësve”.²⁴⁰ (Theks i shtuar)

152. Këto nuk ishin vërejtje të karakterit reaktiv, por shqetësime strukturore të identifikuara që në fazën e hartimit të kornizës, përpara fillimit të procedurave penale. Ajo që më pas është materializuar në Rastin *Thaçi et al.* (Rasti 6) duhet të analizohet në raport me atë paralajmërim fillestar.
153. Brenda dhjetë ditëve nga dhënia e dëshmisë nga dëshmitari i parë në prill 2023, ekipet e mbrojtjes së Thaçit dhe Selimit ngritën kundërshtime lidhur me mënyrën se si Paneli po e bënte marrjen në pyetje. Mbrojtja argumentoi se është detyrim i Prokurorit që të paraqesë provat e dëshmitarit *viva voce* kur konsiderohen relevante, dhe se marrja në pyetje e mbrojtjes në përgjithësi kufizohet në provat e nxjerra nga Prokurori. Nëse Paneli do të mund të parashtronte pyetje për çdo element që ZPS-ja e vendos në “rendin e materialeve për prezantim”, atëherë mbrojtja do të detyrohej të bënte kundër-pyetje për gjithçka në atë rend; se kundër-pyetjet në këtë mënyrë, si dhe rifillimi i kundër-pyetjeve pas marrjes në pyetje nga trupi gjykues, do të çonte në vonesa të tepruara dhe mund të detyronte vlerësimet e kohës së kundër-pyetjeve të trefishoheshin ose katërfishoheshin; dhe se nuk

²³⁸ Rregulla 127 e Rregullores së Procedurës dhe Provave të DHSK-së; shih gjithashtu: Michael G. Karnavas, “Kosovo Specialist Chambers – Part 6: The Rules of Procedure and Evidence (The Proceedings)” (michaelgkarnavas.net/blog, 26 qershor 2017) <https://michaelgkarnavas.net/blog/2017/06/26/kosovo-specialist-chambers-part-6/>.

²³⁹ Karnavas (n 238).

²⁴⁰ Karnavas (n 238).

është e përshtatshme që gjykatësit të shqyrtojnë deklaratat e një dëshmitari që nuk janë pranuar si prova për të “*nxjerrë linja të reja betimi*”.²⁴¹

154. Paneli ka konstatuar se fushëveprimi i kompetencës së tij për marrje në pyetje “*është i gjerë dhe nuk kufizohet nga asnjë konsideratë e temës apo e përmbajtjes*”.²⁴², duke vënë në dukje gjithashtu se, në rastin konkret, kishte pyetur dëshmitarin lidhur me një dokument të përfshirë edhe në rendin e materialeve për prezantim të ZPS-së, por se, në çdo rast, Paneli “*nuk kufizohet në marrjen në pyetje të dëshmitarëve vetëm mbi bazën e materialeve të listuara në rendin e materialeve për prezantim të palës që e thërret dëshmitarin*”.²⁴³
155. Për sa i përket kundërshtimit të mbrojtjes të një dokumenti të përdorur nga Paneli, të cilin mbrojtja e kishte cilësuar si të papranueshëm nga Gjykata e Apelit të Kosovës, Paneli ka konstatuar se do të shqyrtojë dhe do të vendosë mbi çdo kundërshtim të mbrojtjes ndaj çdo dokumenti të paraqitur mbi bazën e autenticitetit, dhe se në kohën e duhur do të vendosë edhe mbi kundërshtimin e mbrojtjes lidhur me autenticitetin e dokumentit të paraqitur dëshmitarit nga Paneli.²⁴⁴ Paneli ka theksuar më tej se Rregulla 143(3) e RrPP së DHSK-së (e cila rregullon marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga palët dhe ndalon pyetjet sugjестive në marrjen direkte në pyetje) nuk e detyron Panelin, pasi kjo dispozitë zbatohet për palët dhe jo për gjykatësit.²⁴⁵
156. Paneli i Apelit i DHSK-së e ka konfirmuar këtë qasje, vetëm duke kërkuar që marrja në pyetje të mos krijojë “*dysitime për paragjykim, cenim të të drejtave të të akuzuarit apo të mos ndërhyjnë në të drejtat e tij*”.²⁴⁶
157. Vendimet pasuese ilustrojnë pasojat provuese të kësaj kompetence të gjerë në praktikë.²⁴⁷ Në mars 2024, duke vendosur mbi një kundërshtim të mbrojtjes lidhur me përdorimin

²⁴¹ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës gjyqësore, 20 prill 2023, f. 3263-3264.

²⁴² *Ibid*, 3267. Paneli Gjyqësor u mbështet në nenin 40(6)(e) të Ligjit të DHSK-së dhe në nenin 329(4) të Kodit Penal të Kosovës 2012.

²⁴³ *Ibid* (n 241), 3266.

²⁴⁴ *Ibid* (n 241), 3263-3269.

²⁴⁵ *Ibid* (n 241), 3263-3269.

²⁴⁶ KSC-BC-2020-06, IA028/F00011, Paneli i Apelit, Vendim mbi ankesën e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit kundër urdhrat gojor të Panelit të Gjyimit mbi marrjen në pyetje (“Vendimi i Apelit”), 4 korrik 2023, para. 32.

²⁴⁷ Shih gjithashtu shqetësimet e ngritura në Parashtrimin Përfundimtar të Mbrojtjes së Selimit: “Gjatë gjithë gjyqimit, Paneli i ka bërë pyetje dëshmitarëve duke u bazuar në dokumente të paparaqitura si prova, shumë prej të cilave ishin të papranueshme në bazë të RPV-së, përfshirë deklaratat e individëve që nuk janë thirrur si dëshmitarë. Shumë prej atyre dokumenteve nuk janë pranuar si prova.” (KSC-BC-2020-06, Versioni i

nga gjykatësit të dokumenteve sipas Rregullës 102(3),²⁴⁸ Trupi Gjykues ka konstatuar se do të “*përpiqet të njoftojë palët për këtë fakt para fillimit të marrjes në pyetje*”, kur i paraqet dëshmitarit dokumente nga burime publike ose që i janë zbuluar mbrojtjes nga ZPS-ja në fillim të gjykimit, në përputhje me këtë rregull.²⁴⁹ Në qershor 2024, kjo qasje u zgjerua edhe për materialet sipas Rregullës 103.²⁵⁰ Nevoja për një njoftim të tillë duhet të vlerësohet në raport me shkallën e dosjes provuese: mbrojtja pranon mijëra dokumente përmes zbulimit nga ZPS-ja, dhe njoftimi paraparak se cilat prej tyre Paneli synon t'i përdorë është thelbësor për të reduktuar barrën e parashikimit dhe reagimit ndaj marrjes në pyetje nga trupi gjykues mbi të gjithë atë korpus, përveç përballjes me çështjen e prokurorisë. Se kjo praktikë kishte prodhuar tashmë pasoja konkrete provuese ilustron edhe nga pranimi nga Paneli, në maj 2024, i katër dokumenteve që ishin përdorur vetëm gjatë marrjes në pyetje nga trupi gjykues.²⁵¹

158. Dimensioni sasior i marrjes në pyetje nga trupi gjykues ofron kontekst të rëndësishëm. Deri më 11 nëntor 2024, pas afërsisht nëntëmbëdhjetë muajsh dëshmi dëshmitarësh, Paneli kishte shpenzuar 71 orë në marrje në pyetje të dëshmitarëve, duke tejkaluar kohën individuale të marrjes në pyetje të tre prej katër ekipeve të mbrojtjes të marra veçmas.²⁵² Për më tepër, mbrojtja në tërësi kishte shpenzuar edhe 31 orë e 23 minuta në kundër-

redaktuar publik i “Parashtrimit Përfundimtar të Mbrojtjes së Selimit me Aneksin 1 Konfidencial”, me version të redaktuar publik të Aneksit 1, 19 janar 2026, paragrafi 34 (referencat në fund janë hequr).

²⁴⁸ Rregulla 102(3) e RrPP të DHSK-së: “*Bazuar në nenin 21(6) të Ligjit, Prokurori i Specializuar i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim. 2Me kërkesë të Mbrojtjes, Prokurori i Specializuar vë në dispozicion çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie dhe lejon këqyrjen e çdo sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e Prokurorit të Specializuar, që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë, apo i përkasinin të akuzuarit. 3Nxjerrja e materialeve dhe provave të tilla bëhet pa vonesë. 4Prokurori i Specializuar i drejtohet menjëherë trupit gjykues në qoftë se ekzistojnë arsye për kundërshtimin e rëndësishëm materiale të informacionit të lartpërmendur.*” (theks i shtuar). KSC-BC-2020-06, In Court – Urdhër gojor, Urdhër mbi kundërshtimin e mbrojtjes ndaj përdorimit nga gjykatësit të dokumenteve të zbuluara mbrojtjes në bazë të Rregullës 102(3), 19 mars 2024, f. 13383.

²⁴⁹ Rregulla 103 e RrPP të DHSK-së: “Në varësi të Rregullës 107 dhe Rregullës 108, Prokurori i Specializuar zbulon menjëherë Mbrojtjes çdo informacion sapo ai të jetë në posedim, kontroll ose njohuri të tij ose të saj, i cili mund të sugjerojë në mënyrë të arsyeshme pafajësinë ose të lehtësojë fajësinë e të Akuzuarit, ose të ndikojë në besueshmërinë apo besueshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar.” Paneli i Gjykimit në rastin Gucati ka konstatuar se “në mënyrë të arsyeshme sugjeron” do të thotë se “informacioni në fjalë duhet të orientojë, në një mënyrë logjike, drejt pafajësisë ose drejt fajësisë së lehtësuar të të Akuzuarit, pavarësisht nëse ZPS e konsideron informacionin të besueshëm apo ‘fantazik’. Mbajtja e provave në mënyrë tjetër do të çonte në të drejtën e ZPS-së për të mbajtur prova shfajësuese në shkelje të së drejtës së të Akuzuarit për një gjykim të drejtë dhe të parimit të barazisë së armëve.” (shih KSC-BC-2020-07/F00413/RED, para. 43).

²⁵⁰ KSC-BC-2020-06, F02293, Paneli i Gjykimit, Vendim mbi kërkesën e Prokurorisë për pranimin e dokumenteve të paraqitura dëshmitarit W04739, konfidencial, 8 maj 2024.

²⁵² Në të njëjtën periudhë, prokuroria zhvilloi marrjen në pyetje direkte për rreth 201 orë; Këshilli për Viktimat përdori pak më pak se nëntë orë; ndërsa katër ekipet e mbrojtjes përdorën respektivisht 154, 54, 52 dhe 59 orë. Marrja në pyetje nga Panelit zgjati shtatëdhjetë e një orë.

pyetje për të trajtuar çështje të ngritura nga pyetjet e Panelit,²⁵³ krahasuar me vetëm dymbëdhjetë minuta të shpenzuara nga prokuroria në përgjigje të së njëjtës detyrë.²⁵⁴ BHRC-ja ka kërkuar të dhëna të përditësuara deri në vitin 2026 nga Zyra Administrative e DHSK-së por deri në momentin e publikimit të këtij raporti nuk kemi pranuar përgjigje.

159. Përtej dimensionit sasior, karakteri cilësor i marrjes në pyetje nga Paneli gjithashtu meriton vëmendje. Mbrojtja ka paraqitur një Kërkesë të Përbashkët më 13 nëntor 2024, duke kërkuar që Paneli të marrë masa për të garantuar dukjen e paanshmërisë në mënyrën e ushtrimit të pyetjeve.²⁵⁵ Në kërkesë u identifikuan tri shqetësime specifike:

- a. se Paneli nuk po e përdorte kompetencën e tij për marrje në pyetje për të testuar tezën e prokurorisë;
- b. se Paneli në mënyrë sistematike po u sugjeronte përgjigje dëshmitarëve përmes formulës “*nuk dua të ju drejtoj në një përgjigje të caktuar*” si parathënie e pyetjeve sugjestive;
- c. dhe se Paneli po e përdorte marrjen në pyetje për të nxjerrë prova kundër të akuzuarit që tejkalonin fushëveprimin e marrjes në pyetje direkte nga prokuroria.

160. Nuk është brenda fushëveprimit të këtij raporti të ndërmerret një analizë e plotë e të gjithë procesit të marrjes në pyetje dhe ndikimit në të drejtat e të akuzuarit për një gjykim të drejtë, veçanërisht pasi numri i dëshmitarëve të dëgjuar me dyer të mbyllura e bën një vlerësim të tillë domosdoshmërisht të pjesshëm. Sidoqoftë, në shqyrtimin e transkripteve të disponueshme publikisht, rezulton se formula “*nuk dua të ju drejtoj në një përgjigje të caktuar por ...*”, përdoret në mënyrë të përsëritur nga të paktën një anëtar i Panelit, përfshirë në disa raste si parathënie e pyetjeve sugjestive.²⁵⁶ Në këtë kontekst duhet marrë parasysh

²⁵³ KSC-BC-2020-06, Kërkesë e përbashkët e Mbrojtjes drejtuar Panelit të Gjyimit për marrjen e masave për të garantuar dukjen e paanshmërisë së procedurave dhe shmangien e paragjyimit ndaj mbrojtjes, F02718, 13 nëntor 2024, par. 20.

²⁵⁴ KSC-BC-2020-06, Kërkesë e përbashkët e Mbrojtjes drejtuar Panelit të Gjyimit për marrjen e masave për të garantuar dukjen e paanshmërisë së procedurave dhe shmangien e paragjyimit ndaj mbrojtjes, F02718, 13 nëntor 2024, par. 20.

²⁵⁵ Kërkesë e përbashkët e mbrojtjes drejtuar Panelit të Gjyimit për marrjen e masave për të garantuar dukjen e paanshmërisë së procedurave dhe shmangien e paragjyimit ndaj mbrojtjes, F02718, 13 nëntor 2024.

²⁵⁶ Shih për shembull, KSC-BC-2020-06 Transkriptet – Dëshmitari W04408, 7 shtator 2023; Dëshmitari Shaun Byrnes, 27 mars 2024; Dëshmitari Shaun Byrnes, 28 mars 2024; Dëshmitari Johann Fritsch, 22 maj 2024; Dëshmitari Jan Rickert, 29 maj 2024; Dëshmitari Kurtesh Fondaj, 25 qershor 2024 (shih në veçanti f.

efekti i autoritetit gjyqësor. Për më tepër, në të paktën një rast, një anëtar i Panelit i ka parashtruar pyetje një dëshmitari mbi një dokument të marrë nga interneti, pa njoftim paraprak për mbrojtjen.²⁵⁷

161. Siç u përmend më sipër, korniza e DHSK-së i jep Panelit një hapësirë të konsiderueshme veprimi si në vlerësimin e fakteve ashtu edhe të së drejtës. Në mungesë të kufizimeve në shtrirjen dhe drejtimin e tij, këto kompetenca krijojnë kushte që Paneli të funksionojë, në praktikë, si prokuror i dytë, duke ndikuar në barazinë e armëve. Atëherë mbrojtja detyrohet t'i përgjigjet jo vetëm tezës së prokurorisë, por edhe, në mënyrë efektive, tezës së Panelit, me të gjitha implikimet shtesë në burime që kjo sjell. Ky është një problem i parashikueshëm i integritetit të kompetencave të gjera inkuizitore në një kornizë akuzatore pa e zgjidhur plotësisht tensionin ndërmjet tyre apo pa vendosur mekanizma të mjaftueshëm mbrojtës.
162. Kjo çështje do të mund të vlerësohet në mënyrë të plotë vetëm pas publikimit të aktgjykimit të Panelit. Shkalla në të cilën çdo konstatim fajësie mbështetet në prova të nxjerra përmes marrjes në pyetje në mënyrë sugjestive ose spekulative përbën një tregues thelbësor nëse shqetësimet e identifikuara më sipër kanë pasur pasoja materiale për drejtësinë e procedurës penale në tërësi.

C. Konkluzioni

17195–17205: gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit lidhur me arrestimin dhe ndalimin e Blerim Kuqit, gjykatësi Mettraux pyeti nëse ishte “e arsyeshme të supozohet” se një palë e tretë ishte e shqetësuar (T.17195), nëse dëshmitari do të kundërshtonte se Jakup Krasniqi e kishte komunikuar urdhrin e arrestimit të policia ushtarake, si dhe nëse Bislim Zyrapit “nuk donte të kishte asnjë lidhje me arrestimin dhe burgosjen” e Kuqit (T.17195–96). Pyetja për Zyrapin ishte thirrje për spekulim në kuptimin e ngushtë: dëshmitari nuk kishte njohuri personale mbi motivet apo gjendjen mendore të Zyrapit në lidhje me arrestimin, dhe dokumenti që po i paraqitej nuk përmbante asgjë për arrestimin apo burgosjen. Ftesa për të shprehur opinionin mbi atë që Zyrapit donte apo synonte e shtynte dëshmitarin të dilte përtej provave të tij në spekulim. Avokati mbrojtës i z. Krasniqi kundërshtoi pikërisht mbi këtë bazë, dhe gjykatësi Mettraux e pranoi këtë: “Do ta riformuloj, z. Ellis. Mendoj se keni të drejtë” (T.17196). Gjykatësi Mettraux e riformuloi pyetjen duke e kthyer nëse dëshmitari do të kundërshtonte atë që “Bislim Zyrapit do të thoshte”, por siç vuri në dukje z. Ellis, kjo nuk e korrigjoi defektin: “Nëse kjo do të jetë dëshmia e një dëshmitari tjetër, atëherë duhet ta dëgjojmë nga ai dëshmitar, jo nga dikush që qartësisht nuk ka njohuri për të” (T.17204, theksimi i shtuar). Kryetari i trupit gjyqësor Smith e rrëzoi kundërshtimin dhe urdhëroi dëshmitarin të përgjigjej; Dëshmitari Paul Williams, 18 shtator 2025; Dëshmitari John Duncan, 23 shtator 2025.

257

KSC-BC-2020-06, Dëshmitari Jan Rickert, 29 maj 2024 (shih në veçanti f. 15707, si dhe f. 17015: “Z. ROBERTS: Së dyti, nëse mund të kaloj te disa pyetje nga gjykatësi Mettraux. Dhe kërkoj ndjesë që po i drejtohem Panelit me një pyetje, por do të më ndihmonte. Ishte një dokument të cilit in referua gjykatësi Mettraux. A është e mundur të kemi ERN-in e dokumentit në mënyrë që ta hap përmes Oficerit të Gjykatës? **GJYKATËSI METTRAUX:** Nuk mendoj se ka ERN, z. Roberts, por ndoshta mund ta gjeni online siç bëra unë. Është dokument i disponueshëm publikisht. Z. ROBERTS: Pra a e kuptoj saktë se ai nuk i është zbuluar mbrojtjes nga Prokuroria në këtë rast? **GJYKATËSI METTRAUX:** Nuk e kam verifikuar, z. Roberts. Z. ROBERTS: Pra kuptimi im në këtë aspekt është i saktë, që ai nuk është gjetur të paktën në dosjen e rastit. Kjo ishte gjithëcka që doja të verifikoja [...]” (theks i shtuar)).

163. Nuk mund të nxirret ndonjë përfundim për shkelje të barazisë së armëve vetëm mbi bazën e kësaj analize. Vlerësimi i drejtësisë së procedurave penale duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të marrë në konsideratë çdo masë korrigjuese apo element balancues të zbatuar nga Paneli. Disa prej presioneve të identifikuara mund të rezultojnë të jenë adresuar në mënyrë të përshtatshme brenda vetë procedurave penale, ndërsa të tjera jo. Për aq kohë sa rastet janë ende në proces, një vlerësim përfundimtar nuk mund të bëhet deri në shpalljen e aktgjyqimit dhe analizimin e arsytimit të tij. Megjithatë, kjo pjesë demonstroi ekzistencën e kushteve strukturore që mund të ngrejshin shqetësime lidhur me barazinë e armëve, disa prej të cilave janë shfaqur në mënyrë të dokumentuar dhe konkrete. Kjo justifikon monitorim të vazhdueshëm dhe sistematik.

VII. VËREJTJE PARAPRAKE MBI PARIMIN E LIGJSHMËRISË

164. Në “Aktgjykimin e vitit 2025 mbi referimin e Salih Mustafës lidhur me të drejtat themelore të garantuara nga nenet 31 dhe 33 të Kushtetutës së Kosovës (‘Aktgjykimi për referimin kushtetues Mustafa’)", Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese deklaroi se DHSK-ja vepron në përputhje si me parimin *nullum crimen sine lege* ashtu edhe me moszbatimin prapaveprues të ligjit penal.²⁵⁸ Megjithatë, ky angazhim i përgjithshëm nuk arrin të pasqyrojë kompleksitetet lidhur me parimin e ligjshmërisë të shkaktuara nga natyra dhe historia unike institucionale e DHSK-së, e cila kërkon që t’i kushtohet vëmendje e duhur praktikës së saj lidhur me këtë parim. Nuk është brenda fushëveprimit të këtij rishikimi të shqyrtohet praktika e DHSK-së për sa i përket çdo elementi të parimit të ligjshmërisë.²⁵⁹ Në përputhje me qëllimin e këtij rishikimi, fokusi vendoset në fushat e shqetësimit real ose potencial në praktikën e DHSK-së. Në këtë drejtim, shqyrtohen tre tema: 1) funksionimi i parimit *nullum crimen sine lege* në nivel ndërkombëtar, duke u fokusuar në nevojën për të siguruar që interpretimi gjyqësor i neneve 13 dhe 14 të Ligjit të DHSK-së të jetë në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së veprës; 2) funksionimi i parimit *nullum crimen sine lege* në nivel vendor, si në

²⁵⁸ *Prokurori i Specializuar k. Mustafa*, Aktgjykim mbi referimin e Salih Mustafës lidhur me të drejtat themelore të garantuara nga nenet 31 dhe 33 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, KSC-CC-2024-27/F00011, 17 prill 2025 (“Aktgjykimi për referimin kushtetues Mustafa”).

²⁵⁹ GJEDNJ ka një jurisprudencë të gjerë mbi nenin e KEDNJ-së që trajton, në mënyrë jo shteruese: *nullum crimen sine lege*; *nulla poena sine lege*; moszbatimin prapaveprues të ligjit penal; lex mitior; aksesueshmërinë dhe parashikueshmërinë; ndalimin e interpretimit të zgjeruar (analogjisë); si dhe përjashtimin për krimet ndërkombëtare.

kontekstin e veprave penale të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, ashtu edhe lidhur me mbështetjen e DHSK-së në Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale III (“**NPK III**”) si formë përgjegjësie penale; dhe 3) kompleksiteti i parimit *lex mitior* në jurisprudencën e fundit të DHSK-së. Analiza e këtyre fushave të praktikës së DHSK-së shfaq shqetësime se jurisprudenca e saj deri më tani nuk është angazhuar në mënyrë të duhur me një interpretim dhe zbatim kontekstual të parimit të ligjshmërisë brenda arkitekturës së saj unike institucionale.

165. Parimi i ligjshmërisë është i garantuar drejtpërdrejt në Kushtetutën e Kosovës,²⁶⁰ e po ashtu edhe përmes inkorporimit në të drejtën e brendshme të instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht nenit 11(2) të DUDNJ-së; nenit 15 të KNDCP-së; dhe nenit 7 të KEDNJ-së.²⁶¹ Edhe pse nuk ekziston ndonjë konflikt i dukshëm ndërmjet këtyre dispozitave, zbatimi i njëkohshëm i disa normave me të njëjtin fokus substancial mund ta ndërlikojë ndjeshëm interpretimin dhe arsyetimin gjyqësor. Ky problem potencial zbutet pjesërisht përmes një interpretimi më të gjerë të Kushtetutës, megjithëse nuk eliminohet plotësisht. Ndër normat e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, neni 7 i KEDNJ-së ka një rol të privilegjuar në Kushtetutën e Kosovës, pasi mbrojtja kushtetuese e të drejtave të njeriut interpretohet në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së.²⁶² Për këtë arsye, KEDNJ-ja dhe jurisprudenca e saj kanë një rol më të rëndësishëm në arsyetimin gjyqësor të DHSK-së, përfshirë edhe në raport me parimin e ligjshmërisë.
166. DHSK-ja ka një juridiksion të kufizuar *ratione materiae*, i cili shtrihet vetëm në si vijon:
- a. Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi krimet e përcaktuara në nenet 12-16, të cilat lidhen me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.
 - b. Dhomat e Specializuara gjithashtu kanë juridiksion mbi veprat penale sipas Kapitullit XXXII, neneve 384-386, 388, 390-407; Kapitullit XXXIII, neneve 409-411, 415, 417, 419, 421; dhe Kapitullit XXXIV, neneve 423-424 të Kodit Penal të

²⁶⁰ Neni 33 i Kushtetutës së Kosovës.

²⁶¹ Shih diskutimin më sipër në Pjesën IV.A. mbi “Zbatueshmërinë e KEDNJ-së dhe KNDCP-së”.

²⁶² Neni 53 i Kushtetutës së Kosovës.

Kosovës 2012, Ligji nr. 04/L-082, kur ato lidhen me procedurat penale zyrtare dhe zyrtarët e saj.²⁶³

167. Nenet 12 deri 16 të Ligjit të DHSK-së trajtojnë dy kategori veprash penale: krimet ndërkombëtare (krime kundër njerëzimit dhe krime lufte) dhe veprat penale vendore. Veprat penale vendore që bien brenda juridiksionit të DHSK-së kanë qenë të kriminalizuara gjatë gjithë periudhës së juridiksionit kohor të DHSK-së dhe nuk paraqesin shqetësime të dukshme nga perspektiva e parimit *nullum crimen sine lege* ose e ndalimit të zbatimit retroaktiv të ligjit penal. Rrjedhimisht, fokusi vendoset tek veprat penale ndërkombëtare.

A. *Nulla crimen sine lege* në nivel ndërkombëtar

168. Tribunalet penale ndërkombëtare *ad hoc* nuk ekzistojnë brenda kornizës juridike të brendshme të shteteve ndaj të cilave ushtrojnë juridiksion. Rrjedhimisht, aftësia e tyre për të ushtruar juridiksion nuk kufizohet nga e drejta penale e brendshme në fuqi në ndonjë shtet të caktuar në ndonjë kohë të caktuar, por bazohet në të drejtën zakonore ndërkombëtare siç ka qenë në kohën e kryerjes së veprës. Kjo u konfirmua nga Dhoma e Apelit e TPNJ në rastin *Tadić*:

*“... veprat e listuara në nenin 5 ishin pa asnjë dyshim pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare, dhe për rrjedhojë parimi nullum crimen sine lege nuk shkelet. Neni 5 madje mund të thuhet se është më kufizues se e drejta zakonore ndërkombëtare në fuqi në atë kohë, në kuptimin që kërkon provimin e një lidhjeje me një konflikt të armatosur. Rrjedhimisht, neni 5 është në përputhje me parimin nullum crimen sine lege”.*²⁶⁴

169. Ligji për DHSK-në përfshin përkufizime ligjore si për krimet kundër njerëzimit ashtu edhe për krimet e luftës. Megjithatë, neni 12 konfirmon se burimi i së drejtës që zbatohet për veprimet që përbëjnë krime ndërkombëtare është “*e drejta zakonore ndërkombëtare ... e zbatueshme në kohën kur janë kryer krimet*”. Duke qenë se Ligji për DHSK-në është miratuar më 3 gusht 2015, pra pas periudhës së juridiksionit kohor të DHSK-së (1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2000), mbështetja e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në të drejtën zakonore ndërkombëtare bashkëkohore është një aspekt i rëndësishëm për të

²⁶³ Neni 6 i Ligjit për DHSK-në.

²⁶⁴ *Prokurori k. Duško Tadić*, Çështja nr. IT-94-1-AR72, Vendim mbi kërkesën e Mbrojtjes për ankesë të ndërmjetme lidhur me juridiksionin, Dhoma e Apelit, 2 tetor 1995, paragrafi 141.

siguruar që DHSK-ja të veprojë në përputhje me parimin *nullum crimen sine lege*.²⁶⁵ Megjithatë, DHSK-ja nuk është tribunal ndërkombëtar. Si mekanizëm gjyqësor i Kosovës, ndjekjet penale para DHSK-së duhet gjithashtu të jenë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, si një parim kushtetues dhe në bazë të efektit juridik të brendshëm të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ashtu siç zbatohet në të drejtën e Kosovës. Siç është theksuar më parë, çështja e përputhshmërisë me parimin *nullum crimen sine lege* në nivel të brendshëm trajtohet në pjesën pasuese.

170. Nenet 13 dhe 14 të Ligjit për DHSK-në ofrojnë përkufizime statutoire të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Kjo krijon rrezikun e supozimit se këto përkufizime statutoire janë automatikisht në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare të zbatueshme. Ky rrezik shtohet nga vështirësia e natyrshme në përcaktimin e ekzistencës dhe shtrirjes së një norme të së drejtës zakonore ndërkombëtare siç është zbatuar në një periudhë të caktuar historike. Në këtë drejtim, parimet themelore të DHSK-së parashohin se: *“Për përcaktimin e së drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën kur janë kryer krimet, gjykatësit mund të ndihmohen nga burime të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë burime dytësore siç janë jurisprudenca nga tribunalet ndërkombëtare ad hoc, Gjykata Ndërkombëtare Penale dhe gjykatat e tjera penale.”*²⁶⁶
171. Formulimi i krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në Ligjin për DHSK-së është marrë nga Statuti i Romës. Ndonëse gjuha e këtyre veprave është përshtatur minimalisht për t’iu përshtatur kontekstit të DHSK-së dhe disa vepra themelore janë përjashtuar nga Ligji për DHSK-në, elementet kontekstuale të krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës janë plotësisht në përputhje me Statutin e Romës, ndërsa elementet e shumicës së veprave themelore janë në fakt të kopjuara drejtpërdrejt nga ai Statut. Meqenëse GjPN-ja ushtron kryesisht juridiksion në mënyrë prospektive, në përgjithësi nuk kufizohet nga parimi i ligjshmërisë në zbatimin e këtyre veprave penale ashtu siç janë përcaktuar në Statutin e Romës, edhe nëse ndonjë prej këtyre veprave mund të mos jetë në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare bashkëkohore. Megjithatë, kur juridiksioni i GjPN-së aktivizohet përmes një referimi nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara lidhur me një shtet që nuk është palë në Statut, shfaqen sfida të ngjashme të parimit të ligjshmërisë si ato që hasen në DHSK.

²⁶⁵ *Prokurori i Specializuar k. Mustafës*, Aktgjykim i Gjykimit, KSC-BC-2020-05/F00494/RED, 16 dhjetor 2022 (“Aktgjykimi i Gjykimit Mustafa”).

²⁶⁶ Neni 3(3) i Ligjit për DHSK-në.

172. Statuti i Romës u miratua më 17 korrik 1998, shtatë muaj pas fillimit të juridiksionit kohor të DHSK-së, dhe hyri në fuqi më 1 korrik 2002, një vit e gjysmë pas përfundimit të juridiksionit kohor të DHSK-së. Disa autorë kanë theksuar se disa vepra të parapara me Statutin e Romës mund të mos jenë kristalizuar si vepra penale sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e hartimit të Statutit të Romës. Në të vërtetë, Kryesuesi i Komitetit Hartues të Konferencës Diplomatike për Themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, M. Cherif Bassiouni, e po ashtu edhe përfaqësuesi i SHBA-së në Konferencën e Romës, Michael Scharf, kanë shprehur mendimin se vepra penale në konflikt të armatosur jo-ndërkombëtar (“KAJN”) e “rekrutimit të fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë vjeçare në forcat ose grupet e armatosura, apo shfrytëzimi i tyre për të marrë pjesë aktive në luftime”, nuk përbënte vepër penale sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e miratimit të Statutit të Romës.²⁶⁷ Kjo vepër është reflektuar në formë të pandryshuar edhe në Ligjin për DHSK-në.²⁶⁸
173. Pavarësisht përfshirjes në nenin 14 të Ligjit të DHSK-së, në masën që vepra penale e përdorimit ose rekrutimit të fëmijëve si ushtarë gjatë KAJN nuk ka qenë e ndaluar në të drejtën zakonore ndërkombëtare deri pas 31 dhjetorit 2000, ajo nuk bie brenda juridiksionit *ratione materiae* të DHSK-së. Megjithatë, përvoja e SCSL-së ilustron rrezikun që paraqet situata kur një vepër penale e përcaktuar në ligj mund të mos reflektojë në mënyrë të plotë të drejtën zakonore ndërkombëtare.
174. Në rastin *Prokurori k. Sam Hinga Norman*, i akuzuari u akuzua, ndër të tjera, për krimin e luftës: përdorimi dhe rekrutimi i fëmijëve ushtarë gjatë një KAJN, i cili ishte marrë drejtpërdrejt nga Statuti i SCSL-së prej Statutit të Romës, siç është rasti edhe me Ligjin për DHSK-në.²⁶⁹ I akuzuari paraqiti ankesë të ndërmjetme për të kundërshtuar juridiksionin *ratione materiae* të SCSL-së lidhur me këtë vepër, duke argumentuar se akuza binte ndesh me parimin e ligjshmërisë, meqenëse vepra nuk ishte e ndaluar në të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën relevante për aktakuzën. Shumica vendosi se ndjekja penale për këtë akuzë nuk ishte në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë.²⁷⁰ Megjithatë,

²⁶⁷ M.C. Bassiouni, “The Normative Framework of International Humanitarian Law: Overlaps, Gaps and Ambiguities” (2000) 75 *International Law Studies* 3, f. 20; dhe “United Nations Diplomatic Conference of Plenipotentiaries on the Establishment of an International Criminal Court”, Komiteti i Përgjithshëm, “Procesverbali përmbledhës i mbledhjes së 4-të”, A/CONF.183/C.1/SR.4 (20 nëntor 1998), para. 54.

²⁶⁸ Neni 14(1)(d)(vii) i Ligjit të DHSK-së.

²⁶⁹ *Prokurori k. Sam Hinga Norman*, Vendim mbi mocionin paraprak të bazuar në mungesë juridiksioni, SCSL-2004-14-AR72E, 31 maj 2004.

²⁷⁰ *Ibid*, par. 53-54.

opiniononi i pakicës i gjykatësit Robertson, sipas të cilit ndjekja penale për këtë akuzë do të shkelte parimin e ligjshmërisë, konsiderohet gjerësisht si juridikisht i saktë.²⁷¹

175. Është e mundur që krimi i përdorimit dhe rekrutimit të fëmijëve ushtarë të jetë i veçantë ndër krimet ndërkombëtare në juridiksionin e DHSK-së, pasi mund të mos ketë qenë i ndaluar sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën relevante të juridiksionit të saj kohor. Megjithatë, ky shembull pasqyron një rrezik më të gjerë. Siç është përmendur, gjatë përcaktimit të së drejtës zakonore ndërkombëtare, gjykatësit mund të shërbehen me burime ndihmëse, përfshirë jurisprudencën e GJPN-së dhe të tribunaleve *ad hoc*.
176. Mbështetja në burime që janë pas periudhës së juridiksionit kohor të DHSK-së rrezikon të çojë në një interpretim të së drejtës zakonore ndërkombëtare që është në mospërputhje kohore me *actus reus* në shqyrtim. Ky rrezik mund të duket i largët; megjithatë, në periudhën menjëherë pas miratimit të Statutit të Romës, e drejta zakonore ndërkombëtare penale ka kaluar një fazë të shpejtë zhvillimi. Për më tepër, e gjithë jurisprudenca e GJPN-së është e mëvonshme ndaj periudhës së juridiksionit kohor të DHSK-së. Kur mbështeten në burime ndihmëse, gjykatësit duhet të shqyrtojnë me kujdes nëse dhe në çfarë mase burimi përkatës pasqyron të drejtën që ka qenë e zbatueshme në kohën e ngjarjeve relevante për akuzën.

B. *Nullum crimen sine lege* në nivel vendor

177. Përputhja me parimin e ligjshmërisë në nivel ndërkombëtar sipas formulimit të TPNJ-së në rastin *Tadić* nuk është domosdoshmërisht e mjaftueshme për të siguruar që gjykatat vendore të respektojnë parimin e ligjshmërisë gjatë ndjekjes penale të veprave ndërkombëtare. Në nivel vendor, parimi i ligjshmërisë mund të kuptohet si kërkesë që sjellja në fjalë të ketë qenë e dënueshme nga gjykatat vendore në kohën kur ajo ka ndodhur. Në rastin *Kokkinakis k. Greqisë*, GJEDNJ-ja e shprehu parimin *nullum crimen sine lege* në këto terma:

“... një veprë penale duhet të jetë e përcaktuar qartë me ligj. Ky kusht përmbushet kur individit mund të dijë nga formulimi i dispozitës përkatëse dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e

²⁷¹ Për një diskutim më të plotë, shih G. Waschefort, *E drejta ndërkombëtare dhe fëmijët ushtarë*, Hart Publishing (2015), fq. 108-111.

*interpretimit të saj nga gjykatat, se cilat veprime dhe mosveprime do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht.*²⁷²

178. Në rastin *Vasiliauskas k. Lituanisë*, GJEDNJ-ja trajtoi zhvillimin gradual të së drejtës penale përmes interpretimit, duke konstatuar se “*Neni 7 i Konventës nuk mund të kuptohet si ndalim i qartësimi progresiv të rregullave të përgjegjësive penale përmes interpretimit gjyqësor në mënyrë rast pas rasti, për sa kohë që zhvillimi i tillë mbetet në përputhje me natyrën thelbësore të veprës dhe mund të ishte i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme...*”²⁷³ Këtu Gjykata trajtoi zhvillimin progresiv të së drejtës penale përmes interpretimit të së drejtës ekzistuese, dhe jo zbatimin prapaveprues të së drejtës.
179. Kadri Veseli, ndër të pandehurit e tjerë, e kundërshtoi juridiksionin lëndor të DHSK-së mbi bazën se jo të gjitha veprat penale sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare, për të cilat DHSK-ja ushtron juridiksion, ishin të inkorporuara në të drejtën e brendshme gjatë periudhës kohore të juridiksionit të gjykatës.²⁷⁴ Për më tepër, që një vepër e caktuar të ndiqet penalisht në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duhet të ketë ekzistuar një vepër korresponduese në të drejtën e brendshme në kohën përkatëse. Kundërshtimi i Veselit shtrihej edhe te mbështetja e DHSK-së në NPKIII si formë e përgjegjësive penale.²⁷⁵ Megjithatë, çështja nëse mbështetja e DHSK-së në NPKIII si formë përgjegjësie është në përputhje me parimin e ligjshmërisë ka qenë dytësore në kundërshtimin e tij.²⁷⁶ Ndonëse vetë koncepti i NPKIII ka qenë dukshëm i kontestuar, fokusi aktual është nëse përgjegjësia penale individuale e bazuar në NPKIII është në përputhje me parimin e ligjshmërisë.

Kundërshtimi i Veselit ndaj juridiksionit të DHSK-së mbi të drejtën zakonore ndërkombëtare

²⁷² *Kokkinakis k. Greqisë*, kërkesa nr. 14307/88 (GJEDNJ, 25 maj 1993), paragrafi 52.

²⁷³ *Vasiliauskas k. Lituanisë*, kërkesa nr. 35343/05 (GJEDNJ, 20 tetor 2015), paragrafi 155.

²⁷⁴ *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçi*, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, “Kërkesë paraprake e Mbrojtjes së Kadri Veselit për të kundërshtuar juridiksionin e DHSK-së”, KSC-BC-2020-06/F00223, 15 mars 2021 (“Kundërshtimi i Veselit”). Shih gjithashtu Lachezar Yanev, “To Custom or Not to Custom: A Battle for the Applicable Sources of Law at the Kosovo Specialist Chambers” (EJIL: Talk!, 10 gusht 2021) <https://www.ejiltalk.org/to-custom-or-not-to-custom-a-battle-for-the-applicable-sources-of-law-at-the-kosovo-specialist-chambers/>.

²⁷⁵ Kundërshtimi i Veselit, par. 94-119.

²⁷⁶ *Ibid*, paragrafët 91–119. Në këtë drejtim, Veseli argumentoi se mbështetja e DHSK-së në JCEIII pa një bazë statutore bie ndesh me ndalimin e interpretimit të zgjeruar të së drejtës penale sipas nenit 7 të KEDNJ-së dhe nenit 33 të Kushtetutës; se JCEIII nuk zbatohet për krimet me qëllim të posaçëm; dhe, në çdo rast, nuk ekziston një bazë e mjaftueshme e JCEIII në të drejtën zakonore ndërkombëtare.

180. Kushtetuta e vitit 1974 e RSFJ-së rregullonte inkorporimin e së drejtës ndërkombëtare në Kosovë gjatë periudhës kohore të juridiksionit të DHSK-së. Neni 181 i Kushtetutës së vitit 1974 potencon parimin e ligjshmërisë:

“Askush nuk mund të dënobet për asnjë veprim i cili, para kryerjes së tij, nuk ka qenë i përcaktuar si veprë e dënueshme me ligj ose me një dispozitë juridike të bazuar në ligj, ose për të cilin nuk është paraparë dënim. Veprat penale dhe sanksionet penale mund të përcaktoben vetëm me ligj. Sanksionet për veprat penale shqiptohen nga gjykata kompetente në procedura të rregulluara me ligj. Askush nuk mund të konsiderohet fajtor për një veprë penale pa u provuar me vendim të formës së prerë të gjykatës. Cilido person që është dënuar në mënyrë të padrejtë ose i është hequr liria pa arsye ka të drejtë rehabilitimi dhe kompensimi për dëmin nga shoqëria, si dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj.”

181. Neni 210 i asaj Kushtetute trajton inkorporimin e së drejtës ndërkombëtare publike, por i referohet vetëm së drejtës së traktateve. Neni në fjalë përcakton se, që një traktat të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykatat, ai duhet së pari të shpallet. Kjo sugjeron se, në kohën e kryerjes së veprave për të cilat akuzon DHSK-ja, veprat sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare nuk ishin drejtpërdrejt të zbatueshme në rendin juridik të Kosovës.

182. Në masën që argumenti bazohet në tezën se karakteri i brendshëm i DHSK-së kërkon që sjellja përkatëse të ketë qenë e dënueshme sipas së drejtës së brendshme në kohën e kryerjes së saj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar se *“ushtrimi i kategorizimit të një gjykate si vendore, ndërkombëtare, hibride apo tjetër, nuk është përcaktues për të drejtën që do të zbatohet gjatë gjykimit të rasteve”*.²⁷⁷ Ai shtoi se qëllimi i legjislatorit në krijimin e DHSK-së ishte krijimi i një gjykate të specializuar për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës, duke konkluduar se:

“Në vazhdim të konsideratave të mësipërme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se thelbi i dispozitave të nenit 7 të KEDNJ-së dhe nenit 15 të KNDCP-së, siç pasqyrohen në nenin 33(1) të Kushtetutës, qëndron në autoritetin e legjislatorit kosovar për të miratuar në mënyrë të ligjshme legjislacion të brendshëm që parasheh në mënyrë eksplicite krime ndërkombëtare tashmë ekzistuese sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën përkatëse. Në këtë mënyrë, legjislatori mund të mundësojë - ose madje të urdhërojë - ndjekjen penale për sjellje që ka ndodhur para se kriminalizimi

²⁷⁷ Ibid (n 275), par. 98.

*të ishte futur në të drejtën e brendshme. Në raste të tilla, nuk ka çështje të retroaktivitetit: legjislatori thjesht transpozon (në të drejtën e brendshme) krime që tashmë ishin pjesë e rendit juridik dhe të detyrueshme për individët sipas së drejtës ndërkombëtare në kohën e kryerjes së veprave.*²⁷⁸

183. Ky qëndrim bie në kundërshtim me pohimin e saktë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake se funksionimi i DHSK-së “*dubet të jetë në përputhje me garancitë kushtetuese, në veçanti me dispozitën për moszbatimin prapaveprues, të paraparë me nenin 33 të Kushtetutës, nenin 7 të KEDNJ-së dhe nenin 15 të KNDCP-së*”.²⁷⁹ Siç sugjeron rasti *Kokkinakis*, respektimi i parimit *nullum crimen sine lege* varet nga fakti nëse, objektivisht, i akuzuari mund të ketë ditur ose parashikuar se sjellja e tij mund të sillte përgjegjësi penale. Konstatimi se një legjislaturë mund të kriminalizojë sjellje për të cilat i akuzuari nuk mund të ishte ndjekur penalisht në kohën e kryerjes, edhe nëse ato përbënin krime sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare, nuk është plotësisht bindës.
184. Sa i përket parashikueshmërisë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar se, duke qenë se veprat në fjalë ishin krime sipas së drejtës ndërkombëtare në kohën përkatëse, i akuzuari mund të parashikonte se sjellja e tij mund të sillte përgjegjësi penale individuale.²⁸⁰ Në diskutimin e parimeve *nullum crimen, nulla poena sine lege* në rastin *Vasiliauskas*, GJEDNJ-ja theksoi se “*Si rrjedhojë e këtyre parimeve, një veprë penale dubet të jetë e përcaktuar qartë me ligj, pavarësisht nëse bëhet fjalë për të drejtën e brendshme apo atë ndërkombëtare*”.²⁸¹ Megjithatë, ky formulim është bërë në terma të përgjithshëm dhe jo në kontekstin specifik të ndjekjes penale vendore të krimeve sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare, kur nuk ishin të inkorporuara në të drejtën e brendshme në kohën përkatëse. Në këtë kuptim, arsyetimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake rrezikon të përziejë përputhshmërinë me ligjshmërinë në nivel ndërkombëtar me atë në nivel të brendshëm.

Juridiksioni i DHSK-së mbi NPKIII

185. Neni 16 i Ligjit për DHSK-në kodifikon format e përgjegjesisë penale brenda juridiksionit të DHSK-së për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit. Megjithëse NPKIII nuk përfshihet shprehimisht, përgjegjësia individuale penale shtrihet ndaj “*personit që ka*

²⁷⁸ *Ibid* (n 275), par. 101.

²⁷⁹ *Ibid* (n 275), par. 90.

²⁸⁰ *Ibid* (n 275), par. 90.

²⁸¹ *Ibid* (n 275), par. 90.

*planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer ose ndihmuar e mbështetur në planifikimin, përgatitjen ose ekzekutimin e” krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.*²⁸²

186. Neni 16(1) është materialisht identik me nenin 7(1) të Statutit të TPNJ-së. Kur TPNJ-ja fillimisht përmendi NPKIII në rastin *Tadić*, e bazoi arsyetimin në përgjegjësinë penale individuale sipas nenit 7(1) të statutit dhe arriti në përfundimin se NPK, përfshirë NPKIII, është “*mirë e konsoliduar në të drejtën zakonore ndërkombëtare*”.²⁸³ Dhoma e Apelit e TPNJ-së theksoi tri kategori të dallueshme të nocionit të planit të përbashkët si formë e përgjegjësisë për bashkëpjesëmarrje, dhe për kategorinë e tretë, NPKIII, përcaktoi kërkesat e mëposhtme të *mens rea*:

*“(i) qëllimi për të marrë pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale dhe për të avancuar – individualisht dhe së bashku – qëllimet kriminale të asaj ndërmarrjeje; dhe (ii) parashikueshmëria e mundësisë që anëtarët e tjerë të grupit të kryejnë vepra që nuk përbëjnë objektin e qëllimit të përbashkët kriminal. Prandaj, pjesëmarrësit duhet të kenë pasur në mendje qëllimin, për shembull, për të keqtrajtuar të burgosurit e luftës (edhe nëse një plan i tillë ka lindur në mënyrë të menjëhershme), dhe një ose disa anëtarë të grupit duhet të kenë kryer vrasjen e tyre. Në mënyrë që përgjegjësia për vdekjet t’u atribuohet të tjerëve, megjithatë, të gjithë anëtarët e grupit duhet të kenë qenë në gjendje ta parashikonin këtë rezultat. Duhet theksuar se kërkohet më shumë se neglizhenca. Kërkohet një gjendje mendore në të cilën një person, edhe pse nuk ka pasur qëllim të shkaktojë një rezultat të caktuar, ka qenë i vetëdijshëm se veprimet e grupit kishin shumë gjasa të çonin në atë rezultat, por megjithatë e ka pranuar me vetëdije këtë rrezik. Me fjalë të tjera, kërkohet i ashtuquajtimi *dolus eventualis* (i quajtur edhe “*pakujdesi e vetëdijshme*” në disa sisteme juridike kombëtare).”²⁸⁴*

187. Duke marrë parasysh qasjen e TPNJ-së në rastin *Tadić*, nuk është krejt e papritur që DHSK-ja ka vijuar mbi bazën se ka juridiksion edhe për NPKIII, të mbështetur si në nenin 16(1) të Ligjit për DHSK-në ashtu edhe në të drejtën zakonore ndërkombëtare. Megjithatë, në vitet pas rastit *Tadić*, baza zakonore e NPKIII është sfiduar në mënyrë të konsiderueshme, përfshirë nga Dhoma e Gjykatës Supreme të ECCC-së, e cila konstatoi se, ndryshe nga gjetjet në rastin *Tadić*, e drejta zakonore ndërkombëtare nuk ofronte një

²⁸² Neni 16(1)(a) i Ligjit të DHSK-së.

²⁸³ *Prokurori k. Duško Tadić*, Çështja nr. IT-94-1-AR72, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ankesë të Ndërmjetme lidhur me Juridiksionin, Dhoma e Apelit, 2 tetor 1995, paragrafi 220.

²⁸⁴ *Ibid.*

“bazë mjaftueshëm të qëndrueshme” për përgjegjësinë penale të bazuar në NPKIII në kohën përkatëse të aktakuzës.²⁸⁵ Megjithatë, siç u theksua, fokusi mbetet në çështjen e interpretimit të zgjeruar të së drejtës penale.

188. Në rastin *Vasilianskas*, GJEDNJ-ja ka konstatuar se: “Gjykata dubet të verifikojë nëse interpretimi i veprës nga gjykatat vendore... ishte në përputhje me thelbin e asaj vepre dhe mund të ishte i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme”. Ky parim shtrihet në mënyrë logjike edhe te forma apo baza e përgjegjësisë penale individuale. Mund të jetë që NPKIII pasqyron në mënyrë të mjaftueshme forma të përgjegjësisë penale të njohura në të drejtën e brendshme në kohën e kryerjes së veprave të pretenduara – çështje kjo e kontestuar ndërmjet Veselit dhe ZPS-së. Megjithatë, ajo që kërkohet është që përputhshmëria e NPKIII me parimin e ligjshmërisë të trajtohet dhe të arsyetohet plotësisht nga DHSK-ja.
189. Interpretimi i avancuar në rastin *Kokkinakis* bazohet në aftësinë e individit për të ditur ose, të paktën, për të parashikuar se sjellja e tij mund të sjellë përgjegjësi penale – ky është kryesisht vlerësim faktik. Kjo sugjeron se, kur krimet sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare nuk janë inkorporuar në të drejtën e brendshme në kohën e kryerjes së veprës, individit nuk mund të dijë se veprimet apo mosveprimet e tij që lidhen me këto krime zakonore do ta bëjnë penalisht përgjegjës sipas së drejtës së brendshme, pasi kjo mund të mos jetë rasti. Prandaj, kjo nënkupton se, kur gjykatat vendore kanë juridiksion penal mbi krimet sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare, këto krime duhet të kenë pasur efekt juridik në të drejtën e brendshme në kohën e kryerjes së veprës, në mënyrë që ndjekja penale e tyre të jetë në përputhje me parimin *nullum crimen sine lege*. Në shtetet moniste, krimet sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare kanë efekt *ipso jure* në rendin e brendshëm juridik. Ndërsa në shtetet dualiste, kërkohet një akt inkorporimi për t’i transpozuar këto krime në kornizën e brendshme juridike.

C. *Lex mitior*

190. Në rastin *Scoppola k. Italisë*, GJEDNJ-ja konfirmoi se neni 7 i KEDNJ-së përfshin parimin *lex mitior*, sipas të cilit, nëse ligji i zbatueshëm për një veprë penale ndryshon pas kryerjes së saj, i pandehuri duhet të përfitojë nga dënimi më i butë. Gjykata theksoi se “neni 7 § 1 i

²⁸⁵ *Prokurorët e Përbashkët k. Nuon Cbea* dhe të tjerëve (Aktgjykimi i Apelit), Çështja nr. 002/19-09-2007/ECCC/SC, 23 nëntor 2016, paragrafi 791.

*Konventës garanton jo vetëm parimin e moszbatimit prapaveprues të ligjeve penale më të rënda, por edhe, në mënyrë implicite, parimin e zbatimit prapaveprues të ligjit penal më të butë.*²⁸⁶ Zhvillimi i së drejtës së brendshme nga periudha kohore e juridiksionit të DHSK-së deri në ditët e sotme është veçanërisht i ndërlikuar në kontekstin e Kosovës. Jo vetëm që ekziston një hendek pesëmbëdhjetëvjeçar ndërmjet miratimit të Ligjit për DHSK-në dhe veprimeve të të akuzuarve, por edhe pasojat e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 sollën reforma të rëndësishme ligjore. Kjo, në vetvete, krijon nevojën për kujdes të shtuar në vlerësimin e ndikimit të zhvillimeve ligjore mbi të drejtat e të akuzuarve. Rasti i Salih Mustafës e vë në pah në mënyrë të veçantë nevojën për shqyrtimin e qasjes së DHSK-së ndaj parimit *lex mitior*. Historia komplekse procedurale e këtij rasti paraqitet më poshtë, pas së cilës analizohet praktika e DHSK-së.

191. Salih Mustafa ishte komandant i një njësie të specializuar guerile brenda UÇK-së, e njohur si njësia “BIA”. Pas gjykimit, ai u shpall fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes, dhe u lirua nga akuza për krimin e luftës të trajtimit mizor. Në caktimin e dënimit, Trupi Gjykses identifikoi dënimet për secilën vepër për të cilën ai u shpall fajtor si vijon: dhjetë vjet për krimin e luftës të ndalimit arbitrar; njëzet e dy vjet për krimin e luftës të torturës; dhe njëzet e pesë vjet për krimin e luftës të vrasjes.²⁸⁷ Bazuar në parimin e totalitetit, atij iu shqiptua një dënim unik prej 26 vitesh burgim.²⁸⁸
192. Pas dënimit, Mustafa ndoqi disa rrugë ankimi dhe rishikimi përkitazi me aspekte të ndryshme të dënimit dhe fajësisë së tij. Historiku procedural përfshin vendimet dhe aktgjykimet kryesore si në vijim:
 - a. Aktgjykimi i Trupit Gjykses I, i datës 16 dhjetor 2022.²⁸⁹
 - b. Aktgjykimi i Panelit të Apelit i datës 14 dhjetor 2023.²⁹⁰
 - c. Vendimi i Panelit të Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë i datës 29 korrik 2024.²⁹¹

²⁸⁶ *Scoppola k. Italisë* (Nr. 2), Aplikimi nr. 10249/03 (GJEDNJ, 17 shtator 2009), paragrafi 109.

²⁸⁷ Aktgjykimi i gjykimit në rastin Mustafa, paragrafët 827–831.

²⁸⁸ Në përputhje me Rregullën 163(4) të Rregullores.

²⁸⁹ Aktgjykimi i gjykimit në rastin Mustafa

²⁹⁰ *Prokurori i Specializuar k. Mustafës*, Aktgjykimi i Apelit, KSC-CA-2023-02/F00038/RED, 14 dhjetor 2023 (“Aktgjykimi i Apelit në rastin Mustafa”).

²⁹¹ *Prokurori i Specializuar k. Mustafës*, Vendimi mbi kërkesën e Salih Mustafës për mbrojtje të ligjshmërisë, KSC-SC-2024-02/F00018, 29 korrik 2024 (“Vendimi për mbrojtje të ligjshmërisë në rastin Mustafa”).

- d. Vendimi i Panelit të Apelit për rivendosjen e dënimit i datës 10 shtator 2024.²⁹²
- e. Vendimi i Panelit të Gjykatës Supreme lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, në vijim të rishqyrtimit të dënimit nga Paneli i Apelit i datës 25 shkurt 2025.²⁹³
- f. Vendimi i Panelit të Gjykatës Kushtetuese mbi një referim për të drejta themelore nga Mustafa i datës 17 prill 2025.²⁹⁴
193. Ndonëse secila nga këto procedura penale ishte tejet komplekse dhe e veçantë, pozicioni kyç i Mustafës lidhur me parimin e ligjshmërisë mbeti në masë të madhe i qëndrueshëm. Mustafa mbajti qëndrimin se Trupi Gjykoes duhej të kishte zbatuar Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1976) (“**Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976**”), i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës, gjatë përcaktimit të intervalit të aplikueshëm të dënimit.²⁹⁵ Mustafa argumentoi se intervali i dënimit për krimin e vrasjes sipas Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976 parasheh dënim maksimal me burgim prej pesëmbëdhjetë vitesh.²⁹⁶ Baza e këtij argumenti ishte interpretimi dhe zbatimi i nenit 44(2) të Ligjit të DHSK-së dhe zbatueshmëria e parimit *lex mitior*.
194. Neni 12 i Ligjit për DHSK-në përcakton se “*e drejta e zbatueshme*” në DHSK përfshin “*të drejtën materiale penale të Kosovës ... siç ka qenë e zbatueshme në kohën kur janë kryer veprat penale*”. Neni 15 përcakton “*të drejtën materiale penale në fuqi sipas ligjit të Kosovës gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara*”, e cila shprehimisht përfshin Kodin Penal të RSFJ-së të vitit 1976.
195. Parimi *lex mitior* pasqyrohet në nenin 7 të KEDNJ-së dhe është i mishëruar në nenin 33(2) dhe (4) të Kushtetutës:

²⁹² Prokurori i Specializuar k. Mustafës, Vendimi mbi rivendosjen e dënimit të Salih Mustafës, KSC-CA-2023-02/F00045, 10 shtator 2024 (“Vendimi i Apelit për rivendosjen e dënimit në rastin Mustafa”).

²⁹³ Prokurori i Specializuar k. Mustafës, Vendimi mbi kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të Mustafës dhe ZPS-së, KSC-SC-2024-03 & KSC-SC-2024-04/F00006, 25 shkurt 2025 (“Vendimi për mbrojtje të ligjshmërisë në rastin Mustafa dhe ZPS”).

²⁹⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në çështjen e referimit kushtetues të Mustafës.

²⁹⁵ Shih, ndër të tjera, Prokurori i Specializuar k. Mustafës, Njoftimi i Mbrojtjes për Apel, në bazë të Rregullës 176 (të Rregullores së Procedurës dhe Provave) kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykoes I të datës 16 dhjetor 2022, KSC-CC-2023-02/F00006RED2, 2 shkurt 2023 (“Njoftimi i Apelit në rastin Mustafa”), paragrafi 12; dhe Prokurori i Specializuar k. Mustafës, Versioni i dytë i mëtejshëm publik i redaktuar i versionit të korrigjuar të Parashtrimit të Apelit të Mbrojtjes në bazë të Rregullës 179(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”) me Shtojcat konfidenciale 1, 2 dhe 3, KSC-CA-2023-02/F00021, 2 maj 2023 (“Parashtrimi i Apelit në rastin Mustafa”), paragrafët 412–413 dhe 419–427.

²⁹⁶ *Ibid.*

- 2) *Dënimi i shqiptuar për një veprë penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.*
- 3) *[...]*
- 4) *Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.*

196. Neni 44(2) i Ligjit përcakton:

Gjatë shqyrtimit të dënimit që duhet t'i shqiptohet një personi të shpallur fajtor për një krim ndërkombëtar sipas këtij Ligji, Dhomat e Specializuara marrin parasysh:

- a) *intervalin e dënimit për veprën penale të paraparë sipas ligjit të Kosovës në kohën e kryerjes së saj,*
- b) *çdo interval të mëvonshëm më të butë të dënimit për veprën penale të paraparë në ligjin e Kosovës, dhe*
- c) *nenin 7(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore dhe nenin 15(2) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, siç janë inkorporuar mbrojtur me nenet 22(2), 22(3) dhe 33(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe shkallën në të cilën dënimi i çdo veprimi ose mosveprimi që ishte i dënueshëm sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e civilizuarat do të cenohet nga zbatimi i paragrafit 2 (a) dhe (b).*

197. Interpretimi i Mustafës për intervalin e dënimit sipas Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976 u kundërshtua nga Dhoma e Apelit. Në mënyrë domethënëse, ky kod penal parashihte dënimin me vdekje, i cili nuk është dënim i zbatueshëm nga DHSK-ja, gjë që ngre dyshime nëse ai përbën *lex mitior*.²⁹⁷ Megjithatë, në kontekstin aktual, fokusi është në interpretimin e saktë të nenit 44(2) të Ligjit dhe zbatueshmërinë e parimit *lex mitior* në procedurat penale të DHSK-së lidhur me të drejtën e brendshme të Kosovës të zbatueshme në kohën e kryerjes së veprës penale.

Aktgjykimi i Panelit të Apelit

198. Ankesa e Mustafës kundër fajësisë u rrëzua. Ndërsa ankesa e tij kundër dënimit u pranua pjesërisht. Shkaqet e tij të ankesës përfshinin: se Trupi Gjykses “e hodhi poshtë në mënyrë të

²⁹⁷ Neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976 parashikonte ose “dënim me burgim jo më pak se pesë vjet ose [...] dënimin me vdekje”. Neni 38 më tej parashikonte se “dënimi me burgim nuk mund të jetë më i gjatë se 15 vjet”, por se “mund të shqiptohet një dënim prej 20 vjetësh për veprat penale që janë të dënueshme me vdekje”.

drejtpërdrejtë zbatimin” e parimit *lex mitior*;²⁹⁸ se nuk e zbatoi / nuk e zbatoi saktë parimin *lex mitior*, duke rezultuar në shkelje të të drejtave të tij kushtetuese;²⁹⁹ dhe se interpretoi gabim nenin 44 të Ligjit, duke çuar në shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 33(2) të Kushtetutës së Kosovës.³⁰⁰ Thelbi i këtyre argumenteve u paraqit gjatë të gjitha shqyrtimeve dhe ankesave të mëvonshme.

199. Në masën që ankesa u pranua, Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjykses nuk e kishte përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin e tij për të “*marrë parasysb*” intervalet vendore të dënimit; dhe se dënimi i vetëm, si dhe dënimet për secilën veprë penale, të shqiptuara Mustafës, ishin jashtë proporcionit të arsyeshëm me dënimet e shqiptuara për vepra të ngjashme në rrethana të ngjashme, gjë që përbën gabim në shqiptimin e dënimit nga Trupi Gjykses.³⁰¹ Dënimi i tij i vetëm u ul nga njëzet e gjashtë vjet në njëzet e dy vjet. Dënimet për secilën veprë u ulën si vijon: tetë vjet për krimin e luftës të ndalimit arbitrar; njëzet vjet për krimin e luftës të torturës; dhe njëzet e dy vjet për krimin e luftës të vrasjes.³⁰²
200. Në rrëzimin e nën-shkaqeve të ankesës, Gjykata e strukturoi arsyetimin si vijon:
- a. Ndonëse neni 44(2) i Ligjit parasheh një detyrim për Tribunalin përmes përdorimit të fjalës “*do të*”, ky detyrim është që të “*marrë parasysb*”, e jo të zbatojë apo t’i japë efekt.³⁰³ Rrjedhimisht, regjimi vendor i dënimeve i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës nuk është detyruar për DHSK-në.
 - b. Gjykata më tej konstatoi shprehimisht se, meqë DHSK-ja nuk është e detyruar nga regjimi vendor i dënimeve, “*parimi lex mitior nuk është i zbatueshëm lidhur me këto dispozita vendore*”.³⁰⁴
 - c. Sa i përket mishërimit të parimit *lex mitior* në Kushtetutën e Kosovës, Gjykata konstatoi se ky parim zbatohet vetëm për ligjin që e detyron DHSK-në. Paneli i Apelit e mbështeti këtë arsyetim duke iu referuar faktit se e drejta e zbatueshme për krimet e luftës është e drejta zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së

²⁹⁸ Njoftimi i Apelit në rastin Mustafa, paragrafi 12, Shkaku 9C.

²⁹⁹ Njoftimi i Apelit në rastin Mustafa Shkaku 9D.

³⁰⁰ Njoftimi i Apelit në rastin Mustafa Shkaku 9E.

³⁰¹ Aktgjykimi i Apelit në rastin Mustafa, paragrafi 479.

³⁰² Njoftimi i Apelit në rastin Mustafa, par. 480.

³⁰³ Aktgjykimi i Apelit në rastin Mustafa, par. 466.

³⁰⁴ Aktgjykimi i Apelit në rastin Mustafa, par. 467.

veprës, dhe DHSK-ja është e mandatuar të zbatojë Ligjin e DHSK-së si *lex specialis* dhe të drejtën tjetër të inkorporuar drejtpërdrejt në regjimin e DHSK-së.³⁰⁵ Në veçanti, Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976 nuk është i inkorporuar në këtë mënyrë.

201. Pas aktgjykimit të Apelit, kërkuesi paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pranë një paneli të Gjykatës Supreme, duke kërkuar, ndër të tjera: “*ndryshimin e aktgjykimit të apelit lidhur me dënimin mbi bazën e pretendimit për mosrespektim të parimit lex mitior*”.³⁰⁶

Vendimi i Panelit të Gjykatës Supreme (mbrojtja e ligjshmërisë)

202. Paneli i Gjykatës Supreme theksoi se nuk është natyra e Gjykatës ajo që përcakton të drejtën e zbatueshme, por vetë ligji.³⁰⁷ Paneli kreu një analizë më gjithëpërfshirëse si të Ligjit të DHSK-së ashtu edhe të Kushtetutës së Kosovës, duke arritur në përfundimin se fjalët “do të marrë parasysh” në nenin 44(2) të Ligjit të DHSK-së duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që Paneli përkatës është i detyruar të shqyrtojë se cili interval i zbatueshëm i dënimit sipas së drejtës së Kosovës është në përputhje me parimin lex mitior dhe më pas ta marrë atë interval parasysh gjatë përcaktimit të dënimit.³⁰⁸ Në veçanti, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi: “*do të marrë parasysh*” duhet të interpretohet në përputhje me parimin lex mitior të përcaktuar në nenin 33(4) të Kushtetutës, nenin 7(1) të KEDNJ-së dhe siç pasqyrohet në nenin 44(2)(b) të Ligjit”.³⁰⁹

203. Paneli konstatoi se Paneli i Apelit kishte gabuar duke mos përcaktuar fillimisht intervalin e zbatueshëm të dënimit para se të caktonte dënimin. Ai konstatoi se Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976 nuk është i zbatueshëm si çështje ligjore dhe, në çdo rast, nuk mund të konsiderohet lex mitior, pasi parashihte dënim me vdekje për veprën penale përkatëse. Duke konstatuar se në vend të tij lex mitior është Kodi Penal i Kosovës i vitit 2019, i cili

³⁰⁵ Njoftimi i Apelit në rastin Mustafa, paragrafi 468. Neni 3(4) i Ligjit për DHSK-në parashikon: “Çdo ligj tjetër i Kosovës, rregullore, akt nënligjor, rregull tjetër apo praktikë që nuk është inkorporuar shprehimisht në këtë Ligj, nuk do të zbatohet për organizimin, administrimin, funksionet apo juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Ky Ligj mbizotëron ndaj çdo dispozite të kundërt të çdo ligji apo rregulloreje tjetër”.

³⁰⁶ *Prokurori i Specializuar k. Mustafës*, Kërkesa e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcat Konfidenciale 1 dhe 2 në bazë të nenit 48(6) deri në (8) të Ligjit dhe Rregullës 193 të Rregullores, KSC-SC-2024-02/F00011, 14 mars 2024 (“Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë në rastin Mustafa”).

³⁰⁷ Vendimi për mbrojtje të ligjshmërisë në rastin Mustafa, par. 76.

³⁰⁸ *Ibid*, par. 87.

³⁰⁹ *Ibid*, (n 306), par. 88.

parashih një interval dënimi prej pesë deri në 25 vjet burgim.³¹⁰ Paneli ia referoi çështjen përsëri Panelit të Apelit për rivendosje të dënimit dhe udhëzoi Panelin e Apelit që të udhëhiqet nga: “(i) Rregulla 163 e Rregullores; (ii) intervali i dënimit prej pesë deri në 25 vjet i identifikuar nga ky Panel në rastin e z. Mustafa; (iii) faktorët e dënimit të identifikuar nga Paneli i Apelit; 164 (iv) jurisprudenca e analizuar nga Paneli i Apelit dhe ky Panel; 165 dhe (v) rrethanat specifike të rastit të z. Mustafa”.³¹¹

204. Paneli i Apelit shqiptoi një dënim unik prej pesëmbëdhjetë vitesh, ndërsa dënimet për secilën vepër penale ishin: pesëmbëdhjetë vjet për krimin e luftës të vrasjes; trembëdhjetë vjet për krimin e luftës të torturës; dhe tetë vjet për krimin e luftës të ndalimit arbitrar.³¹²
205. Si Kërkuesi ashtu edhe ZPS-ja paraqitën kërkesa të ndara për mbrojtje të ligjshmërisë, të cilat në thelb u rrëzuan.³¹³ Më pas, Kërkuesi iu drejtua Panelit të Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij sipas neneve 22, 31 dhe 33 të Kushtetutës së Kosovës dhe neneve 6 dhe 7 të KEDNJ-së.³¹⁴

Paneli Kushtetues

206. Baza e referimit, në masën që lidhet me çështjet në shqyrtim, ishte se Paneli i Gjykatës Supreme kishte zbatuar në mënyrë të gabuar parimin *lex mitior* duke përjashtuar nga intervali i zbatueshëm i dënimit Kodin Penal të RSFJ-së të vitit 1976.³¹⁵ Me rëndësi, juridiksioni i Panelit të Gjykatës Kushtetuese ishte i kufizuar në përcaktimin e shkeljeve të pretenduara të të drejtave. Ai nuk ka kompetenca të natyrës së apelit në raport me vendimin e Panelit të Gjykatës Supreme.
207. Paneli Kushtetues hodhi poshtë arsyetimin e Panelit të Gjykatës Supreme lidhur me nenin 44(2) të Ligjit për DHSK-në dhe zbatueshmërinë e parimit *lex mitior*. Arsyetimi u mbështet në qëndrimin se “DHSK dhe ZPS funksionojnë në mënyrë autonome, në përputhje me

³¹⁰ *Ibid*, (n 306), par. 102.

³¹¹ *Ibid*, (n 306), par. 111.

³¹² Vendimi i Apelit për Rishqiptimin e Dënimit në rastin Mustafa, paragrafët 24-25.

³¹³ Vendimi për mbrojtje të ligjshmërisë në rastin Mustafa dhe ZPS, par. 64.

³¹⁴ *Prokurori i Specializuar k. Mustafës*, Referimi pranë Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me shkeljet e të drejtave themelore të z. Salih Mustafa të garantuara nga nenet 22, 31 dhe 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, KSC-CC-2024-22/F00001, 27 shtator 2024 (‘Referimi kushtetues në rastin Mustafa’).

³¹⁵ *Ibid*, Shkaku 2, par. 37-107.

kornizën e tyre të përcaktuar ligjore".³¹⁶ Ai konstatoi se, sipas nenit 44(2) të Ligjit për DHSK-në, "dhomat penale e marrin parasysh këto shkallë gjatë përcaktimit të dënimit që duhet t'i shqiptohet një personi të shpallur fajtor për një krim sipas së drejtës ndërkombëtare, por nuk janë të detyruara t'i zbatojnë ato".³¹⁷ Për më tepër, Paneli Kushtetues u pajtua me Panelin e Apelit se parimi *lex mitior* nuk zbatohet në bazë të faktit se korniza e dënimeve sipas së drejtës së brendshme të Kosovës nuk e detyron DHSK-në, dhe për rrjedhojë vetëm Ligji për DHSK-në është detyrues për Panelin në përcaktimin e dënimit.³¹⁸ Gjithashtu vuri në dukje se nuk bindet nga arsyetimi i Panelit të Gjykatës Supreme për moszbatimin e Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976.

208. Paneli Kushtetues është paneli më i lartë sa i përket interpretimit dhe zbatimit të Kushtetutës së Kosovës dhe të drejtave themelore. Rrjedhimisht, konstatimet e tij, siç u trajtuan më sipër, përbëjnë autoritetin mbizotërues në interpretimin e nenit 44(2) të Ligjit për DHSK-në dhe zbatueshmërinë e parimit *lex mitior*. Megjithatë, meqenëse konstaton se parimi *lex mitior* nuk është i zbatueshëm, çdo mangësi në arsyetimin e Panelit të Gjykatës Supreme lidhur me arsyet pse e konsideroi Kodin Penal të RSFJ-së të vitit 1976 si të pazbatueshëm nuk sjell shkelje të të drejtave. Si i tillë, dënimi i rishikuar i përcaktuar nga Paneli i Apelit pas vendimit për mbrojtje të ligjshmërisë mbetet në fuqi.

D. Konkluzioni

209. Modeli i konsoliduar i gjykatave penale ndërkombëtare me juridiksion prapaveprues tregon se ndjekja penale e veprave historike sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare, në mungesë të një baze statutore bashkëkohore, nuk bie domosdoshmërisht ndesh me parimin *nullum crimen sine lege*, për aq kohë sa veprat në fjalë kanë qenë të ndaluara nga drejta penale ndërkombëtare në kohën përkatëse. Kjo lidhet me parimin e ligjshmërisë në nivel ndërkombëtar. Megjithatë, korniza ligjore e DHSK-së, veçanërisht miratimi i veprave penale të Statutit të Romës dhe referimi ndaj jurisprudencës së Gjykatës Ndërkombëtare Penale si mjet interpretimi, krijon rrezik që veprat penale të konstruktohen në shpërputhje me gjendjen e zhvillimit të së drejtës zakonore

³¹⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në çështjen e referimit kushtetues të Mustafës, par. 113.

³¹⁷ *Ibid*, (n 314), par. 115.

³¹⁸ *Ibid*, (n 314), par. 119.

ndërkombëtare ashtu siç ishte ndërmjet 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000. Për të zbutur këtë rrezik, gjykatësit duhet të jenë të vetëdijshëm për të.

210. Përputhshmëria me parimin e ligjshmërisë në nivel ndërkombëtar nuk rezulton automatikisht në përputhshmëri me të njëjtin parim në nivel vendor. DHSK-ja, në fund të fundit, është mekanizëm vendor dhe jo gjykatë penale ndërkombëtare. Arsyetimi i Dhomës së Procedurës Paraprake në vendimin mbi mocionet e Veselit që sfidonin juridiksionin, nuk e trajton në mënyrë të mjaftueshme parimin e ligjshmërisë në nivel të brendshëm, qoftë lidhur me veprat penale materiale, ashtu edhe me NPKIII si formë e përgjegjësisë penale individuale. Një shtyllë qendrore e arsytimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ishte theksimi i natyrës së specializuar dhe karakterit të vetëklasifikuar *lex specialis* të Ligjit për DHSK-në, gjë që i mundësoi të konkludojë se parimi i ligjshmërisë përmbushet në nivel të brendshëm për aq kohë sa veprat kanë qenë të ndaluara nga e drejta zakonore ndërkombëtare. Në të vërtetë, ky arsyetim është thellësisht i rrënjësor në jurisprudencën e DHSK-së në përgjithësi dhe e paraqet DHSK-në si mekanizëm që në masë të madhe qëndron jashtë kornizës kushtetuese të Kosovës. Kjo mund të jetë pasojë e mungesës së ekspertizës në të drejtën kushtetuese të Kosovës dhe në traditën juridike të Kosovës më gjerësisht brenda trupit gjykues të DHSK-së. Mbetet ende e nevojshme që DHSK-ja, përmes jurisprudencës së saj, ta trajtojë këtë çështje në mënyrë të plotë.
211. Struktura komplekse e DHSK-së sjell një rrezik të vazhdueshëm të fragmentimit institucional, i cili vihet në pah në mënyrë të theksuar nga procedurat penale në *rastin Mustafa*. Historiku procedural në këtë rast, veçanërisht sa i përket dënimit, ngre disa shqetësime serioze. Siç ilustron më poshtë, ankesa dhe kërkesa të veçanta e zhvendosën rastin nga Trupi Gjykues në Panelin e Apelit, më pas në Panelin e Gjykatës Supreme dhe sërish në Panelin e Apelit, duke rezultuar në një reduktim të përgjithshëm të dënimit efektiv prej 11 vitesh, ose 42.3%. Megjithatë, pas një referimi të mëtejshëm në Panelin Kushtetues, pozita juridike lidhur me interpretimin e duhur të nenit 44(2) të Ligjit për DHSK-në dhe zbatueshmërinë *val non* të parimit *lex mitior*, në thelb u rikthye në qëndrimin e mbajtur nga Paneli i Apelit në aktgjykimin e tij për ankimimin fillestar.

Akuza	Trupi Gjykses:	Paneli i Apelit:	Paneli i Apelit:	Ulja e përgjithshme:
Krimi i luftës i vrasje	25 vite	22 vite	15 vite	10 vite / 40%
Krimi i luftës i torturës	22 vite	20 vite	13 vite	9 vite / 40.9%
Krimi i luftës i ndalimit arbitrar	10 vite	8 vite	8 vite	2 vite / 20%
Dënimi unik	26 vite	22 vite	15 vite	11 vite / 42.3%

212. Është përtej fushëveprimit të këtij vlerësimi paraprak të arrihen konkluzione të qëndrueshme mbi çështje komplekse të së drejtës. Megjithatë, disa vërejtje paraprake janë të nevojshme, me qëllim identifikimin e çështjeve për shqyrtim të mëtejshëm dhe rishikim në të ardhmen.
213. Paneli Kushtetues iu referua jurisprudencës së TPNJ-së sipas së cilës parimi *lex mitior* nuk zbatohet në TPNJ lidhur me të drejtën e brendshme, pasi kjo e drejtë nuk e detyron TPNJ-në.³¹⁹ Pa shqyrtim të mëtejshëm, Paneli krijoi një barazi midis vetes dhe tribunaleve ndërkombëtare *ad hoc*, gjë që pasqyron theksin e Panelit mbi DHSK-në si një regjim të veçantë dhe autonom.³²⁰ Një barazim i tillë dhe theksimi i veçantisë dhe autonomisë është i pasaktë. Ai anashkalon faktin se DHSK-ja, në aspektin juridik, është një institucion i vendor që vepron brenda kornizës së Kushtetutës supreme të Kosovës, dhe jo jashtë saj. Për më tepër, kjo qasje injoron faktin se juridiksioni *ratione materiae* i DHSK-së shtrihet edhe mbi Kodin Penal të RSFJ-së të vitit 1976. Nuk është bindëse të konstatohet se parimi *lex mitior* nuk zbatohet lidhur me Kodin Penal të RSFJ-së të vitit 1976 mbi bazën se ai nuk e detyron DHSK-në, kur në fakt DHSK ushtron juridiksion penal pikërisht lidhur me atë kod. Qëndrimi i Panelit në këtë aspekt ka gjasa të jetë pasojë e natyrës së veçantë të themelimit të DHSK-së dhe faktit që gjykatësit janë të gjithë ndërkombëtarë; rrjedhimisht, ekziston një mungesë e theksuar e ekspertizës vendore juridike dhe kushtetuese në përbërjen e saj gjyqësore.

³¹⁹ *Ibid*, (n 314), paragrafi 117, duke iu referuar rastit *Prokurori k. Nikolić*, Aktgjykim për dënim, IT-94-2-S, 2 dhjetor 2003, paragrafët 81-84, TPNJ konstatoi se “ai nuk është i detyruar nga praktika e dënimeve e ish-Jugosllavisë, megjithëse mund t’i referohet asaj”.

³²⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në çështjen e referimit kushtetues të Mustafës, par. 109-121.

214. Konstatimi i Panelit Kushtetues se parimi *lex mitior* e detyron DHSK-në vetëm në masën e së drejtës së inkorporuar në Ligjin për DHSK-në është në papajtueshmëri me thelbin dhe qëllimin e këtij parimi. Ligji për DHSK-në, i miratuar si pjesë e së drejtës së brendshme të Kosovës më 3 gusht 2015, pason me më shumë se katërbëdhjetë vjet periudhën kohore të juridiksionit të DHSK-së. Sipas natyrës, ky parim zbatohet për veprime historike dhe për të drejtën bashkëkohore me ato veprime historike. Për më tepër, ky konstatim lë hapësirë që shtetet të shmangin parimin *lex mitior* në mënyrë të qëllimshme, përmes miratimit të mekanizmave të posaçëm dhe të vetëpërmbytur me juridiksion të ngushtë lëndor. Kjo pasqyron mungesë të vlerësimit të mjaftueshëm se parimi *lex mitior* ka karakterin e një të drejte individuale, dhe jo të një kufizimi procedural që ekziston brenda një tribunali.
215. Për më tepër, konstatimi i Panelit Kushtetues anashkalon faktin se DHSK-ja, në aspektin juridik, është një institucion vendor që vepron nën një kushtetutë supreme. Arsyet për këtë qasje ka gjasë të lidhen, pjesërisht, me themelimin e saj të veçantë dhe faktin se të gjithë gjykatësit janë ndërkombëtarë, pra jo nga Kosova. Rrjedhimisht, në përbërjen gjyqësore të DHSK-së ekziston një mungesë e theksuar e ekspertizës juridike dhe kushtetuese vendore.

VIII. KONKLUZIONI

216. Ky raport, sipas qëllimit të tij, përbën një vlerësim paraprak dhe jo një akt përfundimtar gjykimi. Raporti nuk konkludon se DHSK-ja po dështon në misionin e saj, por as që çdo gjë është në rregull.
217. Raporti pasqyron një sërë shqetësimesh paraprake mjaft serioze për të kërkuar vëmendje dhe mjaftueshëm të dokumentuara për t'i rezistuar hedhjes poshtë. Standardi krahasues i duhur nuk është ai që kanë toleruar gjykata dhe tribunale të tjera ndërkombëtare (ose të ndërkombëtarizuara) – krahasimi me institucione që në disa raste vetë kanë dështuar në garantimin e standardeve të gjykimit të drejtë ofron pak ngushëllim. DHSK-ja i përgjigjet (ose duhet t'i përgjigjet) Kushtetutës së Kosovës dhe standardeve të KEDNJ-së të inkorporuara në kornizën e saj ligjore, dhe pikërisht në raport me këto standarde, të zbatuara në mënyrë rigorozë, duhet vlerësuar performanca e saj.

218. Ky vlerësim ka rëndësi për arsye që shkojnë përtej aspektit procedural. Në lojë është liria e individëve. Viktimat kanë pritur me dekada për përgjegjësi, dhe komunitetet e prekura kanë interes të madh në drejtësi që jo vetëm të jepet, por edhe të shihet se jepet. Për më tepër, vendimet dhe produktet e DHSK-së do të ndikojnë në mënyrë të pashmangshme përpjekjet më të gjera të drejtësisë tranzicionale dhe arkitekturën ende të brishtë të paqes dhe stabilitetit në rajon.³²¹ Pasojat e gabimeve në këtë fushë shtrihen përtej kufijve të sallës së gjyqit.
219. Për këto arsye, BHRC rekomandon krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm monitorimi të gjykimeve, të pavarur dhe të pajisur me burime të mjaftueshme. DHSK-ja është themeluar për të siguruar drejtësi që gëzon besim në rajon dhe më gjerë. Kjo kërkon vëzhgim të vazhdueshëm nga jashtë dhe gatishmëri të vetë gjykatës për ta pranuar një mbikëqyrje të tillë.

³²¹

Ibid (shih shënimin 31); Aidan Hehir, “Lessons Learned? The Kosovo Specialist Chambers’ Lack of Local Legitimacy and its Implications”, 20 Hum. Rts. Rev. 267, 268 (2019), në f. 268 dhe 282-283. Shih gjithashtu Gëzim Visoka, “Assessing the potential impact of the Kosovo Specialist Court” (PAX, shtator 2017), f. 7.